

KOLEGJI ESLG

DEPARTAMENTI: MENAXHIMI I PATUNDSHMËRIVE DHE INFRASTRUKTURËS

Niveli i studimeve: MASTER

PUNIM DIPLOME-MASTER

**PROMOVIMI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM URBAN PËRMES PPP NË
QYTETIN E PRISHTINËS**

RAST STUDIMI: PROJEKTI I NËNKALIMIT NË LAGJËN BILL CLINTON

Mentor: Prof. Dr. Elvida Pallaska

Kandidati: VLORA SINANI

Prishtinë

MARS, 2022

“Planifikimi hapësinor është dhe do të mund të përdoret si instrument për matjen e nivelit të vetëdijes kolektive në një vend, qeverisjes së mirë dhe nivelit të demokracisë. Planifikimi/zhvillimi hapësinor urban është politikë dhe e kundërta, po që se planifikimi zhvillimi hapësinor dhe urban është efikas, në atë vend zhvillohet politikë e mirëfilltë, ka qeverisje të mirë dhe ka demokraci dhe e kundërta!”

(E.Pallaska, 2012)

FALENDERIMET

Kjo temë e Masterit është e punuar në kuadër të drejtimit “Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës” në Kolegjin ESLG, pas një përpjekje të gjatë të studimeve dhe thellimit në temë.

Kjo fazë e hulumtimit shënon një periudhë të veçantë të zhvillimit tim profesional. Falenderoj Zotin, që me njoftoi me njerëz të veçantë në këtë periudhë të studimeve.

Falenderoj mentoren time Dr. Prof. Elvida Pallaska Sahatçiu për besimin, këshillimin dhe mbështetjen profesionale në një temë të gjërë si “Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban”.

E falenderoj Dr. Prof. Dekan Visar Hoxha për mundësinë e ndjekjes së studimeve Master përmes bursës studentore pranë Kolegjit ESLG, tanimë pjesë e Universitetit UBT.

Falenderoj familjarët dhe miqtë e mi që më morën pjesë në hulumtim, në veçanti miken time N. Maliqi.

Këtë punim ia dedikojë nënës time Fetije dhe dy vajzave të mia, Arseles dhe Esres.

*Gjilan, 01 Janar, 2022
Vlora Sinani Miftari*

Abstrakt

Qytetet janë vatrat kryesore në trajtimin e problemeve globale, trajtimin e emergjencave të ndryshme klimatike e ekologjike, riadresimin e çështjeve të pabarazisë sociale dhe ekonomike. Në kohë emergjencash, sfidash dhe pabarazish të llojeve të ndryshme të shek. XXI, qytetet dëshmojnë se riorientimi i qeverisjes urbane drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban nuk është kurrë i mjaftueshëm. Si mjet i rëndësishëm për shtyerjen e qyteteve drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban, Bashkimi Evropian vazhdon të mbështesë PPP në realizimin e kohezionit territorial dhe prioriteteve të Zhvillimit të Integruar Territorial si rrugë drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.

Për qytetet në tranzicion dhe jo anëtare të BE-së, ku politika e kohezionit territorial dhe kapitali i Bashkimit Evropian nuk paraqesin alternative, si dhe qeverisja urbane nuk ekziston si trup institucional, zhvillimi fillon me hapat e parë të vlerësimit dhe plotësimit të indikatorëve drejtë Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative në mini-projektet e atij qyteti.

Ky hulumtim synon të analizojë teoretikisht strategjitë dhe politikat hapësinore të qytetit si bazë për krijimin e qyteteve të qëndrueshme të shek. XXI. Përmes inicimit të projektit me PPP në rastin e një nënkalmi argumenton praktikisht suksesin e PPP në plotësimin e indikatorëve për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban. Për bazë teorike janë marrë dokumentet evropiane hapësinore: Axhenda e Re Urbane dhe Axhenda Territoriale 2030.

Hulumtimi teston që:

1. Partneriteti Publiko- Privat arrin të orientojë suksesshëm qytetin e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.
2. Partneriteti Publiko- Privat nuk arrin të orientojë qytetin e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.

Empirikisht, studimi bazohet në anketimin e nëntëdhjetë pjesëmarrëve të kategorive të ndryshme të përfshirë në rastin e studimit në nënkalimin “Bill Clinton” në Prishtinë, i cili konsiderohet si projekt i suksesshëm dhe pikë nyje për përmirësim e shumë aspekteve të jetës së qytetarëve në Prishtinë. Natyra e hulumtimit është deskriptive dhe normative, e elaboruar përmes metodës kualitative dhe shqyrtimit kritik të legjislacionit aktual. Në përgjithësi, kjo tezë siguron një kuptim më të mirë sesi qytetet mund të përjetojnë transformimin drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.

Fjalët kyçe: Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban, Axhenda Territoriale 2030, Axhenda e Re Urbane, Zhvillimi i bazuar në Njohuri, Kapacitetet Organizative, Partneritet Publiko- Privat, Kohezion territorial, Indikatorë urban, Qyteti i Prishtinës, Nënkalmi.

Abstract

Cities are the main hotbeds in tackling global problems, tackling various climatic and ecological emergencies, re-addressing issues of social and economic inequality. In times of emergencies, challenges and inequalities of various kinds of the century. XXI, cities prove that reorienting urban governance towards Sustainable Urban Development is never enough.

As an important tool for pushing cities towards Sustainable Urban Development, the European Union continues to support PPP in achieving territorial cohesion and Integrated Territorial Development priorities as a path towards Sustainable Urban Development.

For cities in transition and non-EU member states, where territorial cohesion policy and European Union capital are not alternatives and urban governance does not exist as an institutional body, development begins with the first steps of evaluating and meeting indicators towards the development of based on Knowledge and Organizational Capacities in mini-projects of this city.

This research aims to theoretically analyze the strategies and spatial policies of the city as a basis for the creation of sustainable cities of the twentieth century. XXI. Through the initiation of the project with PPP in case of an underpass argues practically the success of PPP in meeting the indicators for Sustainable Urban Development. The European spatial documents are taken as a theoretical basis: the New Urban Agenda and the Territorial Agenda 2030.

The research tests that:

1. Public-Private Partnership manages to successfully orient the city of Prishtina towards Sustainable Urban Development.
2. Public-Private Partnership fails to orient the city of Prishtina towards Sustainable Urban Development.

Empirically, the study is based on the survey of ninety participants of different categories involved in the case of the study on the underpass "Bill Clinton" in Pristina, which is considered a successful project and a turning point for improving many aspects of life of citizens in Pristina. The nature of the research is descriptive and normative, elaborated through qualitative method and critical review of current legislation. Overall, this thesis provides a better understanding of how cities can experience transformation towards Sustainable Urban Development.

Keywords: Sustainable Urban Development, Territorial Agenda 2030, New Urban Agenda, Knowledge Based Development, Organizational Capacities, Public-Private Partnership, Territorial Cohesion, Urban Indicators, City of Prishtina, Underpass.

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

- Fig. 1. Baza teorike për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 2. Evolimi i koncepti të kohezionit dhe rolit të qyteteve në përbërjen e legjislacionit evropian hapësinor, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 3. Subsidiariteti vertikal në Evropë, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 4. Subsidiariteti vertikal në Kosovë, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 5. Subsidiariteti, kohezioni territorial dhe koordinimi në mes tyre, Autori: Rivolin Janin, U. (2005)
- Fig. 6. Korniza teorike logjike, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 7. Prizmi i Qëndrueshmërisë, Burimi: Stenberg, J., (2001)
- Fig. 8. Ylli i kohezionit territorial, Burimi: Medeiros, E., (2016)
- Fig. 9. Korniza e Qëndrueshmërisë Urbane e GPSC, Burimi: World Bank, (2017)
- Fig. 10. Shtatë kushtet që definojnë Partneritetin Publiko-Privat, Burimi: Ohiani, J. A. M., (2014)
- Fig. 11. Procesi i PPP-së në Kosovë, Burimi: Republika e Kosovës, Ministria e Financave, (2014)
- Fig. 12. Nurmi i qyteteve të mençura (smart) në Evropë, Burimi: Unioni Evropian (2014)
- Fig. 13. Korniza logjike analitike, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 14. Bashkëpunimi i institucioneve arsimore me ndërmarrje në shtetin e Kosovës, Burimi: Oda Ekonomike, (2018)
- Fig. 15. Rritja e qytetit të Prishtinës 1970-2010, Burimi: Gollopeni, B. (2016)
- Fig. 16. Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në ndërmarrje publike në Kosovë, Burimi: Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, (2013)
- Fig. 17. Pamje nga nënkalimi në lagjen “Bill Klinton” në Prishtinë, Burimi: <https://allzone-ks.com/ndertimore/>
- Fig. 18. Plotësimi i indikatorëve të ZHBNJ në bazë të tri grupeve: Komuna, Tregtarët dhe Kalimtarët, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 19. Plotësimi i indikatorëve të KO në bazë të tri grupeve: Komuna, Tregtarët dhe Kalimtarët, Burimi: Autori, (2021)
- Fig. 20. Rezultati i përgjithshëm i plotësimit të indikatorëve të ZHBNJ dhe KO në projektin e nënkalimit në lagjen Bill Clinton, Burimi: Autori, (2021)

Tabela 1. Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban në legjislacionin kosovar dhe evropian, Burimi: Autori, (2020)

Tabela 2. Publikimet e punimeve shkencore në Universitetin e Prishtinës 2018, Burimi: Orca, (2018)

Tabela 3. Numri i parkingjeve publike krahasuar me buxhetin e Komunës së Prishtinës, Burimi: Instituti GAP, (2018)

Tabela 4. Sinteza e analizave, Burimi: Autori, (2021)

LISTA E SHKURTIMEVE

AET	Association for European Transport
ANP	Aerporti Ndërkombëtar i Prishtinës
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane per Rindërtim dhe Zhvillim
DG DEVCO	The European Commission Directorate- General for International Cooperation and Development
DG TRADE	The Directorate-General for Trade
EBI	European Banking Institute
EBRDO	European Bank for Reconstruction and Development
EC	European Cities
EEAS	European External Actions Service
ERDF	European Regional Development Fund
ESCAP	Economic Social Commission for Asia and the Pacific
ESLG	European School of Law and Governance
EUROSTAT	The statistical office of the European Union
GAP	Instituti per studime të avancuara
GIS	Geographic Information System
GTZ	Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
INSI	Instituti për Shkencë dhe Teknologji
KO	Kapacitetet Organizative
KKP	Kuvendi Komunal i Prishtinës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit hapësinor dhe Infrastrukturës
MNDE	Ministry for National Development and Economy
MRP	Menaxhimi i Ri Publik
MZHE	Ministria e zhvillimit ekonomik
NUTS	Nomenklatura e njësive territoriale statistikore
OECD	Organisation for Economic Cooperation and Development
OJQ	Organizatë jo- qeveritare
PFI	Private Finance Initiative

PHK	Plani hapësinor i Kosovës
PIP	Programi i investimeve publike
PPAM	Politikat Prioritare Afatmesme
PPP	Partneriteti Publiko-Privat
PVVZHE	Plani i veprimit për vizionin e zhvillimit ekonomik
PZHU	Plani zhvillimor urban
QeK	Qeveria e Kosovës
Orca	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
SAP	Systems Application and Products
SDG	Sustainable Development Goals
UBT	University of Business and Technology
UNDP	United Nations Development Programme
UNSCR	United Nations Security Council Resolutions
UNESCAP	United Nations Economic and Social Commission for Asia and the Pacific
UCLG	United Cities and Local Governments
UN-Habitat	United Nations Settlements Programme
WBIF	Western Balkan Investment Framework
ZHBNJ	Zhvillimi i Bazuar në Njohuri

Tabela e përmbajtjes

FALENDERIMET	iii
Abstrakt	iv
LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE	vi
LISTA E SHKURTIMEVE	ix
Përmbledhje ekzekutive	4
Konteksti	5
Kapitula I - Hyrje	12
1.1. Sfondi	13
1.2. Lidhja e konceptit të territorit me kohezionin dhe roli i qytetit	14
1.3. Objektivat studimore	20
1.4. Pyetjet hulumtuese dhe hipotezat	20
1.5. Metodologjia	21
1.5.1 Burimi i të dhënave	24
1.5.2. Struktura e Tezës	24
Kapitula II Sfondi teorik	25
2.1. Shqyrtimi i literaturës	25
2.1.1. Çka është Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe cilat janë forcat lëvizëse drejtë një zhvillimi të tillë?	26
2.2.2. Si duhet të identifikojë vetvetën qyteti drejtë një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban?	28
2.1.3. Cili është roli i PPP në orientimin e qyteteve drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban?	31
2.2. Korniza teorike	38
2.2.1. Ekonomia e bazuar në Njohuri	38
2.2.2. Roli i PPP në Zhvillimin e bazuar në Njohuri të qytetit	39
2.2.3. Rëndësia e promovimit të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri përmes PPP për qytetet në tranzicion ..	40
2.2.4. Teoria e Kapaciteteve Organizative	43
2.2.5. Korniza analitike	45
Kapitula III - Analizat e potencialeve të qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban ..	48
3.1. Prishtina, kryeqytet i një shteti në tranzicion	48
3.2. A. Analiza e pozitës dhe rolit të qytetit të Prishtinës	52
3.3. B. Analiza e Strategjisë	64
3.4. C. Analiza e pyetësorit	70
3.5. Sinteza e tri analizave të punimit	75

Kapitina IV - Konkluzionet dhe rekomandimet	76
4.1. Konkluzioni dhe rekomandimi 1- Në lidhur me potencialet dhe pozitën e qytetit drejtë një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban	76
4.2. Konkluzioni dhe rekomandimi 2 –Në lidhur me strategjitë hapësinore të qytetit të Prishtinës.....	76
4.3. Konkluzioni dhe rekomandimi 3- Në lidhur me vlerësimet që japin njerëzit e Prishtinës rreth nënkalimit me PPP për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban të qytetit.....	77
4.4. Konkluzionet dhe rekomandimi finale- Në lidhur me ZHQU të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban përmes PPP	77
4.5. Kahjet e ardhshme për studim	79
Bibliografia.....	81
ANEKSET	86

Përmbledhje ekzekutive

Pandemia e fundit, Covid 19 i ka dhënë qyteteve botërore leksione të fuqishme mbi konceptin e “qëndrueshmërisë”. Kështu edhe pala private e cila në të shumtën e rasteve vepron si aktor i pavarur ndaj zhvillimeve urbane, ka kuptuar që për të përfituar nga mundësitë dhe për të menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet, kompanitë duhet të vendosin qëndrueshmërinë në qendër të modelit të tyre të biznesit dhe të kontrollojnë qëndrueshmërinë e tyre në të ardhmen. (Haubensack, 2020). Kështu kontributi për t’u transferuar në një shoqëri relativisht johierarkale e cila është më se e nevojshme për zhvillimin e një qyteti konsiderohet obligim për çdo palë të interesit që përfaqësohet në mënyrë grupore sepse rreziqet i prekin të gjithë njerëzit pa dallim dhe vetëm përmes bashkëpunimit arrihet zhvillimi.

Në vitin 2015, Asambleja e përgjithshme e Kombëve të Bashkuara ka aprovuar Axhendën e Re urbane apo Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030 në të cilën Partneriteti Publiko-Privat është shfaqur si një mjet i rëndësishëm për arritjen e SDG-ve në lidhje me çështjet dhe problemet urbane (UN-Habitat, 2016). Objektiva e 11 synon që qytetet dhe vendbanimet njerëzore të bëhen më gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme (UN, 2018).

Për qytetet në tranzicion sikurse qyteti i Prishtinës, kriter minimal për stabilizimin e zonave urbane të cilat po ecin drejtë zhvillimit policentrik të qytetit, paraqet rëndësia e bashkimit të akterëve relevant lokal në trajtimin e sfidave urbane të qytetit në kuptimin e qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të mençur. Ndonëse një qytet praktikisht mund të jetë larg një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban si koncept multidimensional, vëmendje të duhur urbane duhet t’i jipet zonave të caktuara urbane ku adresohet konteksti urban në drejtim të përmirësimit të sigurisë, identitetit lokal, qasjes në banime dhe shërbime për qytetarë, qasja në rekreacion dhe vende të hapura, qasja në lloje të ndryshme të transportit, minimizimit të ndotjes, përdorimit efikas të tokës, qasshmërisë, diversitetit lokal, shkallës urbane, barazisë sociale etj.

Si dimension bazë shtesë i cili është shtruar në kornizën e Axhendës së Re Urbane është *dimensioni hapësinor* i cili përfshihet brenda dimensionit social, ekonomik dhe mjedisor, i cili realisht për qytetin e Prishtinës, si kryeqytet i një shteti të ri Kosovës, është dimension i më i anashkaluar në kuptimin logjik e praktik. Dhe për këtë ekzistojnë arsyet e shumta sikurse: qeverisja urbane shumë-niveleshe e padefinuar qartë në kompetenca, plane urbane të shpërndara, jo specifike por të përgjithësuara e shumë shkaqe të tjera.

Përderisa qytetet evropiane kanë teknologji gjeo-hapësinore të cilat parashikojnë qartë zhvillimin e qytetit dhe se kjo ndikon në atë që *planifikimi i qytetit po bëhet me shpejtësi një shkencë e caktuar si inxhinieri e pastër* (Ford, 1913). Për qytetin e Prishtinës planifikimi urban është shëndrruar në një gjueti të hapësirës në bazë të diskriminimit të skajshëm hapësinor të dokumentit “Harta zonale e Prishtinës” i cili është hartuar në bazë të Ligjit për planifikim hapësinor LPH-2003/14. Gjendja financiare është poashtu një barrierë e madhe për vendin mirëpo gjithashtu vlen të theksohet se shkalla e demokracisë së zhvillimit hapësinor është një lami krejtësisht në vete.

Në mënyrë që të optimizohet procesi i planifikimit hapësinor në raport me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të Prishtinës është e domodoshme zbatimi i indikatorëve urban të qëndrueshëm si dhe bashkëpunimi i formësuesve të shumtë urban për të arritur deri në ndryshime pozitive. Koncepti i

qyteteve nordike në lidhur me “qytet i qëndrueshëm” ka ardhur rrjedhimisht si rezultat i një përpjekje kohezive e bashkëpunimit të formësueve të shumtë urban për të arritur deri te ndryshimi i cili nuk ekzistonte më parë. (Nordregio Forum, 2017)

Në shembullin e qytetit të Prishtinës këta indikatorë janë përcaktuesit e parë për të ardhmen e qëndrueshme të saj prandaj ka edhe rëndësi shumë të madhe matja dhe përmbushja e tyre në zhvillimin hapësinor të qytetit.

Konteksti

Procesi i shpejtë dhe i pakontrolluar i urbanizimit në qytetin e Prishtinës duhet të përceptohet si kohë e rëndësishme për të reflektuar mbi transparencën në zhvillimin hapësinor/ urban të qytetit. Ashtu edhe vërtetohet se është një cikël rrethor ku urbanizimi shkon dorë me dorë me rritjen, ku askush nuk mund të mohojë që urbanizimi është thelbësor për transformimet socio-ekonomike, pasurinë e gjeneratave, mirëqenien dhe zhvillimin. (UN-Habitat, 2016) Në këto rrethana qyteti i Prishtinës duhet të njeh dhe përkufizojë vetvetën si “Shtëpi e Ekonomisë me bashkëpunim ndërkombëtar” (Van den Berg et al., 2004). Kështu sektori publik duhet të ndërmerret masa dhe veprime të cilat e fuqizojnë rolin e qytetit drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban në mënyrë që procesit të urbanizimit të shpejtë dhe krizave socio- ekonomike në vend të kthehen në mundësi për zhvillim. Në anën tjetër sektori privat duhet t’i bashkangjitet iniciativës për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban të qyteteve në mënyrë që t’i mbijetojë krizave, të shtojë efikasitetin në operacionet e tyre, të mbrojë investimet dhe të sigurojë shërbime më të mira për qytetarë. Një qytet i qëndrueshëm krijon një mjedis të qëndrueshëm të të bërit biznes por edhe siguron mirëqenien e duhur për qytetarë të bazuar në shumë kritere përtej “mbrojtjes së klimës” apo zhvillimit të infrastrukturës së nevojshme për zhvillim. Përderisa Partneriteti Publiko- Private konsiderohet indikator në teorinë e Kapaciteteve Organizative, mungesa e theksuar dhe mospërvoja në zbatimin e tyre në një qytet është tregues i rëndësishëm sa është një qytet i qëndrueshëm. Nisur nga ky parim, ky studim hipotezat i ka të mbështetura në këto fakte:

1. Implementimi i PPP është në favor të Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban për krijimin e bazamentit të një qyteti të qëndrueshëm pavarësisht qeverisjes lartë- poshtë të qytetit dhe formës së administrimit nga ana e institucioneve lokale, autoriteteve urbane dhe qasjes së partnerit privat apo autoritetit lokal në ekonominë qendrore dhe lokale.
2. PPP si mundësi për të rritur ndikimin dhe fuqinë e qytetarëve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes brenda planifikimit hapësinor.

3. PPP si mjet efikas financiar në periudha tranzitive të qyteteve si dhe periudha të krizave për zgjidhjen e problemeve urbane, ku fondi financiar komunal është i pamjaftueshëm për të mbuluar koston e shpenzimeve të projekteve të ndryshme.
4. PPP si mjet i qëndrueshëm për të zbatuar praktikisht parimet e Axfordës së Re urbane dhe Axfordës Territoriale edhe pse Kosova nuk është e anëtarësuar ende në Bashkimin Evropian.

Qëllimi i këtij hulumtimi është kuptimi i rëndësisë që ka Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban për qytetin e Prishtinës i cili është i panjohur si koncept teorik dhe praktik duke u promovuar përmes instrumentit të PPP.

Si rast studimor është marrë nënkalimi në lagjën “Bill Clinton” që kontribuon në zhvillimin hapësinor në shumë aspekte dhe rikonfirmon potencialin e qytetit për zhvillim kur brenda PPP janë përfshirë plotësisht i indikatorëve të ZHQU.

Për të projektuar të ardhmen e Prishtinës me Zhvillim të Qëndrueshëm Urban, punimi është nisur nga kjo shkallë e koncepteve, nocioneve, politikave dhe analizës përfundimtare të potencialeve të qytetit për një ZHQU:




Fig. 1. Baza teorike për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës, Burimi: Autori, (2021)

Potencialet, kushtet, legjislacioni dhe përvojat empirike në shëndrrimin e qytetit të Prishtinës si promoter i Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban përmes Partneritetit Publiko- Privat janë përfshirë në analizat sipas ndarjes:

Analiza e potencialeve të qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban;

- A. Analiza e pozitës së qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban;
- B. Analiza strategjike e qytetit;
- C. Analiza e pyetësorit;

Pyetjet kryesore hulumtuese në këtë studim janë:

1. *Cila është pozita dhe roli i qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban mbështetur në bazën e teorive moderne urbane?*
2. *Si adresohet Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe Partneriteti Publiko-Privat në dokumentet strategjike hapësinore në lidhur me zhvillimin e qytetit të Prishtinës?*
3. *Sa arrin të promovojë suksesshëm projekti i nënkalimit me Partneritet Publiko-Privat, Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës?*

Korniza teorike është shtjelluar në dy teori: Zhvillimin e bazuar në Njohuri dhe Kapacitetet Organizative dhe elaborimi i indikatorëve të tyre.

1.Cila është pozita dhe roli i qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban mbështetur në bazën e teorive moderne urbane?

Qyteti i Prishtinës në aspektin pozicional aktualisht nuk disponon një bazament për të konceptuar zhvillimin si proces i dukshëm që baraspeshon komponentëm ekonomike, sociale, mjedisore dhe institucionale, si kusht për arritjen e një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban. Përkundër asaj që Prishtina si qytet posedon vlera dhe qendra për tërheqjen e zhvillimit ajo ballafaqohet me sfida të shumta. Prishtina ka vlerat e veta të njohura si: vlerat historike dhe kulturore që mbështesin një mjedis atraktiv për zhvillimin e inovacionit dhe konkurrencës, popullatë të re të aftë për të prodhuar ide të orientuara drejtë BE-së me interesim për ndërmarrësi, prezencë të faktorit ndërkombëtar të gatshëm për të ndihmuar qytetin. Prania e Qendrës Klinike Universitare, Universiteteve, Bibliotekës, Objekteve kulturore, Parkut regional të Gërmisë, Pallatit të Rinisë, Teatros dhe qendrave multimediale etj. (Komuna e Prishtinës, 2013) Por vlerat nuk përkthehen në një zhvillim, qyteti kompromenton me fakte negative: si me nivelin e lartë të papunëve 60- 69% të pakualifikuar prej të cilëve 60% janë të grupmohave kryesisht të popullatës aktive prej 25-39 vjeç (Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, 2013), reflektim të shkallës së lartë të varfërisë prej 21.8 % (World Bank, 2009), kushteve të dobëta për zhvillimin e një mjedisi inovativ, kualiteti i dobët i arsimit universitar dhe parauniversitar, praninë e vonshme dhe të cekët të menaxhimit digjital në institucione, pamjaftueshmërinë e inicimit të inkubatorëve të biznesit në universitete, nivelit të ulët të standardeve që ofrojnë hapësirat në qendra arsimore dhe kulturore. Partneriteti Publiko-Privat do të ishte një urgjencë për qytetin. Zhvillimi i bazuar në Njohuri ndonëse me prurje dhe kapacitete të mëdha nuk shënon vlerë dhe rritje ekonomike në vend pa siguruar zhvillimin e frymës së partneriteteve. Disa prej universiteteve private tashmë kanë filluar të fokusohen në partneritete të shkëmbimit të studenteve, kuadrit arsimor dhe mjeteve me faktorin ndërkombëtar mirëpo ende ekzistojnë zbrazëtira në tregun e punës. Qendrat e arsimit nuk po prodhojnë vende të reja të punës për arsye të shumta ku infrastruktura bëhet pengesë për zhvillim mirëpo edhe qasja e institucionale ndaj zhvillimit si koncept. Gjuhët e huaja dhe aftësitë nga TIK konsiderohen si aftësitë/njohuritë më të vlefshme të rinisë për t'u kyçur në tregun global të punës, përderisa me fusha të tjera popullsia e përgjithshme mbetet me shkallë të lartë të papunëve. Kapacitetet për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban nuk promovohen sa duhet megjithëse Prishtina ka potencial për zhvillim të rinjëve, ide-bizneseve që duhet të mbështeteten përshkak barrierave për investime në inovacion dhe ndërmarrësi. Prishtina ka nevojë për të zhvilluar një kulturë identiteti autentik dhe vlerësimi dhe kjo duhet të potencohet si përparësi e qeverisë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit që të ngritet vetëdija në lidhur me kërkesat e industrisë së qytetit dhe kualifikimi arsimor i punëtorëve. Rol të rëndësishëm në përmirësimin e të ardhmes së Prishtinës luan mbështetja institucionale dhe lidhshipi i ri në ardhje. Aktualisht si inkubator biznesesh po shërbejnë vetëm universitetet private përderisa universitetet publike mbesin me një pjesëmarrje të ulët të ndikimit në zhvillim ekonomik të vendit, përmirësimin të praktikave të qyteteve të qëndrueshme, qasshmërisë, kualitetit të jetës dhe shkallës urbane. Ligji për konkurrencë i Kosovës ende ka nevojë që specifikohet edhe pse është

në përputhje me standardet e BE-së. Për zhvillimin e inovacionit duhet të rritet fuqishëm numri i grupimeve (cluster) për të inkurajuar shkëmbimin e njohurive dhe krijimin e një grupi të koncentruar të kualifikuar të punës. Kompanitë funksionuese duhet të jenë të hapura për bashkëpunim me universitetet për të komercializuar veprimtarinë kërkimore të cilat janë të vogla në krahasim me vendet e rajonit.

Mungesë të kapaciteteve organizative dhe investimeve në këtë sektorë për të udhëhequr role ndërmjetësuese ndërmjet akterëve të ndryshëm për të bërë biznes si dhe qeverisë përmes PPP. Ndërmarrjet e shumta janë pronë e ndërkombëtarëve ose blihen nga ata duke mos u përcjellur me menaxhim të transformimeve (aktiviteteve transformuese të pakta) nën udhëheqjen e liderëve të mirëkualifikuar me njohje ndërkombëtare jashtë vendit dhe përvojë të lartë në industrinë vepruese. Qyteti i Prishtinës nuk funksion ende si qytet- region ndonëse thirret me epitetin kryeqytet, kjo vërehet në mosharmonizimin jo vetëm të hapësirës por koncentrimin e shoqërisë, aktiviteteve ekonomike, mjedisore, kulturore- si elemente të shpërndara dhe jo si sisteme lokale- hapësinore të organizuara në shumë qendra. Shpërndarja e pakoordinuar urbane lë gjurmë në humbjen e hapësirave natyrore dhe të hapura, çka e shoqëron qytetin me probleme si: komunikacioni i ngarkuar, shpenzime financiare për shkak qasshmërisë së dobët, ndarjes sociale të popullsisë. Qyteti ka nevojë për krijimin e një imazhi ku promovohet një “vetëdije regjionale e qytetit” e cila prioritetizon rigjenerimin e resurseve natyrore dhe kulturën lokale në kuptimin e “qëndrueshëm” dhe PPP si përsheptues i zhvillimit.

2. Si adresohet Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe Partneriteti Publiko- Privat në dokumentet strategjike hapësinore në lidhur me zhvillimin e qytetit të Prishtinës?

Si plan strategjik hapësinor më i rëndësishëm në lidhur me të ardhmen e qytetit të Prishtinës shquhet Plani Zhvillimor Urban i Prishtinës i cili ka për qëllim të jetësojë synimet e Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020 dhe Planit zhvillimor komunal i Prishtinës në përpjekjet për arritjen e plotësimi të parimeve ndërkombëtare për një Zhvillim të Qëndrueshëm. Përmes këtyre strategjive tentohet të arrihet në një Zhvillim të Qëndrueshëm mirëpo koncepti Zhvillim i Qëndrueshëm Urban nuk figuron si synim për arsye se Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban ende nuk trajtohet si kompetencë e divizionit të planifikimit hapësinor si Departament përbërës i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit. Si dokumenti më i lartë i Planifikimit Hapësinor në Kosovë shquhet Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ i cili është krijuar në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur nga PSSP të KB, më 10 shtator 2003, përcakton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si subjekt bartës i përgjegjësisë për hartimin e tij. Ky dokument strategjik ka karakterin e një plani strategjik multisektorial ashtu siç përkufizohet në nivelin qendror. Fokusi kryesorë i tij qëndron në “Zhvillimin e ofruar policentrik” të qytetit si garant për një zhvillim të barabartë të komunave, fshatrave dhe zonave rurale në Kosovë. Ndonëse plani strategjik promovon një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban, Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-174 nuk bazohet në parimet dhe objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kështu sistemi nuk siguron një lidhshmëri dhe zbatueshmëri të koordinimit

territorial në bazë tri niveleve: nacional, regjional dhe lokal. Kështu lind nevoja e rivendosjes së niveleve të politikave evropiane brenda rregullimit hapësinor kosovar, ku proporcionaliteti, subsidiariteti dhe parimi i kompetencës mbizotërojnë. Strategjitë lokale aktualisht si rezultat do duhej të synonin një Zhvillim të balancuar territorial përmes krijimit të qytet-regjioneve, grupëzimeve dhe partneriteteve ekonomike e financiare të cilët do të kishin mbështetje ligjore për të plotësuar zbrazëtitat socio-ekonomike në ato qytet-regjione. Aktualisht, strategjitë e tanishme shënojnë përpjekje për të kufizuar indikatorët për Zhvillim të Qëndrueshëm, ato trajtojnë mesatarisht kriteret e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative të përcaktuara brenda prioriteteve territoriale për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban. Qyteti nuk njihet si subjekt i përkufizuar juridikisht sikurse përkufizohet në dokumentet evropiane. Territori i cili në njërin anë konsiderohet faktor kyç nuk ka fuqi implementuese në rastin e realizimit të njësisive territorialo- administrative të qytetit në të cilin zonat rurale nuk integrohen e as lidhjet strategjike të qyteteve të tjera përreth me qytetin e Prishtinës. Planifikimi hapësinor nuk bazohet në parimet si subsidiariteti horizontal, vertikal apo kohezionin territorial të nevojshme për të zgjeruar kooperimin në mes sektorëve. Nevoja për qartësimin e të dhënave hapësinore nga parashikimi jo i saktë i shifrave të popullsisë së qytetit do të reflektonte në një situatë më reale të ndjeshmërisë së problemeve dhe domosdoshmërisë së krijimit të zgjidhjeve. Ekziston një lidhje e dobët në mes planifikimit hapësinor dhe aplikimit të instrumentit financiar sikurse Partneriteti Publiko- Privat në krijimin e një qasje vendore të qytetit. Burimet e kufizuara financiare supozohen si pengesë për ndërmarrjen e ekspertizave të nevojshme në fushën e planifikimit hapësinor sa i përket zbatimit të projekteve të kohezionit e poashtu pjesëmarrja e kufizuar në fondet evropiane si: Instrumentet për asistencën e paraanëtarësimit (EBI, EBRD0, Institucionet e OKB-së). Përvoja e shtetit të Kosovës me PPP është kryesisht e re dhe daton nga 2008. Edhe pse vepron Ligji Nr. 04/L- 045 për Partneritet Publiko-Privat dhe Strategjia për Partneritete Publiko-Private për Republikën e Kosovës 2014- 2016, të cilat kryesisht bazohen në parimet e BE-së, qytetet janë ende në fazën e re të zhvillimeve hapësinore drejtë ZHQU. Sikurse ligjet për Partneritetin Publiko-Privat por edhe institucionet e saj kanë nevojë për një platformë të PPP në kontekstin e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban i strukturuar në bazë të objektivave të Agjendës Territoriale 2030 të Bashkimit Evropian dhe Axhendës së Re urbane. Sfidë për realizimin e PPP sipas dokumenteve strategjike të Republikës së Kosovës paraqet trajtimi i transaksioneve komplekse, për të cilën mungon ekspertiza brenda organizatave buxhetore qendrore dhe lokale, çka e vështirëson në të shumten e rasteve përgaditjen e zhvillimit të fizibilitetit dhe këshillave për transaksion, transparencën në planifikimin e buxhetit, zgjidhja e boshllëkut teknik në identifikimin dhe realizimin e transaksioneve si dhe boshllëkut financiar për financimin e angazhimit të këshilltarëve të transaksionit jashtë për nevojat e projektimit, zhvillimit dhe kryerjes së transaksioneve komplekse. si dhe me rëndësi shumë të madhe planifikimi paraprak i PPP me politikat e zhvillimit ekonomik, planeve buxhetore, nevojave për investime në kohën dhe vendin e duhur. Në fund nevoja për të investuar në PPP për një ZHQU duhet të rikthehet si prioritet për të ardhmen e qytetit të Prishtinës.

3. Sa arrin të promovojë suksesshëm projekti i nënkalimit me Partneritet Publiko-Privat, Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës?

Bazuar në realizimin e anketës me 90 pjesëmarrës të tri kategorive: pjesëmarrës nga autoriteti lokal (komuna e Prishtinës), tregtarët (duqanxhinjë brenda dhe jashtë nënkalimit) dhe kalimtarët (qytetarë brenda dhe jashtë nënkalimit) është matur plotësimi i indikatorëve të ZHNJ dhe KO në dy aspekte: në trajtë të përgjithshme (në bazë të llojit të indikatorëve dhe teorive për të gjithë pjesëmarrësit) dhe në bazë të rezultatit për kategori në lidhur me indikatorët dhe suksesit të teorive ZHBNJ dhe KO. Në bazë të interpretimit të rezultatit përmes tre kategorive pjesëmarrëse në hulumtim vihen dallime sa i përket teorive ku autoriteti lokal (Komuna) tregohet më e suksesshme, me rezultat gati të përafërt në dy teoritë rezultojnë kalimtarët kurse tregtarët me sukses më të madh në teorinë e Zhvillimit të bazuar në Njohuri. Indikatorët më të suksesshëm konsideroheshin baza ekonomike, qasshmëria, mbështetja sociale dhe mbështetja politike. Indikatorët me vlerësim neutral vlerësohen barazia sociale dhe diversiteti urban. Kurse indikatorë negativ nuk kishte. Në bazë të interpretimit të rezultatit të teorive urbane në përgjithësi, teoria e ZHBNJ vlerësohet me arritje të njëjtë me teorinë e KO. Në bazë të interpretimit të rezultatit të shumës së dy teorive ZHBNJ dhe KO, hulumtimi përmes anketës vlerësohet si projekt i suksesshëm, ashtu që prej 12 indikatorëve të gjithë rezultojnë si pozitiv. Roli i PPP në kontributin e tij drejtë ZHQU është i njohur më shumë në aspektin ekonomik por i panjohur në aspektin e qëndrueshmërisë, mençurisë dhe gjithëpërfshirjes. Qytetarët shprehen pro rritjes së llojit të tillë të investimeve duke siguruar mbështetjen e plotë sociale. Autoritetet lokale mbështeteshin politikisht lloje të tilla të investimeve për të cilat ende mungojnë përvojat e thella komunale të shfrytëzimit të PPP për një ZHQU të qytetit. Procesi i edukimit dhe huazimit të praktikave të qëndrueshme të BE mbi zhvillimin dhe fuqizimin PPP mbetet obligim për autoritetin lokal kurse komunikimi i vizionit dhe strategjisë në zhvillimin e bashkëpunimit dhe transparencës me qytetarë të Prishtinës nuk duhet të mungojë. Ekonomia lokale e Prishtinës është e favorshme për zbatimin e PPP, megjithatë modelet e PPP nuk promovohen sa duhet si instrument për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban të qytetit

Kapitina I - Hyrje

Në këtë punim trajtohet problematika e qytetit të Prishtinës, orientimi i rregullimit dhe zhvillimit të saj hapësinor/ urban drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban në kontekstin evropian, si qytet i mençur, i qëndrueshëm dhe inkluziv. Hulumtimi synon të vendos qytetin e Prishtinës si qytet i cili mund të ketë një të ardhme drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban nëse bazohet në plotësimin e indikatorëve të Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative, si teori moderne urbane dhe në bazë të objektivave të Axhendës së Re Urbane e Axhendës territoriale 2030.

Kosova si shtet i ri me urbanizim në rritje, në legjislacionin e saj hapësinor aktualisht nuk demonstroi se strategjikisht synon të integrojë perspektivën territoriale në zhvillimin e saj hapësinor qoftë duke përçuar mesazhe të plotësimit të parimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, objektivave të SDG, kohezionit territorial në promovimin e prioriteteve të Axhendës Territoriale apo thjeshtë përfshirjen e kohezionit territorial si *politikë hapësinore për të eliminuar pabarazitë ekonomike dhe sociale*. Megjithatë përballë këtyre sfidave, Prishtina nuk mund të përjashtohet si qytet pa potenciale për zhvillim me një të ardhme drejtë ZHQU. Rrënjet e konceptit Zhvillim i Qëndrueshëm Urban zënë vend në zbatimin e politikave të qëndrueshme urbane duke përcaktuar indikatorëve për zhvillim në secilin sektorë përbërës në bazë teorive moderne urbane të: Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Kapacitetet Organizative.

Në praktikë dihet nga përvoja dhe njohuritë që qytetet policentrike krijohen nga qytetet të cilat janë më të lidhura apo më të qasshme. Qyteti i Prishtinës është në drejtim të krijimit të një identiteti regjional të qytetit edhe pse nuk funksionon ende si qytet-regjion sëbashku me komunat fqinjë Lipjan, Fushë Kosovë, Kastriot dhe Podujevë. (Pallaska, 2014) Gjithësesi ky zhvillim nuk mjafton që të pritët që të ndodh ashtu që të njihet si kusht për zhvillim nëse Prishtina si qytet nuk siguron tani integrimin e PPP në ndërtimin e regjioneve të saja funksionale- si njëra prej prioriteteve të Axhendës Territoriale 2030 të Bashkimit Evropian, që do të ndikonte në rritjen e qëndrueshme ndonëse planifikimi urban kosovar nuk është i integruar ende në sistemin NUTS. Për këtë arsye në kapitujt në vazhdim do të shtjellohen dhe argumentohen fakte të shumta për situatën dhe zgjidhjet e qytetit të Prishtinës, me të ardhmen e saj si qytet i qëndrueshëm urban dhe potenciale të shumta për zhvillim.

Kapitulli i I-rë i punimit është i organizuar në pesë nënkapituj: objektivat, pyetjet hulumtuese dhe hipotezat, metodologjia dhe struktura e tezës.

1.1. Sfondi

Kuptimi ynë mbi qytetet, si në teori ashtu edhe në praktikë, është në një pikë kthesë. Zonat urbane në të gjithë botën përballen me sfida komplekse dhe me evolim të shpejtë.

Por cilat janë ndryshimet që kemi nevojë për transformimin e qyteteve tona në vendbanime të banueshme? Çfarë formash bën një qytet që frymëzon dhe angazhohet për qytetarët, qeveritë, sektorin publik dhe sektorët privat për të punuar së bashku? A është Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban koncepti më i mirë udhëzues për hartuesit e politikave, planifikuesit urbanë, arkitektët dhe investitorët në ndërtimin e qyteteve të së ardhmes? (Woo, 2013)

Zbulimi i kuptimit të qyteteve është një sfidë e madhe dhe mund të zgjasë më shumë ose më shumë se sa të zhvillojë një kuptim të plotë të trupit njerëzor. Në të vërtetë, meqenëse qytetet po bëhen platforma për pothuajse të gjithë jetën njerëzore, qyteti do të jetë një teori e gjithçkaje. (Harrison, 2017)

Ajo që Evropa ka prioritetizuar dhe synuar që nga Traktati i Romës e deri me sot janë: investimet në infrastrukturë, krijimin e një tregu të përbashkët ekonomik si dhe zbatimin e kohezionit territorial. Nga e njëjta strategji mund të përfitojnë qytetet në tranzicion të cilat përballen me një proces të shpejtë të urbanizimit. Për qytetin e Prishtinës, qytet i vendosur në Evropën juglindore të një shteti ende të ri Kosovës, urbanizimi duhet të përceptohet si kohë e rëndësishme për të shënuar pjekuri në zhvillimin hapësinor/urban të qytetit. Ashtu edhe vërtetohet se është një cikël rrethor ku urbanizimi shkon dorë me dorë me rritjen, ku askush nuk mund të mohojë që urbanizimi është thelbësor për transformimet socio- ekonomike, pasurinë e gjeneratave, mirëqenien dhe zhvillimin. (UN- Habitat, 2016) Normalisht përgjegjës për arritjen e një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban konsiderohet qeverisja urbane me qytetin e Prishtinës (niveli qendror dhe lokal) e cila i prodhon të gjitha dokumentet hapësinore/ urbane duke filluar prej Ligjit për Planifikim Hapësinor i një shteti që është burimi kryesorë për prodhimin e një mendësie të qëndrueshme territoriale. Implementimi i së cilës mendësi balancon ndërlidhjen ndërmjet strategjive, planeve, veprimeve dhe instrumenteve të qëndrueshme financiare për të shkaktuar procese drejtë arritjes së Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Qasja e qeverisjes urbane është shumë më rëndësi për shkak impaktit hierarkik të institucioneve, ligjeve, veprimeve dhe masave që burojnë prej lartë- poshtë deri në nivelin lokal (qytetet). Strategjitë nacionale hapësinore përcaktojnë efikasitetin e strategjive lokale hapësinore në cilat shprehet misioni i rregullimit hapësinor, territorit, regjioneve, qytetit dhe njësisive të qytetit. Megjithatë në qytetet ku rregullat ende janë në krijim e sipër duhet kërkuar mënyra të reja për të përforcuar potencialet e panjohura dhe resurset e pa udhëzuara të qytetit për zhvillim.

Në qytetet e Bashkimit Evropian, rregullimi hapësinor urban paraqet një “organizim territorial”, për shkak se territori nuk mirret vetëm me çështjen e rregullimit hapësinor por edhe me koncept-idenë e zhvillimit. Bëhët fjalë për një organizim që shënohet si përpjekje shumëdimensionale për të lidhur nivele të ndryshme sektoriale (ekonomike, sociale, mjedisore, institucionale) me nivele të ndryshme territoriale nacionale, regjionale dhe lokale si zhvillim i integruar hapësinor. Ashtu që qytetet të mos përfaqësojnë vetëm lidhjen hapësinore por edhe atë kohore, si qytete evropiane të së nesërme. Funkcionet e të cilave mundësojnë:

- Trajtimin e sfidave në një mënyrë të integruar dhe gjithëpërfshirëse;
- Përputhjen e qasjeve të bazuara në vend me qasjet e njerëzve;
- Kombinimin e strukturave formale qeveritare me ato fleksibile informale që korrespondojnë me shkallën në të cilën sfidat ekzistojnë;
- Zhvillimin e sistemeve qeverisëse të afta për të ndërtuar vizione të përbashkëta që bashkojnë objektivat konkurruese dhe modelet e zhvillimit konfliktual;
- Bashkëpunimin për të siguruar zhvillim koherent hapësinor dhe një përdorim efikas të burimeve. (European Union, 2021)

Një model i tillë lidhjeje, organizimi, koncentrimi të objektivave në planifikimin hapësinor sjellë përfitime të shumta ekonomiko- sociale dhe si mundësi për një të ardhme me Zhvillim të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës.

1.2. Lidhja e konceptit të territorit me kohezionin dhe roli i qytetit

Në dokumentet hapësinore evropiane koncepti “territor” është koncepti qendror të cilit i kushtohet vazhdimisht vëmendje institucionale në kontekstin e përforcimit të tij në nivele të ndryshme paralelisht me evolucionin e konceptit të kohezionit territorial si koncept kyç i Bashkimit Evropian, i cili është përkufizuar që nga Perspektiva Evropiane Hapësinore e vitit 1999 e deri më sot. Si nocion, kohezionit territorial është edhe koncepti ku ka investuar më së shumti Bashkimi Evropian por njëkohësisht është nocioni më i keqkuptuar nga ana e politikave dhe planerëve urban. (Medeiros, 2019) Në axhendën e BE-së nocionit i janë shtuar interpretime të ndryshme mbi sferën e veprimit sidomos në lidhur me zbatimin e tij në qytet. Bashkimi Evropian beson se ndryshimet që ndodhin në territor duhet të përcaktohen nga rregullat e njejta në hapësira të ndryshme duke përfituar nga:

1. Pikat e forta të secilit territor
2. Menaxhuar koncentrimin
3. Lidhur mirë territoret
4. Zhvillimin e bashkëpunimit (Komisioni për Komitetin Evropian, 2008)

“*Rimendimi i çështjeve territoriale*” është fryma kryesore evropiane e cila ka përcjellur deri më tani të gjitha ndryshimet dhe evolucionet graduale në zhvillimin e koncepteve të rregullimit hapësinor dhe zhvillimit të qyteteve. Nominimi i konceptit të kohezionit territorial nuk ka ndodhur mënjëherë në Axhendën Territoriale por si gradualitet i koordinimit të politikave urbane për të përforcuar dimensionin urban/hapësinor përmes kohezionit territorial, orientimit territorial të politikave sektoriale, implementimit të “*qasjes së bazuar në vend*”, ndryshimit të strukturës hapësinore të qytetit nga ajo monocentrike në policentrike e metropolitane etj. si rrjedhojë edhe evolucionin e

konceptit të qytetit. Ndërlidhja e planifikimit hapësinor bazuar në Zhvillimi territorial origjinën e ka nga Traktati i Lisbonës dhe Perspektiva Hapësinore Evropiane për Zhvillim dhe Axhendës Territoriale 2020. Në vazhdim paraqitet evolimi gradual i Zhvillimit hapësinor të Evropës dhe ngjizja graduale e koncepteve në lidhur më Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban, veçanërisht logjika e përceptimit të qytetit i lidhur me përceptimin e kohezionit territorial.



Fig. 2. Evolimi i koncepti të kohezionit dhe rolit të qyteteve në përbërjen e legjislacionit evropian hapësinor, Burimi: Autori, (2021)

Në perspektivën evropiane të politikave shumë-niveleshe vendimmarrëse promovimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban lidhet me faktin që qyteti gëzon atraktivitet të madh për shkak liberalizimit institucional të qyteteve në udhëheqjen e vazhdueshme të axhendave urbane evropiane dhe Paktit të Amsterdimit. Sipas kontekstit evropian urban qyteti duhet të gëzojë dy veti kryesore në mënyrë që të ushtrojë ndikim në procesin e politikave dhe vendimmarrjes:

1. Legjitimitetin
2. Njohuritë/ Dijën
3. Përvojën. (European Parliament, 2017)

Bazuar në nivelin nacional të planifikimit hapësinor të shtetit të Kosovës, qyteti si koncept dhe komunitet urban mbetet i padefinuar teoretikisht. Ky realitet e bën atë të përjashtuar nga roli i tij

kryesorë si promoter i Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Edhe pse është miratuar ligji për qytetin e Prishtinës, qyteti nuk ka ende bazë institucionale për të qenë i plotfuqishëm si bartës i Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Që të shëndrrohet në gjenerator të zhvillimit ekonomik dhe social nuk ka përse të përfshihet brenda konceptit të “Komunës” apo konceptit të “Zonës urbane”. Ndonëse objektivat hapësinore urbane kosovare janë në përputhje me kontekstin evropian të Zhvillimit të Qëndrueshëm, qyteti nuk figuron në përmbajtjen e këtyre objektiveve si burim i kohezionit territorial apo si identitet urban që përfaqëson zona të ndryshme me karakteristika unike- si një strukturë e qëndrueshme e njësisve urbane. Realisht mangësia e përkufizimit të njësisve më të thjeshta “lokacioneve urbane- si zona unike të qëndrueshme” në legjislacionin hapësinor nacional kosovar e pengon procesin e përforcimit të identitetit urban të qyteteve. Qasja tradicionale administrative e qeverisjes urbane kosovare nuk ka arritur të krijojë një balanc ndërmjet zhvillimit ekonomik, social, mjedisor dhe kulturor sepse integrimi i dimensionit territorial në përbërjen e politikave urbane ka munguar. Decentralizimi i qytetit të Prishtinës nuk ka ndodhur me hartimin e një ligji në emër të saj përderisa kompetencat e saja janë të shpërndara në përbërjen e ligjeve të tjera të ndryshme.

Sipas Ligjit për planifikim hapësinor Nr.04/L- 174 autoritet urban në shtetin e Kosovës është niveli qëndror dhe lokal i cili përkufizon komunat si udhëheqëse të qyteteve (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2013) Qeverisja urbane në legjislaturën e planifikimit hapësinor të shtetit të Kosovës nuk ka lënë hapësirë për të njohur zhvillimin si proces dhe transformimin e qyteteve si bazament për krijimin e regjioneve të ardhshme në të cilat zonat rurale- urbane shkrihen por nuk përjashtohen as nga mungesa e Komunës. Realisht Zhvillimi i Qëndrueshëm nuk mund të arrihet teoretikisht vetëm duke synuar “Promovimin e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm bazuar në nevojat publike dhe ekonomike; (1.9) “Promovimin e vazhdueshëm të harmonizimit me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe me parimet evropiane për zhvillim hapësinor; (1.10) “Zhvillimin e qëndrueshëm dhe proporcional të komunitetit, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase fondet publike; (1.11) Zbatimin e “parimeve ndërkombëtare të planifikimit hapësinor, zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisje në harmoni me normat e BE-së”; (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2013). Kjo për arsye se nuk njihet “qyteti si trupi kryesorë” përmes të cilit do të zbatoheshin këto synime. Kurse për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban do duhej të flitej për parimet e Axtendës Urbane Evropiane për Zhvillim të Qëndrueshëm sikurse: subsidiariteti, proporcionaliteti, parimi i kompetencës, kohezioni territorial. Bazuar në nivelin lokal të qeverisjes urbane të qytetit të Prishtinës, sipas Planit Zhvillimor Komunal 2011- 2022 , territori cilësohet si faktori kyç për krijimin e një vlere ekonomike dhe për të ndjekur një model të zhvillimit të qëndrueshëm. Si i tillë ai është vlerësuar si “çështje kryesore në çfarëdo lloj politike të zhvillimit, i cili siguron bazën racionale ku takohen të gjitha strategjitë sektoriale duke e përmirësuar cilësinë dhe duke rritur kohezionin social dhe qëndrueshmërinë e mjedisit.” (Komuna e Prishtinës, 2013) Por përderisa qeverisja urbane nuk aplikon një “qasje të bazuar në vend” e cila do të siguronte një koordinim të niveleve (nacionale, regjionale dhe lokale) me nivelet sektoriale (ekonomike, sociale, mjedisore e institucionale) nuk mund të flitet për praktikimin e dimensionit territorial në rregullimin hapësinor në nivelin evropian si tërësi. Kështu Bashkimi Evropian e përshkruan modelin e organizimit të strukturave të saja hapësinore me jo vetëm Evropë të regjioneve apo qyteteve por Evropë të politikave të qëndrueshme urbane. Një strategji e tillë e përcepton Zhvillimin e Qëndrueshëm

Urban si koordinim procesesh. Kjo strategji krijon produktivitet dhe kreativitet në gjetjen e zgjidhjeve për tejkalimin e gjendjeve të caktuara të zhvillimit ekonomik, social, kulturor, mjedisor të qyteteve të ndryshme ndonëse të përfshirë brenda një sistemi shumë-nivelesh të qeverisjes urbane të padefinuar qartë në sferën e veprimeve. Nëse qyteti i Prishtinës synon të bëhet *Prishtina, kryeqytet: i një cilësie të lartë jetese, tërheqëse për të jetuar dhe punuar. Qasje e mirë nëpërmjet rrjetit të infrastrukturës, materiale ose jo. Një ambient i favorshëm për një zhvillim inovativ dhe konkurrues* (Komuna e Prishtinës, 2013) ajo duhet të krijojë “minimumin e standardeve për zhvillimin e politikave hapësinore” (Ritter, 2003). Ky minimum nënkupton zbatimin e subsidiaritetit në tri format e tij sikurse e bën Bashkimi Evropian. Qeverisja urbane kosovare aktualisht ushtron vetëm subsidiaritetin vertikal (në nivelin nacional dhe lokal). Niveli regjional nuk është i zhvilluar ndonëse struktura urbane e qyteteve të mëdha është planifikuar në nivelet lokale për zhvillim regjional siç është rasti i qytetit të Prishtinës që si qendër policentrike filloi të bëhet realitet në vitin 2013. (Pallaska, 2014)

Subsidiariteti horizontal është i dobët. Komunat posedojnë kulturë të dobët të dialogimit dhe bashkëpunimit si formësues urbane sëbashku me akterë të tjerë sepse nuk dëshirojnë të eliminojnë strukturat e saja qeverisëse të cilat realisht po transformohen nga urbanizimi i shpejtë i Prishtinës.




Fig. 3. Subsidiariteti vertikal në Evropë dhe Kosovë, Burimi: Autori, (2022)

Subsidiariteti vertikal, i cili përcakton lidhjet vertikale të qeverisjes urbane në shtetin e Kosovës është dy nivelesh. Në planifikimin nacional- koncepti i ri për të cilën ka nevojë qyteti i Prishtinës është koncepti i bashkëpunimit të qeverisë me qytetet në mënyrë qytetet të jenë autoritetet më të larta urbane. Shteti ka nevojë për një subsidiaritet vertikal të drejtë (qyteti në krye të identitetit të

një shteti e jo anasjelltas) sikurse paraqitet në figurën e ilustruar më lartë sipas konceptit evropian. Kurse në aspektin e subsidiaritit horizontal zhvillimin e partneriteteve, koordinimeve apo relacioneve zhvillimore në mes sektorëve, zonave urbane-rurale, njërive të qytetit, qytetit me zonat përreth, regjioneve dhe shteteve. Rëndësia e të cilit konsiston në atë që subsidiariteti e formon një strukturë urbane të qëndrueshme ngase as vetë regjionalizimi nuk garanton rritjen e funksioneve të qyteteve drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban pa marrë parasysh që qyteti i Prishtinës synon një zhvillim policentrik sipas planit hapësinor të Kosovës 2010-2020.

Koncepti evropian mbi vizionin e qytetit të ardhshëm kërkon që të gjitha dimensionet e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të mirren në llogari në një rrugë të integruar. (European Union, 2011) Qyteti i Prishtinës e ka mundësinë që të implementojë të paktën subsidiaritetin horizontal në nivelin lokal përmes përfshirjes së qytetit në projektet e Partneritetit Publiko-Privat, përmes të cilit impakti territorial do të mund të matej jo vetëm në nivelet e programeve dhe politikave sektoriale por edhe në vetë projektet e planifikimit hapësinor nëse jo përmes subsidiaritit vertikal. Relacioni në mes të subsidiaritit horizontal dhe kohezionit territorial është ilustruar në vazhdim nga autori Umberto Janin Rivolin (2005).




Fig. 5. Subsidiariteti, kohezioni territorial dhe koordinimi në mes tyre, Autori: Rivolin Janin, U. (2005)

Në rastin e qytetit të Prishtinës, mungesa e subsidiaritit pengon implementimin e kohezionit megjithatë projektet individuale dhe hartimi i strategjive të përgjithshme hapësinorë në bazë në ZHQU mundësojnë zbehjen e ndikimit hierarkik të subsidiaritit vertikal në qytetin e Prishtinës. Arkitektura e organizimit social të qyteteve mund të ndryshojë ndonëse ka një subsidiaritet të gabuar që e pengon zhvillimin e një qyteti. Në këtë mënyrë lindin pyetjet se a duhet të vazhdojnë

të trajtohen vetëm problemet e mëdha në përmbajtjen e strategjive hapësinore në mënyrë gjenerale dhe problemet specifike si të tilla të trajtohen si projekte individuale me plane të veçanta? Kush duhet të jetë bartësi kryesorë i përcaktimit të planifikimit të shfrytëzimit të hapësirës dhe a mund të projektohet saktë çdo hapësirë? A duhet të besohet se probleme të caktuara urbane nuk mund të zgjidhen në Prishtinë, sepse planifikimi i saj hapësinor nuk mund t'i përballojë kërkesave për zhvillimin e qytetit drejtë ZHQU? Këto pyetje dhe një mori pyetjesh tjera janë më rëndësi për të ardhmen e arkitekturës urbane të Prishtinës.

Është i njohur fakti që një mënyrë për të zgjidhur çështjen e subsidiaritetit është duke e parë PPP në thelb si një instrument decentralizues, i cili favorizon decentralizimin mbi vendimmarrjen e centralizuar duke e përfshirë qytetin dhe qytetarët në fokus të zhvillimit të një projekti.

Sa i përket këtij hulumtimi objektivat kryesore janë:

1. Vlerësimin e potencialeve të qytetit të Prishtinës në arritjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban përmes plotësimit të indikatorëve të teorive moderne urbane;
2. Shqyrtimin e dokumenteve strategjike në lidhur me qasjen e tyre ndaj qytetit të Prishtinës në relacion me Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban dhe Partneritetit Publiko- Privat përmes koncepteve kyçe të teorive moderne urbane dhe indikatorëve të tyre;
3. Matjen dhe vlerësimin e plotësimit të indikatorëve të teorive moderne urbane në një projekt të Partneritetit Publiko – Privat në qytetin e Prishtinës, nënkalimi në lagjen “Bill Clinton” si rast studimor;
4. Nxjerrja e konkluzioneve të veçanta dhe të përgjithshme mbi promovimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës përmes PPP;

Objektiva e parë ka për qëllim të vlerësojë potencialet e zhvillimit të qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban nëse plotësohen indikatorët e teorive moderne urbane.

Objektiva e dytë ka për qëllim sqarimin e koncepteve kyçe nga teoritë moderne urbane, njohja e të cilëve është brumi i nevojshëm për krijimin e strategjive të qëndrueshme hapësinore, të autoriteve të qëndrueshme urbane dhe proceseve të qëndrueshme të planifikimit urban drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban pavarësisht kohës apo fazës së zhvillimit në të cilën ndodhet qyteti i Prishtinës.

Objektiva e tretë paraqet jo vetëm objektive por edhe instrument për të matur, vlerësuar dhe ndryshuar realitetin hapësinor në qytetin e Prishtinës. Qytetarët si gup social paraqesin input dhe output të rëndësishëm brenda kornizës së Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës. Kësisoj sa më tepër që projektet infrastrukturore i shërbejnë qytetarëve aq më i qëndrueshëm është projekti. Në anën tjetër pjesëmarrja në planifikim konsiderohet akti më i lartë për të balancuar politikat hapësinore kurse pjesëmarrja në vlerësim do të konsiderohet si tendencë për të zbehur dominimin e autoriteteve urbane në çështjet urbane që nuk mund t'i kontrollojnë, zgjidhin si dhe rrjedhimisht nuk janë të sigurtë për të besuar në atë se çfarë po e shkakon progresin apo regresin brenda planifikimit hapësinor. Nxjerrja e konkluzioneve nga analizat ndihmon në krijimin e një kuptimi të përbashkët mbi shembullin e zhvillimit të qyteteve evropiane të qëndrueshme ku PPP shihet si instrument efikas në tranzicionin e qyteteve.

Në vazhdim do të elaborohen këto objektiva sëbashku me pyetjet hulumtuese për të orientuar qytetin drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban dhe sqaruar bazën teorike dhe konceptet kryesore në rrugën e demokratizimit të planifikimit hapësinor të një shteti në tranzicion siç është Kosova.

1.3. Objektivat studimore

1.4. Pyetjet hulumtuese dhe hipotezat

Pyetjet kryesore hulumtuese janë:

1. Cila është pozita dhe roli i qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban mbështetur në bazën e teorive moderne urbane?
2. Si adresohet Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe Partneriteti Publiko- Privat në dokumentet strategjike hapësinore në lidhur me zhvillimin e qytetit të Prishtinës?
3. Sa arrin të promovojë suksesshëm projekti i nënkalimit me Partneritet Publiko-Privat, Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës?

Punimi përfshin edhe nënpyetje të tjera të trajtuara në shqyrtimin e literaturës:

- i) Çka është Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe cilat rrethana e përgadisin orientimin e qytetit drejtë një Zhvillimi të tillë?
- ii) Si duhet të identifikohet rruga e zhvillimit të qytetit drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban?
- iii) Cili është roli i Partneritetit Publiko- Privat në orientimin e qytetit drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban?

Korniza teorike 2.2. përbëhet nga teoritë, lidhja e konceptit të PPP me teoritë dhe korniza logjike analitike. Ajo ndahet në :

- 2.2.1. Ekonomia e bazuar në Njohuri
- 2.2.2. Roli i PPP në Zhvillimin e bazuar në Njohuri të qytetit
- 2.2.3. Rëndësia e promovimit të Zhvillimit të bazuar në Njohuri përmes PPP për qytetet në tranzicion (Teoria e Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe komponentet bazë)
- 2.2.4. Teoria e Kapaciteteve Organizative (definicioni, komponentet bazë)
- 2.2.5. Korniza logjike analitike

Hipotezat që do të vërtetohen në këtë punim janë këto:

1. Partneriteti Publiko- Privat arrin të orientojë suksesshëm qytetin e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.
2. Partneriteti Publiko- Privat nuk arrin të orientojë suksesshëm qytetin e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.

1.5. Metodologjia

Metoda kryesore e shfrytëzuar në këtë punim është ajo kualitative duke qenë se buron nga të dhënat kualitative me dizajn kërkimor të tipit përshtues (Analizat A dhe B) dhe shkak-pasojë (Analiza C). Burimet e shfrytëzuara në këtë punim janë primare dhe sekondare. Burime primare konsiderohen të dhënat e marra nga pyetësi kurse në burime sekondare përfshihen të dhënat nga shqyrtimi i ligjeve, raporteve dhe planeve vendore e ndërkombëtare sikurse Axfenda e Re Urbane, Axfenda Territoriale 2030, Ligji Nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+, Plani Zhvillimor Urban (PZHU) 2012-2022, Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës (PZHK) 2012-2022; Ligji Nr. 04/L- 045 për Partneritet Publiko- Privat; Strategjia për Partneritete Publiko-Private për Republikën e Kosovës 2014- 2016; Hyrje në Partneritetet Publiko-Private (Doracak për pjesëmarrës); Doracak për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkëpunimin komunal ndërkombëtar; Draft Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës; Ligji për Vetëqeverisje Lokale; Ligji për Kufijtë Administrativ Komunal; Ligji Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën. Literaturë ndërkombëtare nga legjislacionet evropiane mbi zhvillimin hapësinor si dhe planerë urban mbi shtjellimin e koncepteve evropiane mbi zhvillimin hapësinor dhe qytetin me synim Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban.

Punimi është i ndarë në tri pjesë: sfondi teorik, analizat dhe sinteza. Në sfondin teorik figurojnë dy teori: Teoria e Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Teoria e Kapaciteteve Organizative.

Në pjesën analizat përfshihen: Analiza e potencialeve të Prishtinës drejtë ZHQU, Analiza e pozitës dhe rolit të qytetit të Prishtinës drejt Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban (A), Analiza strategjike (B), Analiza e Pyetësorit (C) dhe Rezultatet (R1), (R2), (R3);

Në pjesën të gjeturat përfshihen: konkludimet (K1, K2, K3, Kf) rekomandimet (R1, R2, R3, Rf) dhe sugjerimet për kahjet e ardhshme të studimit.


Konkluzioni final (Kf) nxirret nga shuma e konkluzioneve $K1+K2+K3=Kf$ kurse rekomandimet e posaçme lidhen me konkluzionet e posaçme $R1=K1$, $R2=K2$ dhe $R3=K3$

Në shtjellimin teorik sqarohen më detajisht konceptet bazë të punimit “ Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban” dhe “ Partneriteti Publiko-Privat”. Kurse në vija më të trasha sqarohen teoritë e tjera si: Zhvillimit i bazuar në Njohuri dhe Kapacitetet Organizative duke u elaboruar në bazë të komponenteve (indikatoreve) që do të përdoren pastaj edhe në rastin studimor.

Në pjesën analizat, pikëspari vlerësohen potencialet e qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Më pas vlerësohet përmbushja e indikatorëve e të tri teorive urbane në rolin dhe pozitën e qytetit të Prishtinës si analiza A. Në analizën e dytë B parashtrahet qasja e dokumenteve strategjike mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban dhe Partneritetit Publiko-Privat.

Analiza e fundit C, "Analiza e pyetësorit" matë përceptimin e pjesëmarrësve në pyetësor (palës publike dhe private) i përbërë nga indikatorë të përzgjedhur të dy teoritë mbështetëse të studimit. Pyetësori realizohet me gjithsej 90 pjesëmarrës nga kategoria: Kalimtarë (brenda dhe jashtë nënkalimit) Duqanxhinjë apo tregtarët (brenda dhe jashtë nënkalimit), zyrtarë dhe punëtor komunal nga drejtoritë përkatëse si e infrastrukturës dhe planifikimit hapësinor etj (autoriteti lokal apo Komuna) Pjesa e fundit pasqyron të gjeturat nga analizat përmes rezultateve, që figurojnë në fund të çdo analize si dhe ajo përfundimtare si sintezë e të gjitha analizave. Në vazhdim lidhur me çdo analizë jepen rekomandimet për çdo konkluzion. Konkluzionet e veçanta krijojnë konkluzionin e përgjithshëm final. Në fund jepen sugjerimet e ardhshme dhe kahjet e ardhshme të studimit. Ecuria e metodologjisë është e sqaruar më poshtë në kornizën analitike.

Fig. 6. Korniza logjike analitike, Burimi: Autori, (2021)



1.5.1. Burimi i të dhënave

Në këtë hulumtim kemi përdorimin e dy lloje të burimit të dhënave: primare dhe sekondare.

- Të dhënat primare i hasim në pjesën e analizës së pyetësorit. Të dhënat sekondare i hasim kryesisht në pjesën teorike “Shqyrtimin e literaturës” dhe “Analizën e pozitës dhe rolit të qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban ” dhe “Analizës strategjike ”. Këto të dhëna figurojnë si të dhëna teorike të siguruara nga libra të autorëve vendas dhe ndërkombëtar, raporte, legjislacione, revista shkencore, statistika dhe figura të nxjerra në mënyrë elektronike.

1.5.2. Struktura e Tezës

Punimi është i ndërtuar nga katër kaptina. Dy kaptinat e para e krijojnë boshtin teorik të punimit përderisa dy kaptinat e fundit janë kryesisht analizë dhe sintezë. Kaptina I trajton: objektivat, pyetjet hulumtuese, hipotezat dhe metodologjinë.

Kaptina II trajton: shqyrtimin e literaturës rreth konceptit të Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban dhe Partneritetit Publiko- Privat në kontekstin evropian dhe rëndësinë e tyre të aplikimit në qytetin e Prishtinës. Roli i konceptit të kohezionit territorial për qytetin e Prishtinës në bazë të Axhendës territoriale 2030 dhe krijimi i strukturave kohezive përmes instrumentit të Partneritetit Publiko-Privat. Në vazhdimësi trajtohen konceptet e Teorisë së Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Teorisë së Kapaciteteve Organizative, definicionet si dhe komponentet (indikatorët) përbërës të tyre.

Kaptina III paraqet pjesën empirike të punimit- analizat dhe të gjeturat në tri seksione:

1. Analiza e pozitës dhe rolit të qytetit të Prishtinës; 2. Analiza strategjike; 3. Analiza e pyetësorit;

Kaptina IV paraqet pjesën e konkluzioneve dhe rekomandimeve të veçanta dhe përmbledhëse në lidhur me promovimin e një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban përmes Partneritetit Publiko-Privat në qytetin e Prishtinës, sugjerimet dhe kahjet e ardhshme për studim.

Kapitina II Sfondi teorik

Kjo kapitinë shtjellon literaturën vendore dhe ndërkombëtare në lidhur me dy teoritë moderne urbane: Teoria e Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Kapacitetet Organizative. Në këtë kapitull pasqyrohen poashtu konceptet kryesore si “Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban” dhe “Partneriteti Publiko-Privat”. Ndër të tjera si dokument bazë është marrë “Axxhenda e Re Urbane” dhe “Axxhenda Territoriale 2030” me objektivën bazë ndërlidhjen e katër shtyllave të Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban me qytetet si dhe kuptimin e implementimit të kohezionit territorial si shtyllë kryesore të Bashkimit Evropian, kusht themelor për krijimin e qyteteve të qëndrueshme.

Përderisa përmes indikatorëve të teorive moderne urbane përcaktohet pozita e qytetit të Prishtinës ndaj Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban, dokumentet hapësinore evropiane si “Axxhenda e Re Urbane dhe “Axxhenda Territoriale” kontribojnë në formësimin e strategjive hapësinore të qytetit të Prishtinës. Kësisoj studiimi paraqet një përpyjekje të ndryshuar gjendjen strategjike dhe faktike të qytetit të Prishtinës si qytet i qëndrueshëm, i qasshëm dhe gjithëpërfshirës. Në fokus të këtij hulumtimi qëndron “Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe Partneriteti Publiko- Privat” si promoter i saj. Si komponente të rëndësishme të Teorisë së Kapaciteteve Organizative, roli i PPP do të shqyrtohet nga aspekti ekonomik dhe i qëndrueshëm për zhvillimin e qytetit të Prishtinës.

2.1. Shqyrtimi i literaturës

Kjo pjesë e punimit ka të bëjë me konceptet dhe definicionet e Zhvillimit të Bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative, si teori mbështetëse të Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban dhe rëndësinë që ka Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban për qytetin si koncept dhe në veçant pozitën e qytetit të Prishtinës ndaj Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Në mënyrë që të kuptohen këto koncepte janë dhënë përgjigje ndaj pyetjeve sikurse:

1. Çka është Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe cilat janë forcat shtytëse drejtë një Zhvillimi të tillë?
2. Si duhet të identifikojë qyteti vetvetën drejtë një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban?
3. Cili është roli i Partneriteti Publiko- Privat në orientimin e qytetit drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban?

Këto përgjegjje janë dhënë në raport me hulumtimet e dokumenteve evropiane strategjike të zhvillimit urbano-hapësinor të Bashkimit Evropian, si origjinë themelore për konceptin “Qëndrueshmëri” dhe “Zhvillim”.

Në rastin e qytetit të Prishtinës, si dokument hapësinor është marrë “Axxhenda Territoriale 2030” dhe “Axxhenda e Re Urbane” që do të shërbejnë me qëllim të “rimendimit të koncepteve hapësinore” në kontekst të realitetit urbano- hapësinor kosovar. Kjo për arsye se realiteti urban është realitet konceptesh që duhet analizuar në shkallën e zhvillimit politik dhe institucional të një vendi. Kështu zhvillimi hapësinor/urban është pasqyrim i nivelit demokratik në një vend. (Pallaska, 2011).

2.1.1. Çka është Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe cilat janë forcat lëvizëse drejtë një zhvillimi të tillë?

Ndonëse tendenca për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban ka influencuar zhvillimin pozitiv të qyteteve sidomos në kohën e urbanizimit të shpejtë dhe rritjen e popullsisë urbane e cila sipas parashikimeve deri në vitin 2050 do të jetë rreth 70 % e popullsisë urbane e vendosur në qytete, qytetet kanë fituar vëmendjen kryesore në fushën e Zhvillimit të Qëndrueshëm. (UN, 2018) Koncepti i Zhvillimit të Qëndrueshëm sipas raportit Brutland në përkufizimin klasik, nënkuptonte vetëm zhvillimin që plotëson nevojat e tanishmes pa kompromentuar me aftësitë e brezave të ardhshme për të plotësuar nevojat e tyre (United Nations General Assembly, 1987). Ky përkufizim bazë nxjerr kuptimin mbi nocionin e qëndrueshmërisë duke e përceptuar atë si një lidhje të brezit të gjeneratave për të lënë resurse të mjaftueshme për zhvillimin e së ardhmes.

Me zhvillimin e shpejtë të urbanizimit qyteteve i është shtuar një komponente tjetër me rëndësi, roli i të cilës është vital për funksionimin e shtyllave të tjera të qytetit. Shtylla hapësinore ka lindur si kërkesë e re për të menaxhuar Zhvillimin e Qëndrueshëm përmes veprimeve publike në nivel urban dhe metropolitan duke përfshi praktikta konceptuale të zbatuara për përdorimin e tokës dhe planifikimit urban. (Gauthier, 2009)

Zhvillimet e fundit në infrastrukturën e transportit, komunikimit dhe teknologjisë së informacionit kanë rritur ndjeshëm rrjedhën e njerëzve dhe burimeve nga njëra zonë në tjetrën dhe kështu e kanë bërë dimensionin hapësinor edhe më të rëndësishëm. (Eurostat, 2001)

Përderisa si forcë lëvizëse për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban konsiderohen tri shtyllat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, në kohën e urbanizimit të hovshëm edhe *kultura* konsiderohet si forcë lëvizëse e cila manifestohet në forma të ndryshme sikurse densitet social, ekonomik, kreativ, ekologjik apo kulturor. (The Royal Swedish Academy of Engineering Sciences (IVA), 2017)

Axhenda e Re Urbane (New Urban Agenda) e konsideron kulturën si zemrën e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Si kriter i rëndësishëm për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban roli i saj njihet historitakisht por edhe është koncept ende i pa implementuar për shumë qytete. Brenda kontekstit të Zhvillimit të Qëndrueshëm politikat kulturore lokale e vënë zhvillimin e komunitetit në thelb, si mjet kyç dhe aspekt thelbesorë i strukturës shoqërore që promovon kohezionin, komoditetin dhe qytetarinë. (UCLG Habitat, 2016) Vështirësitë kryesore që e pengojnë kulturën e një qyteti të shëndrrohet në forcë lëvizëse ndaj Zhvillimit të Qëndrueshëm urban janë mitet konceptuale rreth kulturës.

Qyteti i Prishtinës është pothuajse i zhveshur nga ky koncept kyç për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban edhe pse në planet zhvillimore urbane Prishtina konsiderohet si qendër e kulturës por që aspak ska të bëjë në rrafshin e qëndrueshmërisë. Dhe për këtë ekzistonë faktorë të shumtë.

Për të përmirësuar performancën dhe rezultatet e planifikimit urban dhe zhvillimit në ndikimin e kulturës është e nevojshme që veprohet në këto kategori të përgjithshme:

1. **Kufizimi për shkak të kornizave legislative, politikave të synuara, kapanoneve burokratike dhe ngurrimit administrativ.** (pshm pyetja: Si mundet urbanizimi dhe planifikimi fizik të përqafojnë trashëgiminë dhe kulturën dhe t'i integrojnë ato në qëndrueshmërinë urbane, kornizat dhe programet e politikave?)
2. **Kompleksiteti i sektorit kulturor dhe tiparet kulturore të komunitetit.** (pshm pyetja: Si informojnë dhe lidhen mediat lokale me banorët në qytet?)
3. **Pamjaftueshmëria e treguesve, matjeve dhe vlerësimit të progresit dhe ndikimeve** (pshm pyetja: Si mundemi ne të dijmë se kultura po kontribuon në forcimin dhe pasurimin e qëndrueshmërisë lokale, reziliencës dhe zhvillimit holistik?)

4. **Çështjet themelore të pjesëmarrjes së qytetarëve, vëmendja ndaj gjinisë dhe tejkalimit të segmentimit.** (pshëm pyetja: Si mund të inkurajojmë dhe stimulojmë pjesëmarrjen demokratike të qytetarëve në formulimin, ushtrimin dhe vlerësimin e politikave publike mbi kulturën?) (UCLG, 2016)

Në anën tjetër në lidhur me termin “Qëndrueshmëri urbane” dhe “Zhvillim i Qëndrueshëm Urban” autorët Valentin dhe Spangenberg (1999) në institutin e Wuppertal, tri shtyllave të Zhvillimit të Qëndrueshëm i kanë shtuar edhe shtyllën e katërt “institucionale” apo “qeverisja urbane” Të paraqitur përmes prizmit me interaksione të shtyllave në mes vete (Urbact II, 2014)




Fig. 7. Prizmi i Qëndrueshmërisë, Burimi: Stenberg, J., (2001)

Kështu fushëveprimi dhe ndikimi i kulturës së qytetarëve manifestohet dhe ndikohet nga fushëveprimi dhe ndikimi i institucioneve në jetën e qytetarëve. Prandaj institucionet janë maja e piramidës ashtu që të realizohet synimet e Axshendës së Re urbane, për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban përmes i cili synon:

1. Ofrimin e shërbimeve bazë për të gjithë qytetarët;
2. Të sigurohet që të gjithë qytetarët të kenë qasje në mundësi të barabarta dhe të mos përballen me diskriminim;
3. Promovimin e masave që mbështesin qytete më të pastra;
4. Të forcohet qëndrueshmëria në qytete për të reduktuar rrezikun dhe ndikimin e fatkeqësive;

5. Ndërmerrën veprime për të adresuar ndryshimet klimatike duke reduktuar emetimet e tyre të gazeve serrë;
6. Respektohen plotësisht të drejtat e refugjatëve, migrantëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, pavarësisht nga statusi i tyre i migracionit;
7. Përmirësohen lidhjen dhe mbështesni iniciativat inovative dhe të gjelbra;
8. Promovohen hapësira publike të sigurta, të qasshme dhe të gjelbra. (UN, 2016)

Kurse sipas Axhendës territoriale 2030, për një të ardhme të qëndrueshme për të gjitha vendet dhe njerëzit në Evropë, kërkohen këto veprime bazuar në:

1. Një kuptim i përbashkët se nevojat e zhvillimit dhe ndikimet e së ardhmes ndryshojnë midis vendeve në Evropë, të cilat mund të rriten përmes shkëmbimet e njohurive dhe përvojave të marra nga zgjidhjet specifike të tyre dhe skemat e tjera të lidhura të mbështetjes;
2. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet vendeve, niveleve të qeverisjes, politikave, sektorëve dhe grupeve shoqërore për të adresuar çështje komplekse dhe për të shfrytëzuar potenciale të ndryshme, duke përfshirë politikën e kohezionit të BE-së, Politikën e Zhvillimit Rural, Interreg, ose mjete të tjera që nxisin zhvillimin e integruar territorial ose lokal; (Ministers for Spatial Planning and Territorial Development, 2020)

2.2.2. Si duhet të identifikojë vetvetën qyteti drejtë një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban?

Për arritjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban qytetet duhet të zbatojnë objektivat e Axhendës së Re urbane. Sipas Bankës Botërore, qytetet mund të arrijnë këtë përmes tri mundësive:

1. Financimin e Axhendës së Re Urbane;
2. Promovimi i zhvillimit territorial;
3. Rritja e rezistencës urbane ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të fatkeqësive. (2018)

Në politikat urbane evropiane territori është çështja e cila i kushtohet vëmendshmëri më të madhe ngase ai është burim i rritjes dhe konkurrencës. Misioni i tij është që të zbatohet gjithëfshirja e regjioneve, zonave ruralo-urbane dhe të krijohet barazi socio-ekonomike duke eliminuar pabarazitë. Komponentja e lidhshmërisë në Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban ndryshe përkthehet si “kohezion” si njëri prej komponentëve më qenësore për zhvillim. Megjithatë për shkak se qytetet ballafaqohen në një zhvillim në formë procesi, nën ndikimin e fuqishëm të urbanizimit global, *“çka vlen dhe është me rëndësi të përcillet gjatë procesit të urbanizimit janë burimi dhe shpejtësia si faktorë të zhvillimit të së ardhmes. (World Bank, 2013)* Duke njohur këto dy veti mund të përcaktojmë edhe llojin e qytetit që do të krijohet nëse mund të jetë qytet i gjelbërt, gjithëpërfshirës, rezilient, konkurrues, mbështetës i kohezionit apo jo. Në drejtim kundërt me procesin e urbanizimit ndodh edhe ndarja e qytetit në këtë rast ndikimi i procesit të fragmentimit hapësor mund të kontrollohet në tri mënyra:

1. Në mobilitetin urban;

2. Në strukturën natyrore;
3. Në jetën urbane sociale dhe ekonomike me implikime në shërbime publike; (Pinto et al., 2010)

Sipas Dovey (2016), për shumë njerëz dendësia është bërë diçka negative edhe pse logjikisht ajo përbën një burim për zhvillim. Ata që kërkojnë më shumë nga ajo, shpesh i shtojnë edhe fjalë apo fraza tjera si “Qyteti kompakt”, “Intensifikimi urban”, “Zhvillimi i orientuar tranzitiv” dhe “Qyteti 30 minutësh”. Sipas Bashkimit Evropian, kohezioni territorial duhet të përfshihet në:

- Rrjedhat dhe lidhjet (rrjetet, zonat funksionale, shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik);
- Nyjet hapësinore (struktura e vendbanimeve, grupimet, ekonomitë e aglomerimit);
- Përdorimi dhe organizimi hapësinor makro-gjeografik detar dhe tokësor (p.sh. ekosistemet);
- Asetet territoriale p.sh. struktura institucionale, peizazhet kulturore, identiteti dhe integriteti etj. (2011)

Në ndërtimin e qyteteve të qëndrueshme kohezioni territorial paraqitet si impakt i politikave të integruara urbane. Kështu në interpretimin fillestarë paraqitet *si konvergjencë socio- ekonomike* (në qytetet monocentrikë), ai ndërlidhet me zhvillimin e politikave regjionale apo inicimin e lidhjeve që shkaktojnë zhvillimin e rajonizimit. Kurse kur flitet për shfrytëzimin e *kohezionit territorial në kontekstin e zhvillimit hapësinor/ urban* paramendohet rregullimi i një zhvillimi të pabalancuar, një urbanizim i pakontrolluar, adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike, privimi apo shtirja urbane të trajtuara nga planifikimi hapësinor. (Netherlands Environmental Assessment Agency, 2009) Kurse ky interpretim i kohezionit është karakteristikë e shteteve me përvojë në zhvillim. Qytetet fillojnë të implementojnë rregullen e kohezionit territorial si shtyllë e rëndësishme për arritjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban duke organizuar pikësëpari mënyrën e jetësës së qytetarëve në atë qytet. Pra pjesëmarrja dhe mospërrjashtmi i atyre që kontribuojnë në një “kohezion social” e krijon harmoninë sociale e cila është garancioni më i madh për një zhvillim ekonomik dhe mjedisor. Bashkimi Evropian ka kuptuar nga traktatet e mëhershme që duhet të korrigjohen mosbalanci social me atë ekonomik. *Në mënyrë që të promovojë zhvillimin e tij të përgjithshëm harmonik, komuniteti do të zhvillojë dhe ndjekë veprimet e tij që çojnë në forcimin e kohezionit të tij ekonomik dhe social. Në veçanti, komuniteti do të synojë në zvogëlimin e pabarazive midis rajoneve të ndryshme dhe prapambetjen e rajoneve më pak të favorizuara (European Comission, 2003).* Pra zhvillimi i qytetit duhet të arrijë deri te favorizimi i qytetarit i cili është i pamundshëm pa ekzistencën e kohezionit në të gjitha format e tij. Qëllimi i kohezionit urban në qytete është të ndërlidhë diversitetin social, ekonomik apo kulturor me nocionin qëndrueshmëri. Andaj në fokus të debatit mbi politikat e kohezionit të Bashkimit Evropian qëndrojnë këto çështje të cilat lidhen me pyetjet sesi mundemi:

-të përfitojnë nga pikat e forta të secilit territor në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë më së miri në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të BE-së në tërësi;

-menaxhoni përqendrimin. Qytetet kanë ndikime pozitive dhe negative - duke intensifikuar inovacionin dhe produktivitetin në të njëjtën kohë me ndotjen dhe përjashtimin social;

-lidhni më mirë territoret. Njerëzit duhet të jenë në gjendje të jetojnë kudo që duan, me qasje në shërbimet publike, transport efikas, rrjete të besueshme energjetike dhe internet me brez të gjerë në të gjithë territorin;

-zhvillimi i bashkëpunimit. Efektet e ndryshimeve klimatike dhe bllokimi i trafikut nuk ndalen në kufijtë tradicionalë administrativë, ndaj nevojiten forma të reja bashkëpunimi midis vendeve dhe rajoneve. Strategjia e BE-së për rajonin e Detit Baltik dhe Strategjia e BE-së për rajonin e Danubit janë shembuj të qasjes së re makro-rajonale;

-nxitja e lidhjes urbano-rurale (Komisioni Evropian, 2020)

Rezultatet e kohezionit në qytete sipas Komisionit Evropian për politikën e kohezionit mund të arrihen përmes instrumenteve financiare që përfaqësojnë një rrugë të resurseve efektive të vendosjes së burimeve të politikave kohezive. (Denness, 2019) Qytetet evropiane kanë adaptuar regjenerimin urban si definicion të ri më rëndësi, si i tillë *regjenerimi urban është një zhvillim i qëndrueshëm i qyteteve... i cili është holistik në përpjekje dhe me objektiv në rihvillimin ekonomik dhe kulturor, kohezionit social dhe rehabilitimit fizik të qyteteve* (Eurocities, 1996). Gjithashtu qytetet evropiane e kanë përfshirë “Regjenerimin urban” edhe në objektivat e Partneritetit Publiko-Privat. Sipas kësaj *“Partneriteti Publiko-Privat luan një rol të rëndësishëm në regjenerimin urban dhe roli i tij nuk është i kufizuar në projektet e infrastrukturës kryesore.”*(European Regional Development Fund, 2006)

Kështu kohezioni territorial mund të paramendohet si yll me shumë dimensione për zhvillim i cili për t’u matur ka indikatorët e tij të veçantë.




Fig. 8. Ylli i kohezionit territorial, Burimi: Medeiros, E. (2016)

Bazuar në përvojën e gjerëtanishme të qytetit të Prishtinës në planifikimin hapësinor, termi “regjenerim urban” është termi më i keqkuptuar dhe keqinterpretuar në aspektin hapësinor nga autoritetet urbane kosovare qoftë ato publike apo private. Në lidhur me këtë term nuk kemi ndonjë definicion i cili përcakton masat, veprimet dhe qëllimin e regjenerimit urban si koncept i planifikimit hapësinor në Ligjin për planifikim hapësinor NR. 04/L-174. Rëndësia e ekzistimit të rigjenerimit urban në planin hapësinor konsiston poashtu në atë që do të ishte mundësi për të përfshirë edhe rëndësinë e pjesëmarrjes së formësuesve urban në proceset e planifikimit hapësinor. Meqe rigjenerimi urban është mundësi për të organizuar komunitetin në planifikim dhe zhvillim urban, roli i tij është i pakontestueshëm. (Beqaj, 2012) Gjithashtu mund të njihet qartë se a paraqet rigjenerimi urban njëkohësisht një ndërtim të përshpejtuar apo jo apo kemi dikotomi konceptesh.

Në rastin e qytetit të Prishtinës, kohezioni territorial do duhej të paraqitet si konvergencë socio-ekonomike duke përkufizuar kufinj të gjeo- hapësinor brenda një kulture të përgjithshme urbane lokalo- regjionale, meqë tashme paraqitet si zhvillim i strukturës policentrike. Kjo konvergencë shënon një përpjekje për të lidhur lagjet ndërmjet vete dhe synuar Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban. Partneriteti Publiko- Privat do të ndihmojë në përforcimin e këtyre lagjeve dhe hyrjen e tyre në procesin e rajonizimit. Në aspektin teorik qyteti duhet të përcaktojë sfidat territoriale në kontekstin evropian bazuar në synimet e Axhendës Territoriale duke krahasuar plotësimin e tyre në nivelin e politikave sektoriale (ekonomike, kulturore, mjedisore, institucionale). Në vazhdimësi asetat territoriale do të shëndrrojnë qytetin në qytet-regjion dhe qytet-metropol në sajë të bashkëpunimeve të shumta apo partneriteteve sikurse qytetet e tashme të zhvilluara e të qëndrueshme evropiane.

Shteti i Kosovës është shtet i pasur me resurset të shumta natyrore, kapital njerëzor dhe mundësi për zhvillim me nevojë urgjente për formimin e një identiteti të ri territorial të qyteteve. Ndonëse politikat aktuale urbane të zbatueshme në qytetin e Prishtinës nuk e përfshijnë idenë e të menduarit territorial, dimensionin e kohezioni territorial mund të përfshihet në përforcimin e funksioneve të poleve regjionale.

2.1.3. Cili është roli i PPP në orientimin e qyteteve drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban?

Platforma Globale për Qytete të Qëndrueshme (GPSC) e lancuar në vitin 2016 nën udhëheqjen e Bankës Botërore (World Bank) synon një përpjekje holistike për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në qytete. Si pjesë e kësaj platforme është zhvilluar një kornizë e qëndrueshmërisë urbane e përbërë nga pesë komponente:

- i) Indikatorët e Qëndrueshmërisë
- ii) Procesi i Diagnostifikimit;
- iii) Plani i veprimit për Qëndrueshmëri;
- iv) Financimi dhe Investimet;

v) Procesi i implementimit të Kornizës;




Fig. 9. Korniza e Qëndrueshmërisë Urbane e GPSC, Burimi: World Bank, (2017)

Financimi i qyteteve të qëndrueshme përmes Partneritetit Publiko- Privat nuk paraqet mënyrë të re të investimeve në krijimin e qyteteve të qëndrueshme për Bankën Botërore (World Bank). Sipas saj , PPP -të janë të rrënjosura në të njëjtën qasje të integruar si SDG –të (Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm). Secila komponentë duhet të ndiqet si pjesë integrale e tërësisë, pa të cilën rezultati nuk është i mundur. (Mohieldin, 2018) Shikuar në esencën e termit të PPP:

“Qëllimi i partneriteteve është shfrytëzimi i sinergjisë së burimeve të përbashkëta inovative dhe zbatimit të menaxhimit të njohurive për arritjen optimale të qëllimeve të të gjitha palëve të involvuara, aty ku kjo optimale nuk mund të arrihet në të njëjtën masë pa pjesëmarrjen e palëve të tjera.”(Jomo&Chowdhury, 2009)

Rikujtojmë që kushtet themelore që definojnë Partneritetin Publiko- Privat janë:

1. Marrëveshje (ndërmejt aktorit privat dhe publik ose palëve);
2. Furnizimi dhe Sigurimi (i shërbimeve me benefite publike nga partneri privat);
3. Ndarja e rrezikut (optimalisht ndërmjet palëve të marrëveshjes);
4. Standardet (fokusi në kualitetin e shërbimeve/ përformancën);
5. Investimi (në/ dhe menaxhimin e aseteve publike nga partnerë privat, partneri publik nuk blen asete por shërbime);
6. Pagesa e lidhur për performancën;
7. Periudha kohore (për një kohëzgjatje të caktuar);




Fig. 10. Shtatë kushtet që definojnë Partneritetin Publiko- Privat, Burimi: Ohiani, J. A. M., (2014)

Roli i organizatave botërore që promovojnë Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban duhet të përqëndrohet në mbushjen e “zbratësisë” (eng. gap) në mes sektorit publik dhe privat në lidhur me SDG-të. Meqënëse qyteti si krijesë duhet të gjenerojë zhvillimin, edukimi i autoriteteve lokale urbane është kusht për një Partneritet Publiko- Privat të sukseshëm që sjellë shërbime më të mira publike. (Mohieldin, 2018)

Në pikëpamjet e të ardhmes së zhvillimit territorial të qyteteve, si karakteristikë e qyteteve të përforcuara evropiane në kuptimin e qëndrueshëm, inkluziv dhe të mençur sepse “territori” paraqet asetin kryesor për zhvillim, promovimi i vlerave territoriale jo rastësisht është realizuar përmes konceptit të PPP.

Pa një vizion të bindshëm të orientuar kah e ardhmja mbi zhvillimin territorial të Evropës gjatë dytri dekadave të ardhshme do të jetë e vështirë për të arritur sinergji në shumë politika të sektorëve dhe akterëve. (Martin et al., 2018) Nga kjo problematikë e identifikuar BE ka zgjedhur PPP si burim kryesorë për një Zhvillim të Integruar Territorial përmes Fondit për Kohezion dhe Strukturë. (European Court of Auditors, 2018) Rruga e shfrytëzimit të Partneritetit Publiko- Privat drejtë një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban është më e integruar sesa përpjekja e kapaciteteve institucionale për të mbyllur dobësitë financiare e strukturore për një perspektivë territoriale të qytetit. Në lidhje me promovimin e kombinimit të burimeve PPP dhe Kohezionit, BEI (Banka Evropiane e Investimeve) ka luajtur tre role kryesore: ofrimin e shërbimeve të asistencës këshillimore dhe teknike, mbështetje direkte financiare (p.sh. bashkëfinancimi i projekteve të Politikës së Kohezionit) dhe mbështetje indirekte nëpërmjet shërbimeve të menaxhimit të fondeve (p.sh. mandatet për të menaxhuar fondet mbajtëse të mbështetura nga ERDF).

Kosova si shtet i ri ka përvojë të kufizuar në lidhje me vetë konceptin e PPP, i cili ka filluar të përdoret nga viti 2008 (Ligj ky i cili është shfuqizuar në bazë të Ligjit për Partneritetin Publiko Privat nr. 04/L-045 që ka hyrë në fuqi më 11 Dhjetor 2011). Sipas këtij Ligji, Partneritet Publiko-Privat definohe si:

“çdo bashkëpunim kontraktues ose institucional në mes të një ose më shumë autoriteteve publike dhe një ose më shumë partnerëve privat sipas të cilit partneri privat:

- ofron një shërbim publik ose infrastrukturë publike në emër të autoritetit publik;
 - merr përsipër rrezikun financiar, teknik, ndërtimor dhe operativ, duke përfshirë rreziqet e kërkesës dhe/ose disponueshmërisë, në lidhje me ofrimin e shërbimit publik ose infrastrukturës publike;
 - pranon përfitimet nga ofrimi i shërbimit publik ose infrastrukturës publike në formë të:
 - o pagesës nga autoriteti publik nga buxheti i autoritetit përkatës publik;
 - o taksave ose tarifave të mbledhura prej partnerit privat nga përdoruesit ose klientët e shërbimit publik ose infrastrukturës publike që u ofrohet atyre; ose
 - o një kombinimi të pagesës dhe taksave ose tarifave të lartpërmendura.”
- (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2011)

Megjithatë Partneriteti Publiko-Privat është shikuar vetëm si mjet financiar për përmirësimin e infrastrukturës por jo edhe qëndrueshmërisë apo politikave në arritjen e SDG-ve.

Institucionet kryesore që mirren me çështjet e PPP në Kosovë janë: Komiteti për Partneritetet Publike-Private (KPPP) dhe Departamenti për PPP (DPPP). Kurse dokumentet kryesore që mirren me politikave të PPP janë: Ligji për Partneritetin Publiko-Privat nr. 04/L-045, Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publiko-Private për Republikën e Kosovës 2014- 2016.

Komiteti për PPP-të është organi kryesorë i ngarkuar me mbikëqyrjen dhe koordinimin e sistemit dhe të politikave të PPP-ve të Kosovës. (Republika e Kosoves, 2012)

Edhe pse vendimi i qeverisë sipas direktivës së vitit 2008, shpall PPP si prioritet kombëtar, sistemi i partneriteteve publike-private (PPP) në Kosovë ballafaqohet me sfida të shumta:

- transparencën në planifikimin e buxhetit (në sajë të ngritjes së kapaciteteve për planifikim të PPP duke e ndërlidhur atë me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe me kornizën afatmesme të politikave me prioritet, si dhe proceset e përcaktuara brenda dokumenteve sikurse PPAM (Politikat Prioritare Afatmesme), PVVZHE (Plani i veprimtimit për vizionin e zhvillimit ekonomik), PIP (Programi i investimeve publike) të jenë të përputhshme me proceset e hershme të planifikimit të PPP;
- zgjidhja e boshllëkut teknik në identifikimin dhe realizimin e transaksioneve si dhe boshllëkut financiar për financimin e angazhimit të këshilltarëve të transaksionit jashtë për nevojat e projektimit, zhvillimit dhe kryerjes së transaksioneve komplekse;

- planifikimi paraprak i PPP me politikat e zhvillimit ekonomik, planeve buxhetore, nevojave per investime ne kohën dhe vendin e duhur (udhëzimi i partnerëve publik dhe privat nga ekipet me përvojë ndërkombëtare në zbatimin e PPP) (Republika e Kosovës, 2014);

Sipas strategjisë për Zhvillimin e Partneriteteve Publik- Private 2014-2016, Kosova ka vështirësi në trajtimin e transaksioneve komplekse, për të cilën mungon ekspertiza brenda organizatave buxhetore qendrore dhe lokale, çka e vështirëson në të shumten e rasteve përgaditjen e zhvillimit të fizibilitetit dhe këshillave për transaksion. Procesi i transaksioneve të PPP në Kosovë kalon në këto katër faza:

1. Analiza e para-fizibilitetit;
2. Zhvillimi dhe rishikimi i dokumenteve të transaksionit
3. Zhvillimi i tenderit;
4. Menaxhimi i kontratës së PPP-së.

(DPPP, 2021)



Fig. 11. Procesi i PPP-së në Kosovë, Burimi: Republika e Kosovës, Ministria e Financave, (2014)

Të ndalemi të procesi i planifikimit, përzgjedhja e projektit të PPP në lidhur me dendësinë urbane ka rëndësi të madhe në lidhur me nevoja më të mëdha të qytetarëve në lidhur me shërbimet publike.

PPP si instrument financiar, globalisht paraqet një prej zgjidhjeve të mundshme për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në plotësimin e objektivave për ZHQU. Megjithatë shtetet e ndryshme kanë

përvoja të ndryshme me PPP, shkak i qëndrimit të ndryshëm të politikave përballë konceptit të qytetit dhe vetë termit të qëndrueshmërisë por edhe ndaj vetë PPP. Poashtu çështja është më komplekse sepse është vërtetuar që ndikimi i PPP -ve ndryshon shumë nga sektori në sektorë. (Sharma, 2016) Prandaj ekzistojnë mendime të ndara mbi suksesin e PPP në zhvillimin e qyteteve si dhe modelin me të përshtatshëm të përzgjedhjes së tyre.

Në bazë të Ligjit për Partneritet Publiko- Privat (neni 6) në Kosovë, kemi këto lloje të PPP të cilat përcaktohen në bazë të aktiviteteve në vijim ose formë e kombinuar:

- 2.1. *projektimi, ndërtimi, financimi, mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës së re publike;*
- 2.2. *riparimi, modernizimi, financimi, zgjerimi, mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukture ekzistuese publike; dhe/ose*
- 2.3. *administrimi, menaxhimi, operimi, mirëmbajtja ose shërbimet tjera që i përkasin shërbimeve publike ose infrastrukturës së re ose ekzistuese publike.*

Sipas nenit 7 kemi Partneriteti Publiko- Privat kontraktues në formë të:

- 1.1. *koncesionit, ose*
- 1.2. *kontratës Publike, me kusht që në bazë të kësaj kontrate publike partneri privat:*
 - 1.2.1. *ofron një shërbim publik ose infrastrukturë publike në emër të Autoritetit.*
 - 2.1. *ofron një shërbim publik ose infrastrukturë publike në emër të Autoritetit Publik;*
 - 1.2.2. *merr përsipër rrezikun dhe përgjegjësitë financiare, teknike, ndërtimore dhe/ose operative në lidhje me ofrimin e shërbimit publik ose infrastrukturës publike;*
 - 1.2.3. *pranon pagesa të rregullta nga Autoriteti Publik për ofrimin e shërbimit publik ose infrastrukturës publike, pagesa këto që mund të jenë në formë të pagesave të njëanshme, dhe që pasqyrojnë rrezikun e disponueshmërisë, kërkesës ose ndërtimit që është marrë përsipër nga partneri privat.*

Sipas nenit 8, Partneriteti Publiko-Privat institucional:

1. *Një partneritet publiko-privat institucional mund të themelohet nga një komunë përmes blerjes nga një ose më shumë partner privat të aksioneve të komunës në një ndërmarrje publike ekzistuese funksioni i vetëm i së cilës është kryerja e një shërbimi publik ose ofrimi i një infrastrukture publike, me kusht që partneri privat po ashtu merr pjesë në drejtimin e ndërmarrjes publike ose merr pjesë në kryerjen e shërbimit publik ose ofrimin e infrastrukture publike.*
2. *Nëse themelimi i një partneriteti publiko-privat institucional kërkon shitjen e aksioneve në një ndërmarrje publike e cila është në pronësi të Republikës së Kosovës, atëherë themelimi i këtij partneriteti publiko-privat institucional i nënshtrohet miratimit të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.*

Përzgjedhja e modelit të PPP varet nga disa faktorë dhe procesi i vlerësimit të autoritetit publik në lidhur me sfidat e qytetit dhe prioritetet për zhvillimin e tij. Sipas *The Global Urban Economic*

Dialogue Series (2011), Partneriteti Publiko-Privat duhet t'i ketë parasysh këto tetë parime qeverisëse për të qenë i suksesshëm në kontekstin e zhvillimit urban:

- Interesi publik është me rëndësi;
- Praktikrat e mira në përgjegjësi dhe masat e transparencës duhet të mbahen gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit;
- Një projekt i PPP duhet të jetë i planifikuar me kujdes, i përcaktuar mirë në sferën e tij dhe thelbësisht i qartë me objektivat e tij;
- Nevojitet realizueshmëria e projektit të matet kundrejt kritereve të përcaktuara nga partneri iniciues për ta ndihmuar atë duke përcaktuar përshtatshmërinë e tij të mundshme për PPP të prokurimit;
- Modeli i përzgjedhur i PPP duhet të ofrojë vlera për para në aspektin e kostos dhe kursime të kohës me konsideratë të duhur në transferimin e rrezikut;
- Procesi i tenderimit PPP duhet të jetë konkurrues, i drejtë dhe subjekt me kujdes të duhur nga ana e partneritetit. Një sektor urbanistik PPP duhet të pasqyrojë nevojat e komunitetit të prekur dhe duhet të integrohen si prioritete të akterëve kryesorë të projektit;
- Projekti duhet të menaxhohet me përgjegjësi gjatë gjithë afatit të marrëveshjes, me parashikueshmërinë dhe prioritetet e përcaktuara nga partneriteti;

Në anën tjetër qytetet duhet të plotësojnë komponentet për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban e që janë bazë për mbjelljen e planifikimit territorial të qyteteve:

- Promovimi i Zhvillimit policentrik dhe të balancuar territorial;
 - Inkurajimi i Zhvillimit të integruar në qytete, fshatra dhe regjione specifike;
 - Integrimi territorial në zona kufitare dhe transnacionale të regjioneve funksionale;
 - Sigurimi i konkurrencës globale të regjioneve të bazuar në ekonomi të forta lokale;
 - Përmirësimi i lidhjes territoriale për individët, komunitetet dhe ndërmarrjet;
 - Menaxhimi dhe lidhja e vlerave ekologjike, peisazhore dhe kulturore të regjioneve;
- (MNDE, 2011)

2.2. Korniza teorike

Kjo pjese e punimit trajton: 1. Teorinë e Zhvillimit të bazuar në Njohuri (definicioni, kriteret e definicioneve përmes Ekonomisë së bazuar në Njohuri) 2. Teorinë e Kapaciteteve Organizative (definicioni, kriteret e definicioneve). 3. Korniza logjike analitike e hulumtimit.

2.2.1. Ekonomia e bazuar në Njohuri

Ekonomia e Bazuar në Njohuri qytetet i konsideron si burime të dijës. Mirëpo jo të gjithë qytetet arrijnë të kalojnë suksesshëm tranzicionin drejtë ekonomisë së bazuar në njohuri. Qytetet dallojnë për nga disa kriteret të cilat konsiderohen si “shtyllat e regjioneve urbane” të cilat synojnë drejtë Zhvillimit të Bazuar në Njohuri përmes zhvillimit të *resursit human* dhe *industrive të bazuara në njohuri* si dy aspekte dinamike urbane. Qytetet e mençura në axhendën e tyre përfshijnë zhvillimin e resursit human kryesorë me të cilën lidhet zhvillimi i një vendi.

Zhvillimi i “resursit human”, këtu nënkupton njohjen se a po krijohet një popullsi urbane e bazuar në më shumë njohuri (dije) kurse zhvillimi i industrive nënkupton njohjen e zgjerimit të sektorëve drejtë njohurive dhe sesi industritë e vjetra bëhen më të ditura. Të dyjat paraqesin sfida për regjionet urbane përderisa mungon zhvillimi i kapaciteteve organizative (qeveria dhe qeverisja) e cila është urë lidhëse ndërmjet shtyllave (kriterëve) dhe proceseve për zhvillimin e regjioneve urbane. Kësisojti ndërrimet dhe ndryshimet në qeveri dhe qeverisje kanë shkaktuar edhe ndryshime ekonomike. Paqëndrueshmëria dhe pabarazia ekonomike janë pasqyrë e një qeverie dhe qeverisje aktuale. E dyta sa i përket *Industrive të bazuara në Njohuri*, si faktor kyq në krijimin dhe zgjerimin e tyre në qytete janë format dominante e shtrirjes së tyre është krijimi i grupëzimeve (eng. cluster) të industrive të bazuara në njohuri. Këto *qendra të dijës* konsiderohen si forca shtytëse të ekonomive lokale dhe rajonale. Si shembull konkret janë industria e automobilave në Detroit, prodhimi i çipave kompjuterikë në Silicon Valley të Kalifornisë, sektorin financiar të Londrës, prodhimin e verës së Luginës Napa dhe industrinë e prodhimit të filmave të Hollivudit etj.

Në përgjithësi: tri forcat shtytëse të ekonomive moderne të bazuar në njohuri konsiderohen: globalizimi (unifikimi i prodhimit, tregtisë, financave, mjeteve të komunikimit dhe teknologjisë së informacionit, kërkimit shkencor, konkurrencës dhe fushave të tjera), njohuritë/ dijet (me kusht: kapitali intelektual), ndryshimet (krijimi i pasigurisë dhe rrezikut, zvogëlimi i parashikueshmërisë). (OECD, 2001)




Fig. 12. Nurmi i qyteteve të mençura (smart) në Evropë, Burimi: Unioni Evropian (2014)

2.2.2. Roli i PPP në Zhvillimin e bazuar në Njohuri të qytetit

Partneriteti Publiko-Privat në ekonomine moderne të Zhvillimit në Njohuri shfrytëzohet si përshpejtues i rritjes së bazuar në inovacion. Për dallim nga format tradicionale të prokurimit, PPP siguron disa përfitime sikurse:

- PPP i orientuar drejt rezultateve në sektorin publik synon të përmirësojë cilësinë e shërbimeve publike dhe udhëzimet në rezultatin e tij përfundimtar;
- Transferet e parave nga sektori publik në arritjen e shërbimit të dëshiruar nga sektori privat (sigurimi i produktit ose shërbimit të dëshiruar duhet të jetë me vëllimin dhe cilësinë e synuar);
- Qasja gjithëpërfshirëse në hartimin, zhvillimin dhe funksionimin - në vlerësimin e përmbushjes së një partneriteti publik -privat, vlera e mjeteve për të arritur rezultatin përfundimtar nuk krahasohet, por kostoja e ofrimit të produktit ose shërbimit përfundimtar. (Vutsova, 2014)

Kohët e fundit, qeveritë lokale po promovojnë aktivitete të bazuara në njohuri nga dëshira për të krijuar aktivitete me rritje të lartë dhe punë me cilësi të lartë në qytetet e tyre. Pushtetet lokale po përdorin Partneritetin Publiko Privat për të ofruar politika dhe programe të bazuara në njohuri, si qendrat e inovacionit, që janë në të vërtetë sjellje sipërmarrëse dhe inovative.

(Morisson, 2017) Sidomos për qytetet në tranzicion, krijimi i qendrave inovative përmes Partneritetit Publiko-Privat për shkëmbimin e njohurive/ dijeve shërben si mundësi për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik të qyteteve. Përveç transferit të dijeve, partneritetet mundësojnë edhe shkëmbimit të trendeve të ekonomisë dhe kulturës globale të qyteteve të zhvilluara kësajsoj qytetet synojnë të krijojnë rrjetëzime në fusha të ndryshme të zhvillimit.

2.2.3. Rëndësia e promovimit të Zhvillimit të Bazuar në Njohuri përmes PPP për qytetet në tranzicion

Nëse Zhvillimi i bazuar në Njohuri përceptohet si një “kulturë e re ekonomike” çdo qytet në tranzicion ka mundësi të shumëfishta t’i qaset zhvillimit përmes perspektivave të shumta të zhvillimit. Zhvillimi i bazuar në Njohuri është i lidhur me zhvillimin e inovacionit, teknologjisë por gjithashtu është i lidhur me konceptet e reziliençës, kohezionit e identitetit. (Carrillo, 2015) Në tranzicionin e qyteteve evropiane drejtë Zhvillimit të bazuar në Njohuri, evropianët kanë integruar herët konceptin e Zhvillimit të bazuar në Njohuri në politikat e tyre nacionale për krijimin e zonave urbane të cilat janë tërheqëse për resursin human dhe investimet, krijimin e vendeve të punës në nivel të lartë dhe nivelit të lartë të inovacionit. (van Winden et al., Pol, 2007) Në lidhur më këtë pozicionimi i qyteteve brenda Zhvillimit të bazuar në Njohuri ka rëndësi të madhe, e cila mund të matet dhe vlerësohet përmes indikatorëve bazë të Teorisë së Zhvillimit të bazuar në Njohuri, të cilët janë:

Baza e Njohurive

Si indikator i parë kryesorë i ZHBNJ, njohuritë/ dijet paraqesin rolin qendror në zhvillimin e proceseve ekonomike. *Për qytetet dija nënkupton mjet për të rritur konkurrencën dhe atraktivitetin.* (Pallaska, 2012) Burimet kryesore të dijeve konsiderohen universitetet, qendrat e hulumtimit apo institucionet e tjera. Poashtu hyjnë arti dhe kultura të cilat tërheqin klasën kreative për të jetuar në një qytet dhe organizuar jetën me standarde më të larta të jetësës. Nga perspektiva e tregut të punës rëndësi të veçantë i jipet aftësive apo kompetencave që lidhen me vendin e punës siç janë: interpersonale, intrapersonale dhe teknologjike. (OECD, 2001) Duke qenë se proceset e punës po dixhitalizohen dhe dijet po bëhen sa më të qasshme për njerëzit përmes rrjeteve sociale në shpërndarjen e dijes rol të rëndësishëm zë aspekti i qëndrueshmërisë, kuptimit dhe dobisë së dijes për faktorin njeri. Bota e zhvilluar punon përmes urtësisë dhe në kërkim të formave të reja të inovacionit. Kështu dija duhet të jetë në funksion të krijimit të hapësirave të jetueshme më të qëndrueshme, më të qasshme dhe më inkluzive.

Baza ekonomike

Shquhet si indikator i rëndësishëm i cili në Zhvillimin e bazuar në Njohuri lidhet direkt me inputin e dijës për të prodhuar shërbime dhe të mirat për qytetin. Ekonomia ndikohet skajshmërisht nga urbanizimi në aspektin pozitiv ose negativ. Andaj format e organizimit të strukturës urbane në nivel lokal, rajonal apo shteti krijon shkallë të ndryshme të zhvillimit ekonomik. Gjegjesisht produktiviteti, shkalla e papunësisë, qasja në treg dhe shërbime, krijimi i pabarazisë ekonomike dhe sociale reflektohet nga përqëndrimi dhe lidhjet e pjesëve të qytetit. Si gjenerator të zhvillimit ekonomik konsiderohen qytetet. Në fazën post-industriale të ekonomisë, rëndësi të veçantë zë ekonomia e shërbimeve e bazuar kryesisht në ekonominë e informacionit. Zhvillimi urban i qëndrueshëm i qyteteve po mbështetet fuqishëm nga dixhitalizimi duke lidhur njerëzit, shërbimet dhe bizneset e ndryshme. Dixhitalizimi i ndërmarrjeve sot paraqet obligim për t'i shpëtuar trendeve të shpejta të globalizimit, konkurrencës dhe nxitjes së inovacionit. Baza ekonomike sot është e lidhur me gjerësinë dhe thellësinë e bashkëpunimeve të qyteteve në nivele dhe fusha të ndryshme. Promovimi ekonomik i qytetit është njëkohësisht promovim i resurseve për të prodhuar zgjidhje për problemet e ndryshme lokale, regionale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kualiteti i jetës

Si indikatorë i rëndësishëm në lidhur me zhvillimin e qyteteve njihet edhe me termin „jetueshmëri“. Ky indikator ka një përkufizim kompleks dhe shtrihet në shumë sfera. Qëllimi i tij është gjetja e një bilanci ndërmjet shumë treguesve duke përfshirë vendin e punës, kujdesin shëndetësor, strehimin, kulturën, taksat që duhen të paguhesh ndaj shtetit por edhe përfshirë organizimin i kohës së lirë. Për qytetet e qëndrueshme, barazia dhe niveli i knaqshmërisë ndaj politikave drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban konsiderohet poashtu kualiteti i jetës dhe drejtë për të kundërshtuar politikën vendore. Shtetet me kualitet të lartë të jetës pos pagave të larta ofrojnë edhe shërbime të tjera në vendin e punës, si dhe balancin punë-familje. Megjithatë koncepti i kualitetit të jetës nga qyteti në qytet dallon.

Qasshmëria

Konsiderohet si indikator bazik për të qenë një qytet për të gjithë banorët e saj pa përjashtim. Kur vie në pyetje për këtë indikator gjejmë direkt anomalitë e qytetit në mungesë qasjeje dhe gjithëpërfshirje në shërbime. Qytetet e qasshme janë qytete me trende të larta të zhvillimit të turizmit e cila paraqet input për zhvillimin ekonomik të shtetit. Planifikimi i duhur i transportit dhe formave të përshtatshme urbane të qytetit krijon bazamentin për zhvillimin e qasshmërisë. Si formë dominuese e qyteteve të qasshme paraqesin hapësirat publike të lehta për të ecur, tregtuar, shkolluar e jetuar të gjithë kategoritë e qytetarëve dhe në veçanti kategorisë së dobët të shoqërisë. Qasshmëria megjithatë paraqet edhe në aftësinë për t'u lidhur virtualisht me ekonominë botërore dhe partnerë ndërkombëtar.

Diversiteti urban

Diversiteti përfaqëson parimin e ri udhëzues për planerët urban. (Fainstein, 2005) Qytetet e qëndrueshme arrijnë të ruajnë dhe kultivojnë diversitetin si pasuri socio-ekonomike, përderisa te qytetet e paqëndrueshme shëndrrohet si bazë e konflikteve socio-ekonomike. Diversiteti urban duhet të inkurajohet në zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve. Në kohën e globalizimit, përkrah urbanizimit të shpejtë ai shërben si urë lidhëse ndërmjet grupacioneve, kulturave, vlerave dhe ideve. Lokacionet e qyteteve luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e diversitetit megjithatë kufijtë gjeografik nuk duhet të përcaktojnë një vend ose arritje në mjedis. (Urban Times, 2017) Me rritjen e procesit të urbanizimit dhe migrimin e njerëzve drejtë qytetit, qytetet do të bëhen më hiperdiverse. Krijimi i diversitetit urban ndikohet nga struktura urbane e qytetit. Qytetet e zhvilluara e konsiderojnë diversitetin urban si aset të rëndësishëm për zhvillim duke përfutur nga përvojat dhe kulturat e popujve të ndryshëm në krijimin e formave të reja të bizneseve, përfutur nga shkëmbimet tregtare e të dijes, shërbimet outsourcing dhe zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit global. Si kriter i rëndësishëm konsiderohet element kyç në tërheqjen e klasës kreative dhe zhvillimin ekonomik të një qyteti.

Shkalla urbane

Shkalla urbane ka rol të rëndësishëm në lidhur me zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm të qyteteve. Përderisa historikisht qytetet e mëdha kishin ndikim pozitiv në zhvillim ekonomik, sot është e kundërta dhe madhësia e qytetit nuk ndikon në zhvillim ekonomik më të lartë përkundrazi sot zhvillimi lidhet më tepër me përqëndrimin e popullsisë, infrastrukturës urbane, aktiviteteve socio-ekonomike dhe të institucioneve brenda pjesëve të caktuara të qytetit. Përqëndrimi më i madh i popullsisë në qytete ka përfutur bazuar në tri faktorë: një pjesë e madhe e industrive që përfutur nga ekonomitë e grumbullimit, një infrastrukturë urbane e zhvilluar mirë dhe një nivel adekuat i efektivitetit të qeverisjes. (Frick & Rodríguez-Pose, 2017).

Barazia sociale

Baza teorike për ekzistencën e barazisë sociale në konceptin e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban është e hershme. *Mirëpo sapo të zbresim në operacionalizimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, këto vizione ideale në masë të madhe zhduken ose bëhen të rangut të dytë për t'u përqëndruar në teknologjinë, zgjidhjet e gjelbra ose të zgjuara të drejtuara nga tregu që shërbejnë vetëm për disa.* (Kremer, 2020) Për këtë arsye arritja e barazisë sociale kërkon objektiva më specifike dhe masa më efikase që ndikojnë në një proces afatgjatë të barazisë sociale në një qytet. Disa udhëzime të thjeshta të cilat ndikojnë që qytetet të lëvizin drejtë treguesve që kanë fokus barazinë sociale janë:

1. Përdorimi i të dhënave ekzistuese për treguesit e barazisë (krahasimi i masave prej grupeve të ndryshme të interesit, ndryshimi në lagje të qytetit, duke përdorur harta për të vizatuar variacione ose statistika përmbledhëse duke krahasuar lagjet e pasura me të varfëra)

2. Punimi me akterë lokal (qytetet kanë një mori burimesh lokale në formën e partnerëve që mund të ndajnë të dhëna, mjete analitike apo edhe kërkues)
3. Mësoni nga qytetet e tjera (përvojat e ngjajshme të qyteteve tjera në lidhur me barazinë sociale)
4. Shfrytëzimi i teknologjisë për përditësimin e të dhënave (qytetet vuajnë dhe janë të kufizuar në investimin në lidhur me përditësimin e të dhënave të cilat nuk përputhen me kohën aktuale të zhvillimit)
5. Sillni palët e interesuara në procesin e përcaktimit të treguesit (procesi i përcaktimit të treguesve është gjithashtu një mundësi e vlefshme për angazhimin publik)
6. Lidhë treguesit me politikëbërësit që i përdorin ato (treguesit bëhen të zbatueshëm kur politikëbërësit janë gjithashtu në tryezë). (Adler, 2017)

2.2.4. Teoria e Kapaciteteve Organizative

Kapacitetet Organizative paraqesin boshtin kurrizor për implementimin e suksesshëm të Axhendës së Re Urbane. Brenda procesit të shpejtë të urbanizimit qytetet duhet të monitorohen, maten, vlerësohen dhe orientohen drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Kapacitetet Organizative kanë për qëllim vazhdimin e përpjekjes së qyteteve për të riformësuar politikën, strategjitë, institucionet, partnerët publik dhe privat në kontekst të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Objektivat e tyre janë të shpërndara në përmbajtje të dokumenteve kryesore hapësinore për qytetet si Axhendës së Re urbane, Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Qëllimi themelor i Kapaciteteve organizative është rritja e aftësisë për të vlerësuar dhe shtruar pyetje pse një zhvillim është zhvillim i tillë në mes të përzgjedhjes së politikave dhe mënyrat e zbatimit të alternativave për zhvillim. (UN Habitat, 2019)

Për të funksionuar si i tillë, kapacitetet organizative kërkojnë bashkëpunime të shumta në të gjitha nivelet e organizimit të qyteteve përderisa si shkak i suksesit të kapacitetet ekzistuese të një qyteti mbetet kultura për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban.

Sipas Van den Berg, teoria e kapaciteteve organizative përbëhet nga gjashtë indikatorë: vizioni, rrjeti strategjik, lidhëshipi, mbështetja politike, mbështetja sociale dhe komunikimi. (2004)

Vizioni

Vizioni dhe strategjitë e qytetit duhet të mbështesin fuqishëm rrugën drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban përmes objektivave, politikave, planeve, veprimeve dhe masave të planifikuara në bazë të realitetit urban. Konsiderohet si korniza e përbashkët referuese që ndihmon për të udhëzuar akterët relevant në sjelljen e tyre karshi zhvillimeve të një qyteti. Sidomos në qytetet e reja me zhvillim të hovshëm urbanistik vizioni për një Zhvillim të qëndrueshëm duhet të jetë i qartë dhe strategjitë të jenë të përputhshme në çdo nivel menaxherial. Vizioni nuk mund të jetë produktiv në qoftëse qytetarët nuk janë në focus të zhvillimit dhe të parashikohen mënyra të

reja për të përmirësuar format e qeverisjes me qytetin. Ndonëse konsiderohet themel i një zhvillimi, si i vetëm nuk garanton një zhvillim pa program të definuar, veprime konkrete dhe mjete për konkretizim.

Rrjeti strategjik

Rrjeti strategjik mund të konceptohet si model midis akterëve të varur reciprokisht që evoluojnë në përgjigje të problemeve ose projekteve të politikave. Në lidhur me zhvillimin e qyteteve shpeshherë ky rrjet ndodh të jetë jo publik dhe transparent në veprime. Megjithatë në strategjitë zhvillimore ekzistojnë trupa të shumtë të cilët njohin sferën e veprimeve dhe përgjegjësive të tyre. Kështu përcaktohet qartë kush me kë bashkëpunon dhe për çfarë lloji bashkëpunimi bëhet fjalë. Në lidhur me rrjetin strategjik me rëndësi konsiderohet qartësimi se ndryshimi jo vetëm mund të ndodh por duhet të ndodh në një mënyrë të caktuar për të shtyer proceset përpara.

Mbështetja politike

Përpjekjet, qasjet, qëndrimet, objektivat zhvillimore jetësohen në sajë të aprovimit të organeve politike në nivel qendror dhe lokal. Ndërmjet niveleve të ndryshme politike dhe niveleve të strategjive është e rëndësishme të ketë harmonizim të objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm të qytetit në aspektin kohor dhe kualitativ. Qytetet e qëndrueshme karakterizohen nga një “qeverisje urbane” dhe “demokraci urbane” si rezultat i mbështetjes politike të qeverisë mbi zhvillimin e qëndrueshëm të zonave urbane. *Qeverisja urbane përfshin një sërë akterësh dhe institucionesh; marrëdhëniet mes tyre përcaktojnë se çfarë ndodh në qytet. Në menaxhimin e transformimeve urbane, qeveria (në të gjitha nivelet) duhet të luajë një rol strategjik në krijimin e partneriteteve me dhe midis aktorëve kryesorë* (UNESCAP & UN-Habitat, 2010; 2015).

Mbështetja politike nuk paraqet domosdoshmërisht një vlerë për qytetin përderisa nuk mbështetet në parimet evropiane të zhvillimit hapësinor të qyteteve. Si e tillë spektri politik duhet të jetë shkak për të sjellë bashkëpunime të qyteteve në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.

Mbështetja sociale

Mbështetja sociale duhet të sigurohet nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve në formësimin e të ardhmes së qyteteve. Shoqëria biznesore, qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit duhet të inkurajohen dhe vetëdijësohen për rolin e madh që luajnë si formësues të së ardhmes. Pa marrë parasysh sa i rëndësishëm është një projekt për zhvillim të qëndrueshëm të qyteteve-metropolitane, ai duhet të sigurojë edhe mbështetjen sociale. Mbështetja sociale shpeshherë nuk arrin ndikimin e vet në masë ngase qytetarët nuk e njohin dhe praktikojnë të drejtë e tyre për vetvendosje. Si e tillë mbështetja sociale varet shumë nga angazhimi i vazhdueshëm dhe

efikasitetin në komunikim me qytetarët në lidhur me problemet, sfidat dhe zhvillimin e qytetit. Rol të madh luajnë edhe institutet shkencore për vlerësimin e mbështetjes sociale nga ana e qytetarëve me të cilën kuptohet situata e tanishme dhe propozohen format e përshtatshme për komunikim me qytetarët. Mbështetja sociale duhet të sigurohet dhe fuqizohet sidomos për kategoritë e shtypura të grave dhe fëmijëve, mirëqenia e të cilëve pasqyron shumë nivelin e zhvillimit të një qyteti.

Komunikimi

Komunikimi është i nevojshëm për të sjellë mesazhin e vizionit dhe politikave të ndërlidhura në rrjetet e përfshira deri te drejtuesit e mundshëm, politikanët dhe shoqërinë duke përfshirë grupet e synuara shumë të rëndësishme të politikës së sigurisë. (Van den Berg, Pol, Mingardo, Speller, 2006) Roli i medias është të lidhë dhe përkthejë konceptin e mërzitshëm të Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban me “jeta ime”, “puna ime”, “shëndeti im”, “familja ime”. (GTZ, 2006) Prandaj organizimi dhe funksioni i mirë i mediave është faktorë relevant në kontaktin e parë të shoqërisë me Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban. Roli aktiv i OJQ për të ngritur vetëdijën e popullit kërkon maturi dhe pjesëmarrje direkte të akterëve përfaqësues të Komunës në mënyrë që të kërkohej llogaridhënia.

2.2.5. Korniza teorike analitike

Skema e mëposhtme paraqet kornizën analitike të hulumtimit (shih Fig.4.) Variablat kryesore në punim janë: Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban i qytetit të Prishtinës si variabël e varur, projekti i nënkalimit në lagjën Bill Clinton si variabël e pavarur kurse qeverisja urbane e qëndrueshme në qytetin e Prishtinës si variabël e ndërmjetme.

Indikatorët e përdorur në këtë punim mbështeten në teorinë e Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative si kritere për vlerësimin e proceseve.

Pjesa themelore e punimit është e mbështetur në hulumtimin e strategjive hapësinore të qytetit të Prishtinës dhe organizimi hapësinor të shtetit të Kosovës, temave sikurse Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban dhe qytetet e qëndrueshme nga përvoja e qyteteve evropiane. Rëndësia e të menduarit territorial dhe kohezionit territorial në bazë të kontekstit të strategjive evropiane dhe rastin e implementimit në qytetin e Prishtinës. Si literaturë shtesë është shfrytëzuar në koncepti i PPP dhe lidhshmëria me Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban, sesi mund të ofron zgjidhje për qytetet në tranzicion dhe sesi mund të plotësohen kriteret e teorisë së bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative në reformësimin e politikave urbane dhe krijimin e një qeverisje urbane të qëndrueshme, të qartë në objektiva drejtë ZHQU me burime efikase të financimit.

Pjesa empirike e punimit është ndarë në:

- Potencialet e qytetit të Prishtinës për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban.

A. Analizën e pozitës dhe rolit të qytetit të Prishtinës drejtë ZHQU.

B. Analizën e strategjive hapësinore urbane drejtë ZHQU në bazë të teorive moderne urbane dhe indikatorëve të tyre

C. Analizën e anketës, rreth suksesit të përmbushjes së indikatorëve urbane të teorive moderne urbane dhe realizimit të një projekti me PPP që promovon ZHQU.

Teoritë moderne urbane janë marrë në bazë të autorit Van den Berg, në mënyrë që edhe qyteti i Prishtinës të përfitojë nga këto teori për krijimin e qyteteve të qëndrueshme si shembulli i qyteteve evropiane të qëndrueshme. Në vijim është paraqitur korniza logjike analitike.




Fig. 13. Korniza teorike analitike, Burimi: Autori, (2021)

Burimet e informacionit janë ndarë në tri grupe në lidhur me analiza e potencialeve të qyteti të Prishtinës si qytet në tranzicion, A. Analizën e qytetit B. Analizën e strategjisë C. Analizën e anketës.

Në grupin e parë janë marrë informacione të përgjithshme mbi shtetin e Kosovës dhe qytetit të Prishtinës në përgjithësi, organizimit të saj hapësinor sipas legjislacionit aktual hapësinor.

Në grupin e dytë informacionet janë organizuar në bazë të analizave të planerëve urban në lidhur me potencialet dhe sfidat aktuale të qytetit të Prishtinës si dhe karakteristikat e saja shoqëro-ekonomike të përmbledhura në tërësi. Të dhënat e prezentuara janë marrë nga statistika, raporte vendore dhe ndërkombëtare të organizatave të ndryshme botërore mbi qytetet.

Në grupin e tretë, informatat burojnë nga strategjitë hapësinore në nivelin urban qendror dhe lokal duke përfshirë ligjet, strategjitë, planet zhvillimore etj.

Në grupin e katërt informatat burojnë nga kategoritë pjesëmarrëse në anketë në lidhur me nënkalimin “Bill Clinton” në veçanti pjesëtarë nga autoriteti lokal, tregtarët dhe qytetarët kalimtarë që përfitojnë më së shumti nga shërbimet e nënkalimit. Sa i përket informatave nga autoriteti qendror lokal- Komuna e Prishtinës, ato konsiderohen me kufizime të mëdha si shkak i mungesës së transparencës, qasjes direkte dhe informatave të hollësishme të projektit në fjalë. Si rezultat janë komunikuar vetëm përshkrime gojore në lidhur me pyetjet e parashtruara në pyetësor dhe jo rreth projektit të nënkalimit si investim apo formë e realizimit me shkrim dhe planit të detajishëm komunal për të cilën nuk kishte as një botim as me dorë e as në formën elektronike të faqës së Komunës apo të Departamentit të PPP në Kosovë. Faqja e Departamentit të PPP së Kosovës nuk është transparente sa i përket projekteve të realizuara me PPP në Kosovë përpos disa dokumenteve, ligjeve dhe botimeve të caktuara nuk ka informacione të qasshme sa i përket implementimit të projekteve me PPP.

Prandaj hulumtimi i referohet vetëm përmes analizës së anketës dhe nuk ka të dhëna konkrete në lidhur me fazat e planifikimit të procesit të PPPsë që realisht do të ishte me interes të kuptohet lloji i qasjes institucionale ndaj projektit prej momentin të përzgjedhjes e deri te përfundimi i tij, sfidat dhe sukcesi në implementim të një projekt të tillë infrastrukturor me rëndësi për banorët e Prishtinës.

Kaptina III - Analizat e potencialeve të qytetit të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban

Kjo kaptinë mirret ekskluzivisht me analizën e qytetit të Prishtinës duke i dhënë përgjigje pyetjeve:

- 1. Cilat janë potencialet e qytetit të Prishtinës për zhvillim si përshkrim i përgjithshëm.*
- 2. Cila është pozita e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban?*
- 3. Si e adresojnë Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban strategjitë hapësinore të qytetit të Prishtinës?*
- 4. Çfarë vlerësime japin pjesëmarrësit në hulumtimin e projektit të nënkalimit me PPP në lidhur me ZHQU të Prishtinës?*

Në fund të kaptinës përmbledhet sinteza dhe rezultatet në bazë të analizave.

3.1. Prishtina, kryeqytet i një shteti në tranzicion

Kosova si shtet i Evropës juglindore filloi tranzicionet e saja zhvillimore pas mbarimit të luftës të vitit 1999. Qyteti i Prishtinës si kryeqytet i saj shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës dhe përfshin një sipërfaqe prej 523 km² e me 471,630 banorë të llogaritur sipas Bankës Botërore (regjistrimet e Komunës vlerësojnë rreth 198,897 banorë) kurse sipas regjistrimeve të tatimeve, ujit, energjisë llogariten 450 mijë banorë andaj me koncentrimin më të madh të popullsisë në vend qyteti duhet të zgjidh planifikimin në bazë të numrit të saktë të popullsisë. Ndonëse Plani Zhvillimor Komunal i Prishtinës 2012-2022, me trendin aktual të migrimit përlllogarit që deri në vitin 2022 Prishtina të ketë rreth 622 mijë banorë kjo nënkupton se qyteti është duke u mbipopulluar. (Komuna e Prishtinës, 2013) Mbipopullimi nuk përshpejton procesin e tranzicionit përderisa mungojnë instrumentet e duhura financiare dhe strategjitë e qëndrueshme që e mbrojnë hapësirën dhe vendosin balanc socio-ekonomik paralelisht me ndryshimet rapide në hapësirë.

Në dekadën e fundit të pasluftes, qyteti u përball me sfida të shumta të tranzicionit politik duke filluar nga rindërtimi i institucioneve e deri te kopja- përshkrimi i ligjeve themelore për vetëqeverisje, të rimenaxhimit të burimeve natyrore dhe mjedisit, menaxhimit dhe reformimit të arsimit, rimëkëmbje e ngadalshme e autoriteteve lokale-Komunave, lidhjeve të dobëta infrastrukturore të zonave ruralo- urbane dhe shpërndarjes së pakontrolluar dhe spontane urbane etj.

Krahas stagnimit të proceseve industriale dhe investimeve të dobëta për shkak status quo-së së shtetit të Kosovës, Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban mbetet me shumë mangësi dhe në zhvillime jo të bazuara në modelin evropian të menaxhimit të qëndrueshëm të qyteteve.

Aktualisht qyteti i Prishtinës si kryeqyteti i një shteti tranzit, kompleksitetin e problemeve për zhvillim sipas ekspertëve lokal ia atribuon më së shumti fenomenit të deindustrializimit si rezultat i vonës në procesin e privatizimit dhe në periudhën e pasluftës për rindërtim. (Komuna e Prishtinës, 2013) Kurse fenomeni i ri sfidues si procesi i urbanizimit të shpejtë lidhet për shkak

e ndryshimeve demografike, ekonomike e sociale. Në këtë gjendje të zhvillimeve marramendëse, perspektiva territoriale është zgjidhje për të ndaluar sfidën e urbanizimit të qytetit që ushtron presion sidomos në pjesët më të urbanizuara ku dendësia e popullsisë mbërrin 300- 900 b/km². (Instituti për planifikim hapësinor, 2004) Një dendësi e tillë rrit përgjegjësitë për riorganizimin e shërbimeve, infrastrukturës dhe kapaciteteve publike të Komunës.

Shkaku i gjithë kësaj situate të krijuar konsiderohet *demokracia hapësinore*. Megjithëse plani dhe zhvillimi hapësinor i Kosovës ka pranuar parimet evropiane të bazuara në parimet e ESDP në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar, përforcimin e kohezionit ekonomik, social e zhvillimin e qëndrueshëm, qyteti nuk funksionon si tërësi hapësinore e pavarur, në të cilën zhvillimi i bazuar në njohuri dhe kapacitetet organizative janë të domosdoshme për hequr pabarazitë zhvillimore. Kështu procesi i konsumimit të hapësirës të qytetit të Prishtinës është në një përpjesëtim më të madh se çduhet për banorë duke shkaktuar paqëndrueshmërinë e qytetit. Edhe pse Kosova zbaton një sistem modern të administrimit të tokës, institucionet vazhdojnë t'iu japin leje qytetarëve për ndërtim pa plotësim të kriterëve profesionale për ndërtim (interpretimet e ndryshme të përmbajtjes së Ligjit për ndërtim nga ana e punëtorëve institucionel dhe përfituesve privat).

Kështu koncepti evropian për të ashtuquajturin “Zhvillim të Qëndrueshëm,” në përmbajtje të dokumenteve hapësinore kosovare nuk shtron unitetin në mes çështjes së “zhvillimit” dhe “rregullimit” por ato konsiderohen si dy rrugë të ndara e njohur dhe konfirmuar fuqishëm nga ana e planerëve urban. Në përmbajtjen e dokumenteve strategjike hapësinore është mundësuar një diskrepancë në mes të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit për shkak se hasim në dykuptimësi gjatë zbatimit të planifikimit hapësinor në praktikë. (Pallaska, 2012) Strategjitë hapësinore sipas Ligjit për planifikim hapësinor përfshijnë: planet në nivel të Kosovës sikurse Plani hapësinor i Kosovës dhe Plani hapësinor për zona të veçanta dhe në nivel komune: Plani zhvillimor i Komunës; Plani Zhvillimor Urban dhe Plani Rregullativ Urban. (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2013)

Kjo lloj ndarje e pengon orientimin e drejtë nacional dhe lokal të autoriteteve urbane drejtë menaxhimit hapësinor-territorial të vendit. Aktualisht koncepti i “Zhvillimit nacional hapësinor” është i shpërbërë në rregullativa, synime, objektiva dhe veprime që të gjitha promovojnë parimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Por në esencë konceptet e planifikimit dhe të zhvillimit hapësinor dhe urban, si formë dhe nocion, për shumicën e popullatës janë të ngjashme, nëse jo të njëjta, nuk ekziston dallim. (Pallaska, 2012). Kjo është edhe një ndër shkaqet kryesore pse autoritetet urbane lokale (komunat) janë të papërgaditura të përballojnë trendin e tanishëm të urbanizimit por edhe trendin e ardhshëm të urbanizimit. Si pasojë mundësia që Prishtina të krijojë një identitet lokal të qëndrueshëm ku kohezioni territorial do të përfshihej brenda koncept- ideve sikurse “të menduarit hapësinor- territorial”, “Policentriciteti”, “Zhvillimi i qëndrueshëm harmonizues i regjioneve dhe zonave”, “Diversiteti territorial”, “Ekonomia lokale” , “Solidariteti territorial”, “Subsidiariteti” bashkëjetojnë dhe krijojnë sinergji është teoretikisht e pamundshme pa rregullimin e çështjes së termave urban në lidhur me ZHQU. Qartësia e të cilave fillon kur njihet se në të vërtetë çfarë nënkupton “qyteti” dhe si mund të shëndrohet ai në gjenerator të zhvillimit ekonomik.

Në këtë situatë të tanishme të paqartë urbane/ hapësinore të qytetit të Prishtinës si qytet në tranzicion, implementimi i kohezionit territorial nuk ka sesi të paramendohet apo parashikohet brenda një sistemi hierarkik hapësinor pos me përfshirjen e dimensionit urban hapësinor në proceset politike të kërkimit. Edhe pse Kosova ka stragjinë e saj për Zhvillimin e Infrastrukturës Kombëtare për Informacion Hapësinor (2015), për shkak statusit të saj të padefinuar UNSCR 1244/1999 dhe shpalljes së pavarësisë ajo nuk konsiderohet as kandidatë potenciale për t'u klasifikuar në sistemin evropian të nomenklature NUTS për njësi territoriale dhe statistikore.

Aktualisht, shteti i Kosovës karakterizohet me një qeverisje urbane të papërcaktuar dhe qasje sektoriale të politikave urbane të cilat definojnë nga legjislatore të ndryshme të tjera. Legjislatore hapësinor i Kosovës ka subsidiaritet vertikal në nivelin nacional dhe lokal por mungon subsidiariteti horizontal tejet i rëndësishëm për arritjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban (Qeverisa urbane sëbashku me qytetarët). Në aspektin rregullativ ligjor qyteti i Prishtinës gjendet në një distancë të largët nga niveli i Zhvillimit të Integruar Hapësinor Evropian ku përfshirja e kohezionit territorial do të zgjidhte shumë sfida dhe probleme urbane të qytetit. Realizimi i kohezionit territorial në dokumentet strategjike të qytetit të Prishtinës është i paraparë përmes objektivave/synimeve mirëpo jo si përpjekje për harmonizim të politikave sektoriale. Kështu si detyrë parësore e ekspertëve sektorial paraqitet shpërndarja e mesazheve territoriale në koordinim me Axhendën Territoriale 2030 brenda aktiviteteve të sektorit të tyre, gjegjësisht brenda shtyllës: ekonomike, sociale, mjedisore dhe institucionale.

Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban					
▪ Ndertimi i Zhvillimit të Qendrueshem Urban në:	1.Legjislatore Hapësinore nacionale/lokale	2.Qeverisja Urbane (X)-Qasja e politikave	3.Dimensioni Urban(Y)-Sistemi i informatave hapësinore	4.Kohezioni Territorial (Z) dhe aspektet e tij	5.Partneriteti Publiko- Privat
1. <u>Bashkimi Evropian</u>	Subsidiariteti vertikal (ndarja e kompetencave në nivelin lokal, regjional, nacional, ndernacional, mbinational dhe nderkufitar) dhe horizontal (ndarja e kompetencave nga aktorët e duhur urban në një nivel të njëjtë) -Qyeti ekziston si koncept i një tërësie dhe trupi të gjallë -Zonat urbane ekzistojnë si koncept dhe mbiqyrën në bazë	Shumëniveleshe- -Qasje të bazuar në vend -si proces i koordinuar i shumë aktorëve, grupeve sociale dhe institucioneve -vepron në mënyrë të pavarur nga qeveria -udhëheqë shoqërinë urbane dhe zgjeron rrjetin e qyteteve drejtë ZHQU -Veprom dhe fuqizon termat urban në bazë të	Dimensioni territorial- Njesia Statistikore territoriale NUTS, "Databaza Zhvillimore", Komuniteti Gjeo-hapësinor (ESPON3)	1.Si konvergjenca socio-ekonomike; 2.Si konkurrenca ekonomike; 3.Si perspektive rurale; 4.Si planifikim hapësinor; 5.Si koordinim i politikave;	PPP ne : 1.Lidhja e Aftesise Evropiane (CEF) 2. Fondi i Kohezionit (CF) 3. Rregullorja e Provizionit të përbashkët (CPR) 4.Autoritetet Kontraktuese 5. Qendra evropiane e Ekspertizave të PPP 6.Sistemi Evropian i llogarive kombetare dhe regionale

	të parimeve të ZHQU.	demokracisë urbane -definin problemet urbane si rreziqe -qyeti nuk përkufizohet në bazë të territorit apo kufje gjeografik. -kontrollon çështjet që nuk mund të kontrolloje qeveria			7.Fondi Evropian per investime strategjike. 8. Fondi Evropian per Zhvillimin Rajonal 9. Fondi Evropian Strukturor dhe i Investimeve
<u>. Kosova</u>	Subsidiariteti vertikal (Nacional, lokal) kurse subsidiariteti horizontal mungon ne kontekstin e Zhvillimit te Qendrueshem.	E definuar në Legjislacione te ndryshme te tjera -Qasje multisektorale jo te koordinuar.	Sistemi "GIS" "Indikatorët per planifikim hapësinor ne Kosove "(2017)	I parapare permes indikatorëve hapësinor (2017)	PPP ne: 1.Instrumenti per Asistencen e Paraanetaresimit 2.EBI, EBRD 3. Institucionet financiare te OKB-se 4. Mungesa e përvojës për promovim të projekteve të mëdha dhe atyre që kanë për qëllim ZHQU

Tabela 1. Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban në legjislacionin kosovar dhe evropian, Burimi: Autori, (2021)

3.2. A. Analiza e pozitës dhe rolit të qytetit të Prishtinës

Cila është pozita e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban në bazë të teorive moderne urbane?

Në këtë kaptinë vlerësohen plotësimi i indikatorëve të teorive të Zhvillimit të bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative, konceptet kyçe të Axhendës së Re Urbane dhe Axhendës Territoriale 2030 për zhvillimin e qytetit të Prishtinës. Poashtu konstatohet situata pozicionale dhe strategjike e Partneritetit Publiko- Privat në qytetin e Prishtinës.

Dokumentet kryesore të shfrytëzuara janë: “Plani zhvillimor urban i Prishtinës 2020+”, “Plani hapësinor i Kosovës”, “Strategjia kombëtare për zhvillim 2016- 2021”, “Axhenda Evropiane 2030”, “Axhenda Territoriale 2030”.

Baza e Njohurive- *Sa kultivohet si term Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban në institute, qendra hulumtimi, universitete apo qendra edukativo- arsimore? Cili do të ishte roli i PPP në promovimin e ZHQU në arsim?*

Si bazë për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban të qyteteve, në institucionet e larta të arsimit ka filluar të integrohet planifikimi urban i qëndrueshëm si fushë e gjërë interdisiplinore. Disa Universitete private në Kosovë në relacion me trendin e tregut dhe kërkesat për praktika më të mira në lidhur me zhvillimet urbane lokale, regjionale dhe metropolitane ofrojnë kurse të ndyshme të kësaj fushe të studimeve që lidhen me temat sikurse “Dizajn urban”, “Zhvillim i Qëndrueshëm”, “Zhvillimin e Infrastrukturas”, “Menaxhimi i qëndrueshëm i ndërtesave”, “Sistemet e Informacionit gjeografik (GIS)”, etj.

Edukimi rreth Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban në shkolla ësh të kusht për një të ardhme të qytetit. (Urbact, 2019). Përgjithësisht edukimi rreth zhvillimit të qëndrueshëm është term i panjohur në Kosovë për institucionet arsimore. Në shkolla nuk promovohet sa duhet duke munguar përpjekja e integruar e sistemit të arsimit për gjithëpërfshirje të akterëve të ndryshëm në procesin e edukimit dhe lidhjes me komunitetin për ta njohur qytetin si orkestër e zhvillimit dhe gjenerator i zhvillimit ekonomik. Mungon mbështetja morale, financiare, teknike dhe hapësinore për të promovuar kohezionin social, ekonomik dhe mjedisor në lidhur me zhvillimin urban të qytetit. Për më tepër Zhvillimi i Qëndrueshëm përfshihet brenda termit “Mbrojtje dhe ruajtje të ambientit” mirëpo jo në konceptin origjinal e të integruar ashtu siç duhet të jetë. Partneriteti Publiko-Privat mund të përmirësojë infrastrukturën e institucioneve të arsimit duke bërë që shkollat të jenë më të qasshme, sidomos për studentët të zonave rurale ku infrastruktura e shkollave është është e pazhvilluar, kualiteti i së cilës ndikon edhe në kualitetin e arsimit ashtuqë duhet siguruar ushqimin dhe sigurinë në shkolla, mbështetjen teknike të shkollave, lidhjen e shkollave me komunitetin etj. Me qëllim të krijimit të impaktit të qendrave universitare si burime të dijës/njohurive për zhvillimin e qytetit rekomandohet që të ekzistojnë njësitë e “PPP për qytetin” brenda universiteteve, në të cilën ekspert të lamive të ndryshme dhe studentë implementojnë hulumtimet e tyre shkencore për zhvillimin e

qytetit në shumë aspekte dhe kësisoji studimi të shëndrrohet në përmirësim të jetës në shoqërinë e qytetit. Funksione të tilla mungojnë realisht në qendrat e dijeve ose janë të ralla ngase vetë kualiteti i hulumtimeve shkencore vihet në pikëpyetje dhe qëndron larg kontributeve profesionale të vet autorit apo studentit në jetën reale.

Nr.	Fakultetet UP	Punimet ne revista shkencore	Punimet ne revista shkencore e dyshimta
1	Fakulteti Filozofik	35	10
2	Fakulteti Matematik-Natyror	524	180
3	Fakulteti i Filologjise	36	7
4	Fakulteti Juridik	74	21
5	Fakulteti Ekonomik	98	50
6	Fakulteti i Ndertimtarise- Ark.	48	10
7	Fakulteti Inxhinierise elektrike-kompj.	57	25
8	Fakulteti i Inxhinierise Mekanike	94	16
9	Fakulteti i mjekesise	528	107
10	Fakulteti i Bujqesise	184	34
11	Fakulteti i Edukimit fizik dhe Sportit	14	0
12	Fakulteti i Edukimit	94	42
Totali		1735	502

Tabela 2. Publikimet e punimeve shkencore në Universitetin e Prishtinës 2018, Burimi: Orca, (2018)

Baza ekonomike- Sa ka kapacitete Prishtina për një Zhvillimi të Qëndrueshëm urban duke u bazuar në bazën ekonomike të gatshme për një konvergencë innovative? Si do të ndihmonte PPP në zhvillimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë në Prishtinë?

Qyteti i Prishtinës i karakterizuar me popullsi me moshë mesatare të mesme dhe me një numër në rritje të personave të kualifikuar me arsimim të shkallës së lartë që kanë përfunduar studimet veçanërisht në TIK, si qytet ka kapacitete të mëdha për dixhitalizim. Pyetja mbetet se: si dhe ku të dixhitalizohet Prishtina në mënyrë që ekonomia e saj të ecë drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban? Prishtina sipas trendeve të fundit është qendër atraktive për bizneset e internetit (sistemi SAP- Sistemet, Aplikacionet dhe Produktet/ Shërbimet) prej të cilave biznese zbatohen format tradicionale të biznesit dhe me internet. Qeveria e Kosovës (QeK) ka pranuar financim në vlerë prej 20,7 Milion EUR nga Banka Botërore për projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës në vitin 2020. Implementues i këtij projekti është Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Megjithatë qyteti i Prishtinës ka ende probleme sa i përket infrastrukturës e cila është: e paunifikuar nga operatorët (e cila duhet të jetë pronë e Komunës dhe të kontrollohet cilësia e shërbimeve), mungesës së infrastrukturës nëntokësore, për shërbimet “Data” duhet të rritet numri i BTS-ve në zonat me koncentrim më të madh të qytetarëve. (INSI, 2021)

Koncepti i ndërmarrësisë, si thelb i Ekonomisë së Njohurive është më së i nevojshëm për nxitjen e inovacionit. Edhe pse sipas raporteve të fundit konstatuar nga Treguesit e të Bërit Biznes në vitin 2017 (Banka Botërore 2017), Kosova ka përmirësuar format e të bërit biznes, sipas OECD shumë biznese në Kosovë e konsiderojnë veten të jene inovative, me nivele të larta të bashkëpunimeve në inovacion, por koncepti i inovacionit nuk i referohet këtij realiteti. (OECD, 2013) Partneriteti Publiko-Privat do të ndihmonte në krijimin, testimin dhe bashkëqeverisjen e ideve të reja, produkteve të reja apo shërbimeve të reja që promovojnë Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës duke lidhur universitetet me bizneset. Në dixhitalizimin e qytetit suksesi i PPP qëndron në nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve si kriter shumë i rëndësishëm i krijimit të një qyteti të mençur, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Në bazë të Raportit për Progres 2021, Kosova ka bërë pak progres në përmirësimin e hulumtimeve, zhvillimit dhe sistemit të inovacionit. (European Commission, 2021). Si tri qendra të njohura që mundësojnë intershipe për studentë kosovarë njihen: Universiteti UBT, American University of Kosovo, Innovations Lab Kosovo.




Fig. 14. Bashkëpunimi i institucioneve arsimore me ndërmarrje në shtetin e Kosovës, Burimi: Oda Ekonomike, (2018)

Kualiteti i jetës- A ka Prishtinës infrastrukturë të transportit, infrastrukturë publike dhe infrastrukturë sociale të mjaftueshme për të siguruar një kualitet jete në qytet?

Aktualisht zonat e Prishtinës në aspektin e infrastrukturës së transportit karakterizohen me shumë me sfida të cilat burojnë nga mosplanifikimi i duhur urban: ngarkesën e lartë të trafikut në rrugët kryesore që lidhen me pjesën tjetër të Kosovës, si dhe qendrën e qytetit, mbingarkim nëper kryqëzime apo segmente të rrjetit rrugor, mosplanifikim dhe zbatim i duhur i hapësirave për parking, mungesë për lëvizje të lirë të qytetarëve dhe çiklistëve. Infrastruktura publike është thuajse më e anashkaluara si koncept-ide, infrastruktura sociale është kryesisht infrastrukturë e vjetëruar me shërbime të nivelit të ulët dhe mungesë të hapësirës së nevojshme për zhvillim. Infrastruktura e përgjithshme e qytetit të Prishtinës ka nevojë për konceptualizim të ri strategjik në kuptimin e qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të mençur. Partneritetet Publiko-Private me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës së qytetit do të ndihmonin situatën e pamjaftueshme për investime në përmirësimin e infrastrukturës. Hapi i parë që duhet të bëhet (pos ndryshimeve përmes strategjisë së planifikimi hapësinor të Prishtinës) është të informohet shoqëria e Prishtinës në lidhur me definicionin “kualitet jete” meqë ka shtrirje të gjërë, publiku ka qasje të kufizuar mbi konceptin, përkufizimin, indikatorët, informatat, mundësitë dhe zgjidhjet. Roli i mediave por edhe

i bizneseve private ka ndikim të madh në ngritjen e kualitetit të jetës duke filluar nga vetëdijësimi në lidhje me të. Për të ndihmuar krijimin e qyteteve të mençura, PPP ka rëndësi të madhe në iniciativa të ndryshme që lidhen me vetëdijësimin e publikut mbi krijimin dhe ruajtjen e kualitetit të jetës në Prishtinë. Projektet e PPP mund të shërbejnë si ndihmë për shumë sektorë sidomos në përmirësimin e normave të shëndetit publik, shpërndarjen e Wi-fi dhe rimodifikimin e infrastrukturës së vjetëruar urbane që kontribuojnë në një standard më të lartë të kualitetit të jetës. Kështu edhe qasja më e shpejtë, më e sigurtë dhe më madhe në parkingje në një qytet konsiderohet kualitet jete.

Indikatori	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shuma e buxhetit të Komunes në teresi për një vit	59,487,638	57,694,000	68,693,000	56,738,709	64,222,993	65,888,3762
Nr. i parkingjeve publike	0	251	234	0	0	0

Tabela 3. Numri i parkingjeve publike krahasuar me buxhetin e Komunes së Prishtinës, Burimi: Instituti GAP, (2018)

Qasshmëria- *A sigurohet qasshmëri urbane për të gjitha llojet e grupeve sociale apo qytetarëve të Prishtinës, banorë dhe vizitorë, në tërë regjionin e Prishtinës dhe lidhjeve të saja lokale, regjionale dhe ndërkombëtare për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban? Si do të mund të përmirësonte PPP qasshmërinë në Prishtinë?*

Pos veçorive gjeografike, demokratike dhe natyrore të qytetit të Prishtinës, shtu edhe pozitën strategjike të krijuar nga planet e mëhershme hapësimore dhe nga ndërhyrjet spontane të pakontrolluara të qytetarëve në hapësirën e qytetit, Prishtina duhet të jetë e qasshme për të gjithë pa dallim. Këtu kërkohet që të ndahet zgjidhja e meritueshme për këmbësorë, çiklistë, vizitorë, tregtarë si dhe menaxhimin më të mirë të qendrave të tanishme si transporti publik me autobus, qendra e aeroportit si mundësi për promovim të bizneseve dhe kulturës. Investimi dhe promovimi i qendrave aktuale si qendra të qasshme dhe atraktive për t'i vizituar. Qasshmëria duhet të jetë e dukshme në jetën publike të qytetarëve. Si e tillë prapë shoqëria publike duhet të edukohet në lidhur me praktikën e suksesshme të qasshmërisë si kusht për një Prishtinë të qëndrueshme. Shfrytëzimi i shërbimeve dixhitale në promovimin e qasshmërisë paraqet një mundësi për

Prishtinën. Qyteti mund të fillojë implementimin e tualeteve publike dhe rregullimin e dyerve të objekteve institucionale, sinjalet dhe shenjat për orientim në qytet. Njëra prej arsyeve pse Spanja prin me qasshmërinë e qyteteve është pikërisht Partneriteti Publiko-Privat. (Fundacion Once, 2014) Në lidhur me zhvillimet strategjike për përmirësimin e qasshmërisë së qytetit të Prishtinës është krijuar edhe Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës. Në zhvillimin e qasshmërisë, PPP do të ndihmonte në krijimin e një qeverisje shumë-nivelëshe me qëllim të zhvillimit të mobilitetit të qytetit të Prishtinës si qytet-regjion dhe përfshirjes së gjërë të formësuesve urban të nivelit nacional, lokal, pjesëmarrjes së komunitetit dhe OJQ-ve.

Shkalla urbane- *A ka Prishtina potenciale për të zgjidhur problemin e dendësinë urbane si kusht bazik për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban? Roli i PPP në rregullimin e shkallës urbane?*

Qyteti i Prishtinës dendësinë urbane më të lartë e ka mbi 900 banorë/km² ndërkohë që rajonet më të pabanuara janë viset malore dhe kodrinore me dendësi përafërsisht 50 banorë/km² (Instituti për Planifikim Hapësinor, 2010). Pos shtimit natyror të popullsisë që rrjedhë në mënyrë spontane, ky pasqyrim reflekton gjendjen e planifikimit hapësinor në qytetin e Prishtinës në raport me normat, parimet dhe standardet evropiane për qytetet e qëndrueshme. Në anën tjetër në infrastrukturën e transportit në bazë të vlerësimeve 35% të pjesëmarrësve më të mëdhenj në komunikacion janë veturat. (INSI, 2021) Parimisht qyteti i Prishtinës ka potencial për zhvillimin e hapësirës së qytetit, nëse infrastruktura e saj, çështja e banimeve (individuale dhe kolektive) dhe koncentrimi i objekteve, resurset humane, politike dhe financiare organizohen në bazë planeve zhvillimore të bazuar në Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban. Kjo nënkupton që zhvillimi duhet të auditohet, duke vënë standarde për çdo zonë të hapësirës së Prishtinës paralelisht me kapacitetin që ka Prishtina. Tërë territori i Prishtinës duhet të jetë i mbuluar me shërbime për të cilat ka nevojë qoftë rregullim dhe optimizim infrastrukturë, menaxhim të mbeturinave, hapësirave për parking etj. Për vlerësimin e dizajnit të qëndrueshëm urban të qytetit të Prishtinës për shkak ndryshimeve në të dhëna dhe mungesës së bashkëpunimeve apo gjithëpërfshirjes në vendimmarje, qyteti ka nevojë për Partneritete Publiko-Private që ofrojnë programet e posaçme për monitorim dhe vëzhgim të situatës meqë dizajnit po i kushtohet shumë rëndësi në ndërtim. Një sistem i tillë mund të bazohet në bazë të matjes së vazhdueshme të indikatorëve urban të qytetit të Prishtinës në bashkëpunim të autoriteteve lokale me institute të vlerësimeve të gjendjes ndryshimeve të lëvizjes dhe gjendjes së popullsisë në Prishtinë.




Fig. 15. Rritja e qytetit të Prishtinës 1970-2010, Burimi: Gollopeni, B. (2016)

Diversiteti urban- Në çfarë baze qyteti i Prishtinës aktualisht arrin të mbjellë diversitetin urban?

Pas luftës së vitit 99, Prishtina si kryeqytet i një shteti të ri Kosovës, me veçorinë kryesore të saj të një popullsie të re është kthyer në një qendër të rëndësishme outsourcing të gjuhëve evropiane. Përmes kontaktit më Evropën perëndimore në Prishtinë ka depërtuar kultura evropiane perëndimore dhe të rinjtë të cilët jetojnë në stilin e jetesës perëndimore. Mund të thuhet se teknologjia informative, komunikimi në gjuhë të huaja dhe shërbimet e telekomunikimit janë potenciale për zhvillim dhe kultivim të bashkëpunimeve Prishtinë- Evropë- Amerikë. Kësisoj dija, aftësitë dhe kultura ndërkombëtare e të rinjve janë shkaku kryesorë për të bërë Prishtinën tërheqëse për investitorë. Prishtina ende lufton me mbrojtjen e identitetit të saj urban dhe diversiteti urban nuk paraqet një koncept shumë të njohur në përmbajtjen e planeve zhillimore ndoshta shkaku që Prishtina nuk është qytet aq divers në kuptimin e grupeve, kulturave apo banorëve të huaj. Kjo parashtron pikëpyetjen pse nuk është dhe çka e pengon të jetë e tillë kur qytetet e tjera zhvillimin ia atribuojnë diversitetit urban si pasuri lokale e regjionale. Sidomos në institucionet publike diversiteti urban duhet të promovohet si vlerë për të qenë shembull për kategoritë tjera të shoqërisë.




Fig. 16 Përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në ndërmarrje publike në Kosovë, Burimi: Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, (2013)

Barazia sociale- *A siguron qyteti i Prishtinës barazi sociale të mjaftueshme si bërthamë për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban? Si mund të përmirësojë PPP barazinë sociale si koncept përfshirës brenda projekteve investuese në Prishtinë?*

Qyteti i Prishtinës, për dallim nga qytetet tjera të Kosovës është qyteti më “social” megjithatë në raport me shpejtësinë e urbanizimit të qytetit dhe fazën e privatizimit barazia sociale rrezikohet gjithnjë e më tepër duke krijuar dallime, polarizime dhe ndarje të grupeve shoqërore sidomos në aspektin e pasurisë. Trendi i tanishëm i ndërtimeve masive të pakontrolluara po tërheq klasën e të pasurve në periferi të qytetit të cilët shërbimet e shëndetit, arsimimit, tregtisë po i bëjnë në hapësira dhe qendra private të veçanta përderisa klasa e mesme i marrin shërbimet publike në qendra ku infrastrukturë është e vjetëruar dhe mungesa elementare e mjeteve të punës nuk mjafton për një shërbim normal dhe të sigurtë. Autoriteti komunal ka nevojë urgjente për partneritete për të ndaluar thellimin e pabarazive shoqërore. Përderisa OQJ-të në mënyrë aktive promovojnë kërkesat për barazi, institucionet vazhdojnë të jenë port i interesave të biznesëve dhe partive në pushtet. Sipas UNDP, në kohezionin social të Kosovës ndikojnë këta faktorë: Liderhipi politik, ekonomia-qeveria-shërbimet sociale, mundësitë për bashkëpunime si dhe statusi i pazgjdhur i Kosovës-ballafaqimi me të kaluarën. (2019) Meqenëse Kosova dhe kryeqyteti i saj Prishtina është e pasur me një popullsi të re, rinia si grup i madh demografik mund të konsiderohet si resurs për të vendosur barazinë sociale dhe forcë transformuese e shoqërisë. Qyteti dhe të rinjtë e Prishtinës

duhet të zhvillojnë identitetin e vet të bazuar në barazi sociale. Pjesëmarrja e të rinjve në platforma sociale do të ishte forma më efikase për të promovuar kohezionin pos diskutimeve të hapura publike për të kufizuar ndikimin e strukturës së familjes joliberalë ndaj zhvillimit. Familja mbetet njësisë kryesore udhëheqëse e cila sjellë ndikime të mëdha në jetën shoqërore e cila sjell fakte të favorshme dhe disfavorshme për përcaktimin e vlerave dhe jo-vlerave. Sipas vlerësimeve Kosova në krahasim me vendet e rajonit ka pjesëmarrjen më të ulët të grave në punësim me 12.7 % në Evropë. (Kosovo 2.0, 2017) Për të përfshirë barazinë sociale si output të projekteve të PPP në qytetin e Prishtinës, në hartimin e projekteve duhet përfshirë ekspertë të barazisë sociale që të përcaktojnë prioritetet dhe fushat më të rëndësishme për investime me fryte afatgjatë duke filluar nga diskriminimi në vendet e punës e deri në pjesëmarrjen e barabartë dhe meritore në institucione të larta shtetërore.

Vizioni dhe strategjia- *Çfarë stragjie mund të shfrytëzojë Prishtina në mënyrë që qyteti të paraqitet mjaft joshës në mënyrë që të mos emigrojnë të rinjtë e shkolluar dhe klasa kreative e saj? Cili do të ishte roli i PPP në krijimin e vendeve të reja të punës?*

Edhe pse rritja e ekonomike e Kosovës ka tejkaluar fqinjët e saj dhe ka qenë kryesisht gjithëpërfshirëse, kjo nuk ka mjaftuar për zvogëlimin e konsiderueshëm të normave të larta të papunësisë; ofrimin e vendeve formale të punës, në veçanti për gratë dhe të rinjtë; apo ndryshimin e trendit të migrimit në shkallë të madhe. (Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, 2019)

Migrimi mbetet një fenomen mjaft shqetësues për Kosovën në përgjithësi dhe Prishtinën në veçatë si kryeqytet të saj por pa kushte të mira për jetesë për të gjithë banorët njësoj. Për parandalimin e tij kërkohet qasje e re strategjike duke rritur nivelin e pagave të sektorit privat, përmirësimin e kushteve në shëndetësi dhe arsim. Përkundër migrimit të lartë, qeveria nuk po i adreson faktorët real që ndikojnë në migrim të popullsisë drejtë vendeve të BE-së. Në këtë situatë të tanishme inkurajohet fuqishëm bashkëpunimi i fushës akademike me shoqërinë civile për të komunikuar hapur masat dhe veprimet për parandalim të migrimit dhe studimet sistematike mbi nevojat e tregut të punës dhe politikat e punësimit. Roli i PPP në krijimin e vendeve të reja të punës në qytetin e Prishtinës konsiston nga bashkëveprimi i institucioneve të arsimit me bizneset dhe institucionet vendore, në mënyrë që të njohin më mirë kërkesat e tregut në vend dhe të përcaktojnë një bashkëpunim ashtu që të diplomuarit të kenë garancë për punësim pas studimeve dhe motiv për të vazhduar jetën në Prishtinë.

Lidershipi/ Udhëheqësia- *A sigurojnë liderët aktual kualitete për të orientuar qytetin drejtë ZHQU? A janë për një zhvillim dhe a mund të jenë për një zhvillim?*

Sipas Raportit të Progresit për Kosovën të vitit 2021, Kosova ka bërë përparime në kulturën demokratike edhe pse Kosova ishte e paqëndrueshme politikisht për shkak zgjedhjeve të shpeshta. Udhëheqësit e tanishëm politik pranojnë se vlerësimet e BE në lidhur me progresin e Kosovës janë reale. Zgjedhjet parlamentare të shkurtit 2021 ishin të administruara mirë, transparente dhe konkurruese, pavarësisht disa mangësive, por forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional mbi fushatën zgjedhore dhe financimin e partive politike mbetet një fushë ku duhet të kryhen reforma të thella. (European Commission, 2021) Për një lidship i cili kontribon në Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban liderët e Prishtinës duhet të bashkëpunojnë me planerët urban që promovojnë Zhvillimin e Qëndrueshëm të Prishtinës, bashkëpunimi sa më i ngushtë me dhe për qytetarë dhe partnerëve biznesor. Pas krizës së pandemisë Covid 19, lidshipi qëndron si bartësi kryesor i objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, prandaj profili i udhëheqësit të qytetit duhet të lidhet detyrimisht me Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban. Në udhëheqjen e qytetit drejtë ZHQU liderët e Prishtinës duhet të pranojnë parimet e Axfordës së re urbane. Në fund të vitit 2021, Prishtina si kryeqytet i Kosovës ka ndryshuar përfaqësuesin e Kryetarit të qytetit duke përzgjedhur një arkitekt në krye të saj, i cili rrjedhë nga partia LDK, si parti me pushtet të mëhershëm shumëvjeçarë në qytetin e Prishtinës.

Mbështetja politike- *A ka Prishtina mbështetje politike për të ecur drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të saj? A ka Prishtina politika efikase që promovojnë implementimin e PPP për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban të saj?*

Roli i partive politike në Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban edhe pse nuk është i lidhur drejtëpërdrejtë ushtron ndikim të lartë në orientimin e qytetit.

Qyteti i Prishtinës aktualisht është më aktiv sa i përket procesit të vendimmarrjes në lidhur me aprovimin e planeve zhvillimore komunale. Tendenca e fundit për të miratuar planin 8-vjeçarë të qytetit të Prishtinës pak para se të organizohen zgjedhjet e reja ka dështuar dhe konsiderohet si sukses për të ardhmen e planifikimit hapësinor të Kosovës. Për të vlerësuar planet zhvillimore të Prishtinës është hartuar Draft Raporti i Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës. Heshtja e partive politike ndaj çfarëdo plani zhvillimor komunal të shqyrtuar pa pjesëmarrjen e qytetarëve paraqet sulm direkt ndaj zhvillimit të qytetit. Prishtina historikisht është udhëhequr nga partia e krahut të djathtë LDK-së, që udhëheqi Prishtinën nga viti 2000 deri 2013. Pas kësaj Prishtinën e udhëhoqi partia Vetvendosje. Megjithatë deri më tani politikat e Prishtinës ishin jotransparente ndaj zhvillimeve në hapësirë dhe i duke dhënë mundësinë e ndërtimeve të shumta pa leje dhe pa standarde. Për të siguruar Prishtina mbështetje të plotë politike drejtë ZHQU-së duhet të bashkëpunoj me komunitetin përndyshe MPPHI është e pafuqishme për të udhëhequr politikat brenda strategjive dhe planeve zhvillimore komunale, përderisa autoriteti komunal nuk paraqet partner në zhvillim. Në anën tjetër në aspektin lartëposhtë, stabiliteti i qeverisë së Kosovës ndikon edhe në stabilitetin e qytetit të Prishtinës. Kosova

dhe komunat e saj në përgjithësi nuk kanë përvojë të madhe me PPP. Strategjia e përgjithshme për zhvillimin e PPP ende identifikon sfida të shumta në implementimin e PPP në qytete.

Mbështetja sociale- *A promovohet Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës përmes aktiviteteve, ngjarjeve, hulumtimeve shkencore, OJQ dhe mediave në veçanti? A promovohet PPP si mbështetës i komunitetit/ banorëve të Prishtinës?*

Shoqëria civile e Prishtinës mbështet promovimin e faktorëve që orientojnë qytetin e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Në anën tjetër lufton faktorët që sjellin regres drejtë Zhvillimit të qytetit të Prishtinës në çfarëdo forme edhe pse urbanizimi dhe jeta urbane është e re, ka filluar të promovohet përmes aktiviteteve të ndryshme. Shembulli i tillë është organizata “Qytetaria aktive”. Pjesëmarrësit në aktivitete janë kryesisht banorë të vet qytetit përfshirë klasën kreative të Prishtinës. Mirëpo kultura urbane ende nuk ka depërtuar në fshatrat perreth Prishtinës në sajë të lidhjeve të dobëta të qytetit me zonat e saj rurale. Aktivitetet më të shumta që janë organizuar përfshijnë parandalimin e miratimit të planeve zhvillimore, kunder ndërtimeve të paligjshme, mbrojtjen e mjedisit, pjesëmarrja në debate publike. Megjithatë prapë ka hapësirë mjaft për të punuar në këtë drejtim për të rritur vetëdijën publike mbi format e ndryshme mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës brenda kohës së shpejtë të urbanizimit që po përjeton mbi Kosovën- shtetin e ri dhe Prishtinën si kryeqytet të saj. Prishtinasit brenda dhe jashtë qytetit të Prishtinës duhet të njohin fuqinë dhe pasojat e mospërfshirjes në realitetin urban të qytetit. Në kohën moderne, vrasja e qytetit nuk mund të demaskohet vetëm përmes planeve strategjike urbane- gjuhën e të cilave fatkeqësisht nuk e kupton gjysma e popullsisë. Prandaj arti, kultura dhe gazetaria duhet të veprojnë në mënyrë aktive. Kosova dhe kryeqyteti i saj nuk ka arritur ende të njohin dhe çmojnë benefitet socio-ekonomike të PPP në zhvillimin e qytetit. Projektet e gjerëtanishme të PPP janë me motive të rindërtimit të infrastrukturës elementare për zhvillim por jo si rezultat apo përgjigje për “pyetjet e qytetarëve”. Në mënyrë që qyteti të ketë mbështetje sociale ai duhet të i jep hapësirë qytetarëve për t’u bërë pjesëmarrës në procese, pronar i të dhënave dhe vlerësues e faktor ndryshimi.

Të gjeturat e analizës së qytetit të Prishtinës

Përkundër asaj që Prishtina si qytet posedon vlera dhe qendra për tërheqjen e zhvillimit ajo ballafaqohet me sfida të shumta. Prishtina ka vlerat e veta të njohura si: vlerat historike dhe kulturore që mbështesin një mjedis atraktiv për zhvillimin e inovacionit dhe konkurrencës, popullatë të re të aftë për të prodhuar ide të orientuara drejtë BE-së me interesim për ndërmarrësi, prezencë të faktorit ndërkombëtar të gatshëm për të ndihmuar qytetin. Ekonomia lokale e qytetit të Prishtinës është ekonomi kryesisht e orientuar drejtë mikrondermarrjeve sherbyese. Ku janë të regjistruara rreth 28,500 biznese prej tyre 13,306 janë operuese ku vetëm 4% janë me veprimtari perpunuese. Mungesa e produktivitetit ndikon në vlerën e lartë të importit dhe eksportit të ulet. Kështu qyteti i Prishtinës nuk siguron një ekonomi lokale konkurruese dhe të larmishme. (Komuna e Prishtinës, 2013). Fakti që në Prishtinë janë qendrat kryesore si: Prania e Qendrës Klinike Universitare, Universiteteve, Bibliotekës, Objekteve kulturore, Parkut regjional të Gërmisë, Pallatit të Rinisë, Teatros dhe qendrave multimediale etj. (Komuna e Prishtinës, 2013) ajo mbetet prapë qendër shumë e frekuentuar. Por vlerat nuk përkthehen në një zhvillim, qyteti kompromenton me fakte negative: si me nivelin e lartë të papunëve 60- 69% të pakualifikuar prej të cilëve 60% janë të grupmoshave kryesisht të popullatës aktive prej 25-39 vjeç (Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, 2013), reflektim të shkallës së lartë të varfërisë prej 21.8 % (World Bank, 2009), kushteve të dobëta për zhvillimin e një mjedisi inovativ, kualiteti i dobët i arsimit universitar dhe parauniversitar, praninë e vonshme dhe të cekët të menaxhimit digjital në institucione, pamjaftueshmërinë e inicimit të inkubatorëve të biznesit në universitete, nivelit të ulët të standardeve që ofrojnë hapësirat në qendra arsimore dhe kulturore. Partneriteti Publiko-Privat do të ishte një urgjencë për qytetin. Zhvillimi i bazuar në Njohuri ndonëse me prurje dhe kapacitete të mëdha nuk shënon vlerë dhe rritje ekonomike në vend pa siguruar zhvillimin e frymës së partneriteteve. Disa prej Universiteteve private tashmë kanë filluar të fokusohen në partnertete të shkëmbimit të studenteve, kuadrit arsimor dhe mjeteve me faktorin ndërkombëtar mirëpo ende ekzistojnë zbrazëtia me tregun e punës. Qendra e arsimit janë shëndrruar në biznese fitimprurëse që nuk veprojnë me kërkesën për vende të reja të punës por konkurrencë në treg dhe atraktivitetit të programeve të reja. Duke qenë se rinia synon një kualitet jete me të lartë studentët e rinjë janë aftësuar sa i përket gjuhëve të huaja dhe aftësitë nga TIK, të cilat aktualisht konsiderohen si aftësitë/njohuritë më të vlefshme të rinisë për t'u kyçur në tregun global të punës, përderisa me fusha të tjera të arsimit dhe ushtrimit të profesionit popullsia e përgjithshme mbetet me shkallë të lartë të papunëve dhe nivelit të ulët të të adhurave në bazë pagave aktuale.

Kapacitetet për një Zhvillim të Qëndrueshëm nuk promovohen sa duhet megjithëse Prishtina ka potencial për zhvillim të të rinjëve, ide-bizneseve që duhet të mbështeteten përshkak barrierave për investime në inovacion dhe ndërmarrësi. Prishtina ka nevojë për të zhvilluar një kulturë identiteti autentik dhe vlerësimi dhe kjo duhet të potencohet si përparësi e qeverisë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit që të ngritet vetëdija në lidhur me kërkesat e industrisë së qytetit dhe kualifikimi arsimor i punëtorëve. Rol të rëndësishëm në përmirësimin e të ardhmes së Prishtinës luan mbështetja institucionale dhe lidhshipi i ri në ardhje.

Aktualisht si inkubator biznesesh po shërbejnë vetëm universitetet private përderisa universitetet publike mbesin me një pjesëmarrje të ulët të ndikimit në zhvillim ekonomik të vendit, përmirësimin të praktikave të qyteteve të qëndrueshme, qasshmërisë, kualitetit të jetës dhe shkallës urbane. Ligji për konkurrencë i Kosovës ende ka nevojë që specifikohet edhe pse është në përputhje me standardet e BE-së. Për zhvillimin e inovacionit duhet të rritet fuqishëm numri i grupimeve për të inkurajuar shkëmbimin e njohurive dhe krijimin e një grupi të koncentruar të kualifikuar të punës. Kompanitë funksionuese duhet të jenë të hapura për bashkëpunim me Universitetet për të komercializuar veprimtarinë kërkimore të cilat janë të vogla në krahasim me vendet e rajonit. Mungesë të kapaciteteve organizative dhe investimeve në këtë sektorë për të udhëhequr role ndërmjetësuese ndërmjet akterëve të ndryshëm për të bërë biznes si dhe qeverisë përmes PPP. Ndërmarrjet e shumta janë pronë e ndërkombëtarve ose blihen nga ata duke mos u përcjellur me menaxhimin të transformimeve (aktiviteteve transformuese të pakta) nën udhëheqjen e lidërve të mirëkualifikuar me njohje ndërkombëtare jashtë vendit dhe përvojë të lartë në industrinë vepruese.

3.3. B. Analiza e strategjisë

Si adresohet Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban përmes indikatorëve të ZHBNJ dhe KO në strategjitë hapësinore të Prishtinës?

Në këtë kapitull analizohen strategjitë aktuale urbane që nga niveli qendror deri niveli lokal që përmbledhin orientimin e qytetit të Prishtinës në lidhur me zhvillimin e saj hapësinor. Masat, veprimet, objektivat, kriteret dhe qëllimet e strategjive janë analizuar duke vlerësuar përmbushjen e indikatorëve të teorive moderne urbane. Si burime të informacionit janë shfrytëzuar: Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174, Plani Zhvillimor Urban - Prishtina 2012-2022, Plani hapësinor i Kosovës 2010- 2020+, Vlerësimi strategjik mjedisor i planit zhvillimor urban të Prishtinës 2013-2023, Draft Raporti i Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës 2028, Ligji për Partneritet Publiko- privat, Strategjia për Partneritete Publiko-Private për Republikën e Kosovës 2014- 2016.

Të gjeturat paraqesin këndvështrime individuale të hulumtuesit.

Baza e njohurive: *Cilat janë objektivat dhe masat e parapara për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban përmes fushës së arsimit në qytetin e Prishtinës?*

Sipas planit zhvillimor urban të qytetit të Prishtinës, Komuna përkujdeset për provizionin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, në mesin e së cilës hyjnë: ndërtesat dhe pajisjet shkollore, transporti dhe mësimdhënësit. (Komuna e Prishtinës, 2013) Brenda përmbajtjes së strategjive për

zhvillim hapësinor të qytetit të Prishtinës, arsimit synon të arrijë objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm Urban duke siguruar sipërfaqën hapësinore të mjaftueshme për kokë banori brenda institucioneve të arsimit dhe mjetet financiare e teknike në dispozicion për një periudhë të caktuar kohore. Kështu Prishtina ka mungesë prej 237, 922 m² sipërfaqe për kopshte shkollore, mungesë prej 292,717 m² sipërfaqe të destinuar për institucione publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë në një zonë urbane, mungojnë gjithsejtë -131,505 m² sipërfaqe të destinuar për institucione publike të arsimit të mesëm të lartë. (INSI, 2021) Në përgjithësi zonat rurale për dallim nga ato urbane kanë hapësirë më të madhe për institucionet e arsimit përderisa në zonat urbane ka ngarkesë të lartë të nxënësve. Prandaj rregullimi i dendësisë brenda institucioneve të arsimit, duke e shpërndarë numrin e nxënësve në mënyrë të barabartë dhe ndërtimi i objekteve të arsimit në vendet e duhura paraqet një kërkesë për të hedhur bazën për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban. Në këtë proces pjesëtarët e komunitetit duhet të jenë vigjilent mbi pasojat e ndërtimit të objekteve shkollore në zona të papërshtatshme dhe regjistrimi mbi limitin e parashikuar. Megjithatë kultura e ulët urbane bën që komuniteti të mos respektojë normat e parashikuara me plan urban të qytetit. Kjo përbën një proces tjetër edukimi/ arsimimi drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.

Baza ekonomike- Çfarë masash planifikon strategjia urbane e qytetit të Prishtinës për promovimin e zhvillimit ekonomik, inovacionit dhe ndërmarrësisë?

Për zhvillimin ekonomik të bazuar në inovacion dhe ndërmarrësi, Komuna e Prishtinës konsideron si potencial shërbimet telekomunikuese, infrastruktura e së cilës është relativisht e mirë, megjithatë duhet të kryhen edhe investime të shumta për të përmirësuar situatën. *Shpërndarja e teknologjive dhe rrjetave të avancuara në Prishtinë është zhvilluar në një ritëm të parregullt dhe jo të koordinuar. (INSI, 2021)* Sfidë mbetet rregullimi i infrastrukturës për shtrirjen nëntokësore të kabllove. Për përmirësimin e situatës në planin zhvillimor urban, Komuna ka për qëllim të përmirësojë sektorët e saj përmes së impaktit të saj në këto aspekte: ekonomik, qarkullim, infrastrukturë dhe funksionet e qytetit. Sipas Strategjisë së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Kosovë prioritet i është dhënë fuqizimit të konkurrueshmërisë së sektorit privat nëpërmjet përfitimit të efikasitetit, miratimit të praktikave inovative operative, praktikave të përmirësuar menaxheriale, mjedisit të përmirësuar biznesor dhe qasjes në financa. (Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, 2019) Megjithatë ende ka sfida të mëdha në rritjen ekonomike të vendit.

Kualiteti i jetës- Cilat masa dhe veprime përmbledhen në strategjitë hapësinore të qytetit Prishtinës për përmirësimin e kualitetit të jetës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të qytetit?

Kualiteti i jetës në qytetin e Prishtinës sipas planit zhvillimor urban dhe planit hapësinor të Kosovës lidhet me një mori faktorësh. Plani zhvillimor urban i Prishtinës e llogarit Prishtinën si

vendbanim i një tërësie të vetme pa lënë anash zonat urbane, lagjet, njësitë e vogla dhe vendbanimet përreth. Megjithatë sfida qëndron në zbatimin praktik të PZHK dhe dakordimi me planet zhvillimore të hollësishme që nuk janë të përfshira në PZHK për rregullimin e infrastrukturës të njërive të vogla të cilat duhet të bazohen në objektivat strategjike të PZHK. Menaxhimi i tokave, pronave, ndërtimeve dhe shpyllzimi mbeten shqetësuesit më të mëdhenj në kohën e urbanizmit të shpejtë të Prishtinës, prej të cilave varet indirekt dhe direkt kualiteti i jetës në Prishtinë.

Qasshmëria- *Çfarë strategjie synon Prishtina në mënyrë që të bëhet më e qasshme dhe cilat janë objektivat kryesore për zhvillim?*

Duke qenë se Prishtina ka pozitë strategjike dhe shënon urë lidhëse për shumë regjione me rëndësi qyteti i Prishtinës synon të zhvillojë qasshmërinë e saj në kontekst të transportit/ trafikut urban duke u bazuar në Planin e saj për Mobilitet i cili ka për qëllim promovimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban duke u bazuar zgjidhur problemet e mbingarkesës në trafik dhe vonesat nga to, çështjet e integritit të mobilitetit urban, shfrytëzimit më të mirë të hapësirave në zonat urbane. (Komuna e Prishtinës, 2019)

Shkalla urbane- *Në bazë të çfarë koncepti duhet të rritet qyteti i Prishtinës ashtu që të paraqet një koncept realist por i qëndrueshëm dhe bashkëkohor?*

Koncepti i zhvillimit të balancuar rajonal dhe policentricitetit të Prishtinës nënkupton mundësinë për të funksionuar si qytet i qëndrueshëm duke përfshirë bashkëpunimin me zonën e Obiliqit, Podujevës, Fushë-Kosovës, Lipjanit dhe Novobërdes. Në këtë rrugëtim ajo duhet të fillojë ndërtimin e koridorëve që bashkojnë këto rajone, gjë që mund të arrihet përmes formave të bashkëpunimeve ekonomike, infrastrukturës, funksioneve arsimore e kulturore.

Diversiteti urban- *A ka vend për zhvillimin e diversitetit urban në strategjitë urbane të qytetit të Prishtinës?*

Diversiteti urban si koncept i plotë që lidhet me zhvillimin e qytetit të Prishtinës, në përmbajtjen e strategjive urbane përfshihet brenda konceptit gjithëpërfshirje apo inkluzivitet. Prishtina si qytet inkluziv është synim përderisa ajo ende përballet me nevojat elementare për sigurimin e infrastrukturës rrugore, ujore, elektrike, arsimore dhe kulturore, zhvillimi ka më tepër të bëjë me plotësim dhe stabilizim të situatës së vështirësuar ekonomikisht sesa në aspektin socio-kulturor. Popullata e përgjithshme është ende problemi kryesorë prandaj problemet shtrohen në trajtë të përgjithshme dhe nuk i referohen ndonjë grupi specifik të problemeve në lidhur me diversitetin.

Instrumenetet politike duhet të liberalizojnë diversitetin urban në mënyrë që ai të shikohet si aset dhe mënyrë e re për të prodhuar të dalura të suksesshme (positive outcomes).

Barazia sociale- *A promovet barazia sociale përmes strategjive urbane hapësinore (planit zhvillimor) të qytetit të Prishtinës?*

Në strategjitë urbane hapësinore, barazia sociale e qytetit të Prishtinës figuron në vizionin e sektorëve të saj zhvillimore. Kështu në sektorin ekonomik, qyteti i Prishtinës synon të jetë mbështetes i ekonomisë urbane dhe rurale, promovimin e shërbimeve ekonomike, prodhuese, e turistike për të gjithë banorët e saj por edhe ata të zonave rurale. Në aspektin e banimit synon të bëhet qytet i strehueshëm, gjithëpërfshirës, me kushtet optimale për jetesë për të gjithë banorët duke aplikuar edhe teknologji/inovacion dhe format të mençura (smart) të banimit. Në aspektin e shëndetësisë synon të sigurojë qasje të lehtë për të gjithë anëtarët e komunitetit. Në aspektin e mirëqenies sociale, përkrahje për të gjithë banorët me nevojë etj. (INSI, 2021)

Lidershipi/ Udhëheqja- *Sa i rëndësishëm është roli i lidërshiptit brenda strategjive urbane të qytetit të Prishtinës për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban?*

Konsiderohet prej çështjeve me pak të trajtuara në zgjidhjen e sfidave të qytetit. Pos organizimit regional i cili hapë dyer për mundësi të reja në lidhur me organizimin e departamenteve sëbashku për krijimin e qasjes së integruar për qytetin e Prishtinës, duhet patjetër ndërveprimi që bashkon strukturat udhëheqëse duke plotësuar njëra- tjetren në planet e veprimit. Në momentin që “dija” shëndrohet në kuptueshmëri lidërshipti do të udhëheqë qytetin drejtë ndryshimeve pozitive dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ende zhvillohet fryma negative e konkurrencës për qëllime autoriteti dhe vendimmarrje dhe jo për zhvillim dhe konkurrencë të bazuar në zhvillim. Mungojnë ende format e reja të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe formave të mençura të rekrutimit. Vlen të përmendet që si fakt pozitiv është vlerëuar edhe “strategjia e mosbërjes asgjë” e njejtja duhet të shfrytëzohet edhe nga lidërshipti i Prishtinës, për të përceptuar të këqijat si argument për ndryshim. Rivitalizimi urban, rigjenerimi urban, balanci socio-ekonomik, kohezioni socio-ekonomik dhe qytet i artit dhe kulturës janë termat që duhen të shënojnë kapitujt e ri të qytetit të Prishtinës. Termi “dizajn urban” logjikisht do të keqkuptohet shumë duke iu referuar ndërtimeve dhe zënies së hapësirave të reja nga ana e udhëheqësve. Pa koncepte të drejta urbane, lidërshipti do të jep leje për kaosin urban të vazhdueshëm të qytetit të Prishtinës i cili nuk ka shanse të del nga periudha e tranzicionit.

Mbështetja politike- Cilat janë objektivat e parapara në strategji për zhvillimin e qytetit drejtë ZHQU?

Bazuar në planin zhvillimor urban të qytetit të Prishtinës, Komuna e Prishtinës i ka mbështetura objektivat e saja në ekspertiza ndërkombëtare dhe në bazë të parimeve dhe standardeve evropiane. Objektivat e saj i klasifikon në dy lloje: primare apo globale dhe komunale apo lokale. Në këtë plan të objektivave hyn:

□ *Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave, ku të gjithë aktorët e kryera të drejtën e tyre për të ditur, për t'u dëgjuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën dhe tendencat e tij. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;*

Vlerësimi Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës
155

□ *Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socioekonomike, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;*

□ *Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, eliminimin e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;*

□ *Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj);*

□ *Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillim. (INSI, 2021)*

Mbështetja sociale- Si mund të konstatohet strategjia e qytetit të Prishtinës se ka arritur mbështetjen sociale?

Si kriter i rëndësishëm për një funksionim normal të qytetit si një tërësi e vetme, qytet i dijës, i qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes, mbështetja sociale nuk figuron mjaftueshëm në dokumentet hapësinore të qytetit. Sistemi aktual i qeverisjes lokale të qytetit i njeh dhe i vlerëson kapacitetet e veta përmes vetvetës dhe qendrave statistikore ku qytetari përfaqëson numër dhe gjendje po jo problemin direkt. Si i tillë qyteti zhvillohet me identitetin e vet si i huaj me banorët e saj. Realisht në strategjitë urbane hasim termat “mirëqenie e përgjithshme sociale”, “mbështetje institucionale”, “zhvillim social” apo “kujdes apo siguri socio-ekonomike”, “ndërveprim me qytetarin”. mirëpo ende paraqesin sfidë duke qenë se qyteti i Prishtinës duhet të zhvillojë instrumentë efikas që lejojnë zhvillimin duke u parë qytetarin si shtyllë të rëndësishme së cilit i shërben qyteti i Prishtinës. Organizmi i duhur i E-qeverisjes si dhe format e tjera që sigurojnë Feedback-un konstruktiv të qytetarëve në politikbërje dhe vendimmarrje janë më së të nevojshme. Megjithatë Komuna mund të fillojë me projekte të vogla të cilët mundësojnë kycjen online të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Për një funksionim të suksesshëm të qyteti, Kryetari i qytetit duhet t'i prinë proceseve pro mbështetjes sociale. Sipas programit të qeverisë së Kosovës

2021-2025 në mënyrë që qeverisja të jetë e hapur dhe transparente për qytetarë parashikon që të reformojë administratën publike përmes modernizimit të saj, duke filluar nga rregullimi i sistemit të pagave, sistem të ri dhe transparent të procesit të rekrutimit, skemave të veçanta të profesionalizmit të shërbimit civil, dixhitalizimin e shërbimeve publike përmes platformës E-komunat etj. (Republika e Kosovës, 2021)

Të gjeturat nga analiza e strategjisë

Aktualisht strategjitë lokale hapësinore/ urbane në Kosovë janë kryesisht strategji sektoriale që i përgjigjen natyrës komplekse të qytetit dhe informatave të grupuara në bazë të sektorëve veç e veç. (Komuna e Prishtinës, 2013) Këto strategji nuk sigurojnë vëmendje të duhur ndaj implementimit të kohezionit territorial brenda sistemeve dhe nënsistemeve të një sektori. Struktura hapësinore e qytetit të Prishtinës është kyesisht monocentrike me policentricitet të zhvilluar kurse me tendencë metropolitane. (Pallaska, 2014) Kjo strukturë në proces nuk është rezultat i një Zhvillimi të Qëndrueshëm Urban por është pasojë e një urbanizimi të pakontrolluar. Këtë e dëshmon vetë fakti që përkundër asaj që planifikimi strategjik është në veprim (Plani hapësinor i Kosovës, 2010-2020+) dhe që mbështetet tërësisht zhvillimin e qytetit të Prishtinës, si qytet i qëndrueshëm nxirret në pah mungesa e konceptimit të statutit ligjor të “qytetit si promotor i zhvillimit” në Ligjin për Planifikim Hapësinor Nr. 04/ L-174 si dokumenti më i lartë strategjik-hapësinor. Në anën tjetër objektivat për të shëndërruar qytetin e Prishtinës në gjenerator të zhvillimit nuk paraqesin mundësi, por sfidë në mungesë prioritetesh. Gjatë periudhës së re dhjetë vjeçare pas shtetformimit të Kosovës që nga viti 2008, moszhvillimi është arsyetuar se qytetet nuk paraqesin territore të pavarura për vetzhvillim sepse shteti nuk është konsoliduar. (Republika e Kosovës, 2008) Thirrja për krijimin e identiteteve të qëndrueshme të qyteteve është penguar qoftë nga mospërputhja kohore e veprimeve nga ana e autoriteteve lokale në proceset e planifikimit dhe realizimet të planeve. Në anën tjetër nëse shqyrtohet dokumenti strategjik i Partneritetit Publiko- Privat në Kosovë vihet në përfundim se ai është një kompozim i krijuar nga strategjitë e politikave dhe orientimeve sektoriale, ku mungesa e vetëdijës së konceptimit të hapësirës dhe zhvillimit nga ana e autoriteteve lokale për shfrytëzimin e Partneritetit Publiko- Privat është fakt evident. (Republika e Kosoves, 2014) Aktualisht komunat janë në një fazë të njohjes me impaktin që mund të arrijë një PPP, ndonëse PPP e ka bazën e vetë ligjore (Ligji për PPP Nr.04/ L-045) dhe institucionale (Komiteti dhe Departamenti për PPP). Pengesë për zhvillimin e ambientit të favorshëm për PPP paraqesin prioritetet qeveritare dhe procesi i planifikimit të buxhetit ku mungon koncepti- ideja për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban. Kësisoj nevoja për rivitalizimin e dokumenteve strategjike me koncepte të administrimit territorial të qyteteve të qëndrueshme përmes dispozitave të dokumenteve të BE është kërkesë spontane e cila duhet të realizohet gradualisht kur dihet që në fillim që Ligji për Partneritet Publiko- Privat në Kosovë është hartuar në përputhje me kriteret e BE-së dhe BERZH-së. Mirëpo komunat kanë përvojë të vogël në përdorimin e PPP e sidomos në

menaxhimin e qëndrueshëm urban. Strategjitë duhet të ndjekin përvojat e rregulloreve mbi PPP në BE, ku ai cilësohet si model i përshtatshëm duke u bazuar në kritere të caktuara të përputhshme me objektivat e politikave regjionale dhe të kohezionit territorial.

3.4. C. Analiza e pyetësorit

Rasti studimor: Nënkalimi në lagjën “Bill Clinton” në Prishtinë.

Nënkalimi nën bulevardin “Bill Clinton” luan një rol të rëndësishëm në qytetin e Prishtinës meqë është urë lidhëse ndërmjet lagjeve të qytetit “Dardania” me atë “Pejton” dhe kështu mundëson një frekuentim të madh ditor të qytetarëve si pikë takimi për zhvillimin e lidhjeve ekonomike dhe sociale të qytetarëve në këtë zonë të Prishtinës. Projekti është dhënë me koncesion nga ana e Komunës së Prishtinës dhe ndërtimi i tij ka filluar në vitin 2009 dhe është mbyllur saktësisht një vit më vonë. Nënkalimi përfshin një sipërfaqe prej 17.000 m² në përbërjen e të cilit janë: 13 dyqane, WC-toalet, ashensor, shkallët elektrike, hapësirën e gjelbër, fontanën, etj. Investimet në projekt kapin vlerën prej 2.5 milion euro.



Fig. 17. Pamje nga nënkalimi në lagjën “Bill Clinton” në Prishtinë, Burimi: <https://allzoneks.com/ndertimore/>

A arrin të promovojë suksesshëm projekti i nënkalimit me Parneritet Publiko- Privat, Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban në qytetin e Prishtinës? Çfarë vlerësime japin të intervistuarit?

Pyetësori është zhvilluar me 90 pjesëmarrës të kategorive të ndryshme në lidhur me nënkalimin në lagjen “Bill Clinton” në qytetin e Prishtinës të anketuar në pyetje për secilin indikator nga një

pyetje. Grupet e intervistuarra përfshijnë: tridhjetë pjesëmarrës nga autoriteti lokal (zyrtarë komunal të Prishtinës dhe departamenti për planifikim urban), tridhjetë pjesëtarë nga dyqanxhinjtë (tregtarët apo përfaqësues të bizneseve brenda dhe jashtë nënkalimit) dhe tridhjetë kalimtarë të rastit në nënkalim (brenda dhe jashtë tij).

Grupe janë përzgjedhur për shkak kontaktit me vet nënkalimin dhe informatave në lidhur me këtë nënkalim qoftë si tregtar, shërbyes apo autoritet lokal që ka informata rreth tij. Pyetjet kanë qenë të tipit të mbyllur dhe janë parashtruar për të gjithë pjesëmarrësve të njejtat në lidhur me plotësimin e indikatorëve të teorive moderne urbane. Formulimi i pyetjeve është opinion i hulumtuesit në lidhur me indikatorin urban mbështetur në bazat e teorive moderne urbane: Zhvillimit e bazuar në Njohuri dhe Kapaciteteve Organizative.

Shkalla e përgjegjeve është matur me poena me pesë alternativa të mundshme:

(-2) shumë dobët;

(-1) pamjaftueshëm;

(0) pa ndikim;

(1) mirë;

(2) shumë mirë;

Shkalla e vlerësimeve në bazë pikëve të fituara:

<i>Pikët e fituara</i>	<i>Vlerësimi</i>
<i>>10</i>	<i>Negativ</i>
<i>10-30</i>	<i>Pa ndikim</i>
<i>30-40</i>	<i>Pozitiv</i>
<i>40-55</i>	<i>Mirë</i>
<i>55-60</i>	<i>Shumë mirë</i>

Pyetëtori është analizuar në aspektin e teorive veç e veç duke dhënë një vlerësim të përgjithshëm për teorinë në fund nga shuma e të gjithë kategorive dhe në bazë kategorive të caktuara në lidhur me të dy teoritë (duke potencuar indikatorin më pozitiv, negativ dhe neutral). Rezultati maksimal pozitiv për çdo kategori vlerësohet me notën 2, si rezultat kulmi më i lartë është 60 për çdo kategori. Rezultati final në lidhur me suksesin e nënkalimit është paraqitur në bazë shumës së rezultatit të dy teorive me tri kategori të anketuarve.

Rezultatet e pyetësorit janë ilustruar në formë të diagramit dhe tabelare. Rezultatet janë interpretuar në dy aspekte: në trajtë të përgjithshme (në bazë të llojit të indikatorëve dhe teorive për të gjithë pjesëmarrësit) dhe në bazë të rezultatit për kategori në lidhur me indikatorë dhe suksesit të teorive ZHBNJ dhe KO.




Fig. 18. Plotësimi i indikatorëve të ZHBNJ në bazë të tri grupeve: Komuna, Tregtarët dhe Kalimtarët, Burimi: Autori, (2021)




Fig. 19. Plotësimi i indikatorëve të KO në bazë të tri grupeve: Komuna, Tregtarët dhe Kalimtarët, Burimi: Autori, (2021)




Fig. 20. Rezultati i përgjithshëm i plotësimit të indikatorëve të ZHBNJ dhe KO në projektin e nënkalimit në lagjen Bill Clinton, Burimi: Autori , (2021)

Të gjeturat nga analiza e pyetësorit

A. Në bazë të interpretimit të rezulttit përmes tre kategorive pjesëmarrëse në hulumtim:

- Grupi i pjesëmarrësve nga autoriteti lokal (Komuna) rezulton më pozitiv në indikatorët e Kapaciteve Organizative sesa Zhvillimit të bazuar në Njohuri. Duke vlerësuar lartë vizionin, mbështetjen politike, mbështetjen sociale dhe PPP. Kurse te ZHBNJ vlerësohet si e suksesshme: baza ekonomike, qashmëria dhe kualiteti i jetës.
- Grupi i pjesëmarrësve nga tregtarët- rezulton me rezultat të përafërt në të dy teoritë duke vlerësuar lartë: bazën ekonomike dhe kualitetin e jetës. Kurse te KO vlerësohet me sukses: mbështetja politike, PPP dhe liderhipi.
- Grupi i pjesëmarrësve nga kalimtarët- rezulton barabartë në indikatorët e dy teorive duke vlerësuar pozitivisht mbështetjen sociale, PPP te KO kurse te ZHBNJ bazën ekonomike dhe qashmërinë. Për dallim nga grupet tjera vlerësojnë më ulët liderhipin dhe mbështetjen politike.

B. Në bazë të interpretimit të rezultatit përmes indikatorëve dhe teorive ZHBNJ dhe KO

- Indikatorët më të suksesshëm konsideroheshin baza ekonomike, qasshmëria, mbështetja sociale, mbështetja politike. Indikatorët me vlerësim neutral janë barazia sociale dhe diversiteti urban. Kurse indikatorë negativ nuk kishte.
- Në bazë të interpretimit të rezultatit të teorive urbane, teoria e ZHBNJ vlerësohet me arritje të njëjtë me teorinë e KO.
- Në bazë të interpretimit të rezultatit të shumës së dy teorive ZHBNJ dhe KO, hulumtimi përmes anketës vlerësohet si projekt i suksesshëm, ashtu që prej 12 indikatorëve të gjithë rezultojnë si pozitiv.

Roli i PPP në kontributin e tij drejtë ZHQU është i njohur më shumë në aspektin ekonomik por i panjohur në aspektin e qëndrueshmërisë, mençurisë dhe gjithëpërfshirjes. Qytetarët shprehen pro pritjes së llojit të tillë të investimeve duke siguruar mbështetjen e plotë sociale. Autoritetet lokale mbështeteshin politikisht lloje të tilla të investimeve për të cilat ende mungojnë përvojat e thella komunale të shfrytëzimit të PPP për një ZHQU. Procesi i edukimit dhe huazimit të praktikave të qëndrueshme të BE mbi zhvillimin dhe fuqizimin e PPP mbetet obligim për autoritetin lokal kurse komunikimi i vizionit dhe strategjisë në zhvillimin e bashkëpunimit dhe transparencës me qytetarë të Prishtinës nuk duhet të mungojë.

3.5. Sinteza e tri analizave të punimit

Ky kapitull shënon sintezën e të gjithë analizave: Analiza e qytetit (A), Analiza e strategjisë (B) dhe Analiza e anketës (C). Nga sinteza e analizave vihet në përfundim që indikatorët me të suksesshëm janë: baza ekonomike, mbështetja sociale dhe qasshmëria.

Rezultati përfundimtar është paraqitur përmes tabelës më poshtë me notën që përfaqëson mesataren e vlerësimit të gjithë analizave veç e veç dhe shumës së tyre.

SINTEZA	Analizat			
	Indikatorët	A.Pozita e qytetit	B. Strategjia	C. Anketa
	<i>Zhvillimi i bazuar në Njohuri</i>	1. Baza e njohurive	Mirë (1)	Mirë (1)
2. Baza ekonomike		Mirë (1)	Mirë (1)	Shumë mirë (2)
3. Kualiteti i jetës		Neutral (0)	Neutral (0)	Mirë (1)
4. Qasshmëria		Neutral (0)	Neutral (0)	Shumë mirë (2)
5. Diversiteti urban		Neutral	Mirë	Neutral
6. Shkalla urbane		Mirë	Mirë	Mirë
7. Barazia sociale		Neutral (0)	Neutral (0)	Neutral (0)
<i>Kapacitetet Organizative</i>	8. Lidershipi/Udhëheqja	Neutral (0)	Neutral (0)	Mirë (1)
	9. Vizioni/ Strategjia	Mirë (1)	Mirë (1)	Mirë (1)
	10. Mbështetja sociale	Shumë mirë (2)	-	Shumë mirë (2)
	11. Mbështetja politike	Mirë (1)	Mirë (1)	Shumë Mirë (1)
	12. Partneriteti Publiko-Privat	Neutral (0)	Neutral (0)	Shumë Mirë (2)
<i>Qyteti i Prishtinës</i>	Rezultati i Analizës:	Neutral	Mirë	Shumë Mirë
	Rezultati i Analizave: A+B+C	Mirë		

Tabela 4. Sinteza e Analizave, Burimi: Autori (2021)

Kaptina IV - Konkluzionet dhe rekomandimet

4.1. Konkluzioni dhe rekomandimi 1- Në lidhur me potencialet dhe pozitën e qytetit drejtë një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban

Qyteti i Prishtinës paraqet qytet me potenciale të shumta për zhvillim. Qyteti ka nevojë të theksuar për format e ndryshme të Partneritetit Publiko- Privat me Komunën në mënyrë që të investojë në infrastrukturë dhe modele dixhitale të qeverisjes së hapur dhe transparente në gjendjen e tanishme tranzicionale. Qyteti duhet të realizohë njohje ndërkombëtare dhe rritet në aspektin regjional që të binjakëzohet në bashkëpunim me qytetet e zhvilluara evropiane. Vlerat e qytetit duhet të promovojnë atë si qendër zhvillimi, ekonomike dhe me potenciale të shumta për zhvillim sikurse të rinjtë e saj të avancuar në shkollim. Procesi i rekrutimit të udhëheqësve duhet jetë proces transparent që përfaqëson shumicën e banorëve të qytetit të Prishtinës. Komuniteti i Prishtinës duhet të vetëdijësohet për dallimin ndërmjet “progresit” dhe “regresit” të qytetit dhe indikatorët për zhvillim. Investimi në kulturë lokale dhe regjionale paraqet garancinë më të madhe për zhvillim edhe atëherë ku nuk ka zgjidhje “one size fits all” (një zgjidhje për gjithçka). Qyteti i Prishtinës konsiderohet si qytet i ri por me urbanizim kaotik i nevojshëm për lidhshmëri të drejtuar drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban. Inkurajohet fuqishëm implementimi i PPP për rregullimin e subsidiaritetit vertikal dhe horizontal të qytetit.

4.2. Konkluzioni dhe rekomandimi 2 –Në lidhur me strategjitë hapësinore të qytetit të Prishtinës

Rregullimi i strategjisë për zhvillim të qytetit të Prishtinës, fillon me rregullimin e programit të qeverisë i cili duhet të njeh konceptin qytet, regjion dhe metropol si terme të reja duke u liruar nga koncepti “Komunë”. Duhet të rregullohet plani për vetqeverisje lokale në të cilën qyteti shihet si tërësi e vetme për të funksionuar qasja e njejtë në strategjitë zhvillimore të qytetit dhe Ligji për planifikim hapësinor. Ligji për planifikim hapësinor të përkufizojë njësitë më të vogla, më të mëdha sesa qyteti dhe vet qytetin. Planet e hollësishme hapësinore të mos hartohen ndaras dhe në aspekte të ndryshme kohore. Planet zhvillimore të hollësishme duhet të jenë synimet operationale dhe të specifikohet planifikimi hapësinor, shtirja, infrastruktura dhe funksionet e tyre. Në hartimin e tyre duhet aplikuar parimet, standardet evropiane dhe transparencën në informim të qytetarëve. Procesi i hartimit të jetë transparent dhe i mjaftueshëm në kohë që të përfshihet komuniteti i gjërë i qytetit të Prishtinës. Të investohet në aktualizimin e të dhënave rreth ndryshimeve statistikore në qytet dhe përlllogaritja e përafërt në bazë tyre si dhe të gjitha formave që mbështetesin dhe zhvillojnë kulturën lokale, regjionale e metropolitane. Gjithashtu të përcaktohen qartë kompetencat e autoriteteve urbane duke e trajtuar Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban si prioritetin më të lartë në një qasje të integruar brenda çdo sektori të Ministrisë për planifikim hapësinor. Të përcaktohet lidhje strategjike ndërmjet PPP dhe zhvillimit hapësinor të qytetit të Prishtinës.

4.3. Konkluzioni dhe rekomandimi 3- Në lidhur me vlerësimet që japin njerëzit e Prishtinës rreth nënkalimit me PPP për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban të qytetit

Në bazë të vlerësimeve të pjesëmarrësve në hulumtim, qyteti i Prishtinës mund të rigjenerojë kapacitetet e veta drejtë ZHQU duke implementuar projekte me PPP në infrastrukturën urbane që kontribuojnë në shumë sfera të zhvillimit të jetës së qytetarëve të Zhvillimit të bazuar në Njohuri. Për këtë qëllim Prishtina siguron mbështetje të fuqishme sociale. Me theks të veçantë PPP ndikon pozitivisht në bazën ekonomike, qasshmërinë, kualitetin e jetës etj. Megjithatë sa i përket Kapaciteteve Organizative është rezultati dukshëm më i ulët në sistemin aktual qeverisës të qytetit të Prishtinës ku vizioni/strategjia nuk mungon në parashikimin e mundësive për zhvillim me PPP e cila nuk promovohet aq sa duhet. Në anën tjetër projektet me PPP duhe të sigurojnë arritjen e barazisë sociale dhe promovimin e diversitetit urban si projekte gjithëpërfshirë dhe jo vetëm projekte për qëllime ekonomike.

Rekomandohet që Prishtina të ketë të dhëna të sakta mbi zonat me dendësi më të lartë, jo të qasshme dhe jo gjithëpërfshirëse të Prishtinës, të cilat janë qendra të sfidave të mëdha dhe të përcaktohen indikatorët dhe nënindikatorët përkatës ashtu që të njihet situatë reale dhe barrierat eventuale.

Rekomandohet që Kapacitetet Organizative të promovojnë PPP si zgjidhje për Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës. Të rritet numri i projekteve urbane me PPP që kanë për qëllim zgjidhjen e problemeve të lagjeve me dendësi të lartë të popullsisë përmes kriterëve të teorive moderne urbane.

4.4. Konkluzionet dhe rekomandimi finale- Në lidhur me ZHQU të Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban përmes PPP

Për një të ardhme drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës, zgjidhjet e sfidave dhe problemeve urbane duhet kërkuar në përpjekje për të përcaktuar indikatorët e teorive moderne si bazë për qytete të qëndrueshme.

Për matjen dhe vlerësimin e indikatorëve urban inkurajohet fuqishëm zbatimi i Partneriteteve Publiko-Private për të përfitur nga përvojat, njohuritë dhe mjetet financiare të partnerëve vendor e ndërkombëtar në bashkëpunim me Komunën.

Partneritetet Publiko- Private gjejnë zbatim në çdo segment të Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të jetës në Prishtinë e sidomos si qytet në tranzicion paraqet burim adekuat për zhvillim.

Institucionet e larta publike dhe private të arsimit duhet të luajnë rol aktiv në shtimin e studimeve/hulumtimeve shkencore që janë të rëndësishme në sferën e Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të qyteteve të Kosovës, veçanti qytetit të Prishtinës dhe lagjeve të saja.

Mediat, shoqëria publike, komunitet dhe OJQ-të duhet të promovojnë fuqishëm rolin, vlerat dhe edukimin mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban.

Strategjitë urbane hapësinore duhet të bazohen në modelet evropiane të qeverisjes urbane duke marrë për bazë dokumentet për qytete të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të mençura sikurse Axxhenda e Re Urbane dhe Axxhenda Territoriale 2030 në lidhur me të ardhmen e zhvillimit territorial të qytetit të Prishtinës.

Autoritetit lokal (Komuna) duhet të shërbehet nga praktikatat udhëheqëse dhe politikatat e mençura të qyteteve evropiane në lidhje me zgjidhjen e të problemeve qytetarëve dhe të kultivohet kulturë lokale të qytetit duke bashkëpunuar ngushte me bizneset dhe qytetarët.

Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-74 dhe Ligji për Prishtinën, duhet të rishqyrtohen dhe plotësohen me parime, nocione dhe kompetenca të qarta mbi planifikimin hapësinor të qëndrueshëm të qytetit.

Praktikat në lidhje me PPP në Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban duhet të zhvillohen strategjikisht dhe me përvojën e qyteteve evropiane dhe bashkëpunim me komunën.

Prishtina ka nevojë të mësojë nga praktikatat e qyteteve të mençura evropiane duke i vizituar ato dhe përcjellë menaxhimin e qëndrueshëm të qytetit.

Planifikimi hapësinor i qytetit të Prishtinës duhet konsideruar si prioritet qeverisës, pa marrë parasysh progresin e shtetit të Kosovës, centralizimin e institucioneve apo fazën e integritit drejtë Bashkimit Evropian. Prishtina duhet të kuptojë politikatat e kohezionit të BE në eliminimin e pabarazive socio-ekonomike . Strategjitë sektoriale të shtetit me qytet duhet të kenë aspekte kohore të njëjta të përpilimit.

Planifikimi hapësinor duhet të përfshijë edhe dimensionin territorial dhe konceptin e kulturës si indikator për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban. Parimi i subsidiaritetit duhet të aplikohet, me fjalë të tjera zhvillimi urban territorial duhet të ndërmerret në nivelin më të ulët të përshtatshëm.

Qyteti i Prishtinës vuan nga mungesa e PPP dhe se ajo nuk paraqet vetëm alternativë për zhvillim por domosdoshmëri përderisa struktura e saj urbane është pashtu duke ecur spontanisht drejtë regjionalizimit. Ajo duhet të inspirohet nga politikatat e regjionalizimit të qyteteve të Evropës përmes dialogimi të politikave regjionale nga bashkëpunim me European External Actions Service (EEAS) dhe the external relations family of Directorates General (DEVCO and DG TRADE).

Kultura urbane duhet të promovohet dhe mbrohet fuqishëm nga planerët urban përmes aktiviteteve të ndryshme të qytetit në bashkëpunim me Komunën. OJQ, delegacioni ndërkombëtar dhe mediat.

Qyteti i Prishtinës duhet të investojë në zhvillimin e dixhitalizimit përmes inkurajimit të rinjëve të kontribojnë përmes ideve të tyre inovative në Zhvillimin e Qëndrueshëm Urban të qytetit. Në këtë drejtim PPP duhet të shërbejë si mjet mbështetës financiar për realizimeve e projekteve të mençura dhe të qëndrueshme.

Vërtetimi i hipotezave

Në bazë të rezultateve të marra nga rasti studimor konkludojmë se plotësohet hipoteza:

PPP arrin të orientojë suksesshëm qytetin e Prishtinës drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.

Edhe pse mungojnë praktikatat ligjore dhe rrethanat e planifikimit të bazuar në indikatorë urban të qëndrueshëm, qytetarët japin mbështetje sociale për orientimin e qytetit përmes PPP drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban.

Ende duhet të elimonohen barrierat ligjore, duke ndarë kompetencat për përkufizimin e qytetit si organ i pavarur nga Komuna. Kulturës për partneritete publiko- private duhet të i kushtohet rëndësi dhe monitorim ndërkombëtar duke sjellë praktikatat e qyteteve të zhvilluara evropiane.

Zhvillimi i Qëndrueshëm Urban duhet të bëhet pjesë e boshllëkut të çdo lloj strategjie sektoriale duke krijuar një harmonizim të objektivave të përbashkëta për zhvillim.

Konceptet si kohezion territorial, kulturë lokale urbane, partneritet publiko- privat dhe dixhitalizim duhet të njihen si burime të reja për tërheqjen e investitorëve, integrimin ekonomik dhe social të qytetit të Prishtinës si qytet global me potenciale të shumta për zhvillim.

4.5. Kahjet e ardhshme për studim

Si kahje e ardhshme për studim: “Promovimi i kohezionit territorial përmes transformimit dixhital për një Zhvillim të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës”

Hipoteza e parë do të ishte:

1. Promovimi i kohezionit territorial drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës është i suksesshëm përmes transformimit të saj dixhital.
2. Promovimi i kohezionit territorial drejtë Zhvillimit të Qëndrueshëm Urban të qytetit të Prishtinës nuk është i suksesshëm përmes transformimit të saj dixhital.

“Që nga viti 1986, objektivi e politikës së kohezionit ka qenë forcimi i kohezionit ekonomik dhe social. Traktati i Lisbonës dhe strategjia e re e nivelit të lartë të BE-së (Evropa 2020) prezantojnë një dimension të tretë: kohezionin territorial.” (Bashkimi Evropian, 2021)

Digjitalizimi në kohën e sotme të qyteteve të shek XXI paraqet çelës për realizimin e suksesshëm të kohezionit territorial. Përmes tij qyteti siguron lidhshmërinë, qasshmërinë dhe efikasitetin e shërbimet publike të qytetarëve duke siguruar që të gjithë të përfshihen brenda transformimit digjital. Qytetet dhe regjionet duhet të integrohen përmes dixhitalizimit sepse ai paraqet shans të barabartë për të gjithë qytetet pa marrë parasysh fazën zhvillimore të tyre apo formën e rregullimit hapësinor të qyteteve. Qytetet arrijnë të bëhen atraktive përmes zhvillimit të tyre dixhital e inovativ duke i dhënë atyre tiparët e konkurrencës në tregun global ekonomik, si mundësi për të qenë pjesë e qyteteve të mençura dhe të qëndrueshme.

-Fund-

Bibliografia

1. Adler, Laura (2017) *Getting Insight Into Inequality: How Cities are Investing in Social Equity Indicators*, e qasshme në: <https://datasmart.ash.harvard.edu/news/article/getting-insight-into-inequality-how-cities-are-investing-in-social-equ1-114> , (qasur me 02.11.2021)
2. Beqaj, Binak (2012) *Participation of Community in Urban Management-Case of Prishtina*, f.4
3. Carrillo (2015) *Knowledge-based development as a new economic culture*, f.2
4. COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES (2008) *Green Paper on Territorial Cohesion. Turning territorial diversity into strength*, f.6-9
5. Deloitte Center for Government Insights (2018) *Using public-private partnerships to advance smart cities*, e qasshme në: <https://www2.deloitte.com/content/dam/Deloitte/global/Documents/Public-Sector/gx-ps-public-private-partnerships-smart-cities-funding-finance.pdf> (qasur me 22.09.2021)
6. Dennes (2019) *Financial Instruments in Cohesion Policy*, European Week Brussel 7-10 October 2019
7. Dovey, Kim (2016) *Urban density matters – but what does it mean?*, e qasshme në: <https://theconversation.com/urban-density-matters-but-what-does-it-mean-58977> , (qasur me 12.09.2020)
8. DPPP (2012) *Hyrje në Partneritetet Publiko Private, Doracak për Pjesëmarrës*, f.32
9. Dr. Colin Harrison (2017) *The Search for a Theory of Cities*, e qasshme në: <https://meetingoftheminds.org/search-theory-cities-23642> (qasur me 16 Nëntor, 2021)
10. European Union (2011) *How to strengthen the territorial dimension of 'Europe 2020' and the EU Cohesion Policy* , f. 6, f. 14
11. European Commission (2003) *Impact of Community policies on social and economic cohesion*, f.3
12. European Commission (2021) *Kosovo* 2021 Report*, f.28, f.59
13. European Court of Auditors (2018) *Public Private Partnerships in the EU: Widespread shortcomings and limited benefits*, f.14
14. Eduardo Medeiros (2019) *Measuring Territorial Cohesion*, f.90
15. European Parliament (2017) *The role of cities in the institutional framework of the European Union*, f.10
16. European Regional Development Fund (2006) *Private Partnership in urban regeneration. A guide to opportunities and practice*, f.4
17. European Union (2021) *Cities of tomorrow. Challenges, visions, ways forward*, f.7, f.11

18. European Union (2021) *Territorial cohesion*, e qasshme në: https://ec.europa.eu/regional_policy/en/policy/what/territorial-cohesion/, (qasur me 17.11.2021)
19. European Union (2006) *ESPOON project 2.3.2, Governance of Territorial and Urban Policies from EU to Local Level*, f.25
20. European Union (2011) *The Territorial State and Perspectives of the European Union*, f. 12
21. Eurostat (2001) *European cities - spatial dimension*, e qasshme në: https://ec.europa.eu/eurostat/statisticsexplained/index.php?title=Archive:European_cities_-_spatial_dimension, (qasur me 24.04.2021)
22. European Union (2014) *State of the Art on Sustainable regeneration in urban areas. Urbact II capitalisation*, f. 6
23. Feinstein, Susan. S., (2005) *CITIES AND DIVERSITY, Should We Want It? Can We Plan For It?*, f.12
24. Fiona Woo, (2013) *Sustainable urban development: it's time cities give back*, e qasshme në: <https://www.theguardian.com/global-development-professionals-network/2013/aug/13/sustainable-urban-development-regeneration> (qasur me 16 Nëntor, 2021)
25. Frick & Rodríguez-Pose (2017) *Big or small cities: On city size and economic growth*, e qasshme në: <https://voxeu.org/article/city-size-and-economic-growth>, (qasur me 08.10.2021)
26. Fundacion Once (2014) *Public-private partnership for accessibility*, e qasshme në: https://zeroproject.org/wp-content/uploads/2013/12/Public-private-partnership-for-accessibility_Spain.pdf, (qasur me 21.11.2021)
27. Gauthier Mario (2009) *Urban planning and sustainable development*, e qasshme në: <https://journals.openedition.org/eue/894>, (qasur me 20.04.2021)
28. George B. Ford G (1913) *The city scientific. Engineering Record* 67, f. 551–552
29. GTZ (2006) *Strategic Communication for Sustainable Development: A conceptual overview*, f.9
30. Habitat (2019) *Capacity building and knowledge form the foundation of the new urban agenda, a position paper*, f.1
31. INSI (2021) *Draft Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Prishtinës*, f.48-49, f.88, f.154-155, f.131-137
32. Instituti për planifikim hapësinor (2004) *Profili i Kosovës, Zhvillimi hapësinor në Kosovë*, f.11
33. Janin Rivolin U. (2005) *Cohesion and subsidiarity: Towards good territorial governance in Europe*, f.100
34. Jens Haubensak (2020) *Three key business challenges to increasing sustainability*, e qasshme në: <https://ramboll.com/ingenuity/3-key-challenges-for-business-to-turn-more-sustainable> (qasur me 21 gusht 2019)

35. Jomo, J. K. and Chowdhury, Anis (2009) *Reconsidering public-private partnerships in developing countries*, International Journal of Institutions and Economies, 1(2), f.191–205
36. Komuna e Prishtinës (2013) *PLANI ZHVILLIMOR URBAN PRISHTINA 2012-2022*, f.8, f.39
37. Komuna e Prishtinës (2019)*Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Prishtinës (PMQU)*, f.2
38. Kosovo 2.0 (2017) *Women out of Work*, e qasshme në: <https://kosovotwopointzero.com/en/women-out-of-work/> , (qasur me 12.07.2021)
39. Kremer et al. (2020) *Placing Equity at the Center of the Urban Greening Agenda*, e qasshme në: <https://www.thenatureofcities.com/2020/01/18/placing-equity-at-the-center-of-urban-greening-agenda/>, (qasur me 09.11.2021)
40. Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013) *Ligji për planifikim hapësinor Nr.04/L- 174*, f. 5, f.4
41. Libertung, Nora (2021) *How to plan accessible cities*, e qasshme në: <https://blogs.iadb.org/ciudades-sostenibles/en/how-to-plan-accessible-cities> , (qasur me 21.09.2021)
42. Martin et al. (2018) *What EU Territory do we want to hand over to the next generations?*, f.7
43. Medeiros, Eduardo (2016) *Territorial Cohesion: An EU concept*, Fig.1. The star of the Territorial Cohesion, f.11
44. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (2019)*STRATEGJIA KOMBËTARE PËR INOVACION DHE NDËRMARRËSI (2019-2023)*, f.10
45. Ministers responsible for Spatial Planning and Territorial Development (2020) *Territorial Agenda 2030*, f.1
46. Mohieldin (2018) *SDGs and PPPs: What's the connection?*, e qasshme në: <https://blogs.worldbank.org/ppps/sdgs-and-ppps-whats-connection> , (qasur me 21.09.2020)
47. Morrison (2017)*Public-Private Partnerships for the Knowledge Economy: The Case of Innovation Centers*, f.2
48. Netherlands Environmental Assessment Agency (2009) *A Territorial Impact Assessment of Territorial Cohesion for the Netherlands*, f.11
49. OECD (2013) *Assessment of the Kosovo* Innovation System* , f. 64-65
50. OECD (2001) *COMPETENCIES FOR THE KNOWLEDGE ECONOMY*, f.100, f.106
51. Ohiani, J.A.M. (2014) Evolution of Public Private Partnership, legal and Regulatory Framework. Infrastructure Concession Regulatory Commission (ICRC), e qasshme në www.icrc.gov.ng, (qasur me 22.10.2020)
52. Pallaska, Elvida (2014) *Drejt Prishtinës Metropolitane përmes bashkëpunimit regional* , f.14, f.15
53. Pallaska, Elvida, *Transition towards Knowledge - based development- case of Prishtina*, f. 10

54. Pinto et al. (2010) *Planning Public Spaces Networks Towards Urban Cohesion*, 46th ISOCARP Congress 2010, f.1
55. Republika e Kosoves, (2013) *PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I PRISHTINËS 2012-2022*, f.8, f.12, f.13, f.40
56. Republika e Kosovës (2014) *Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publiko-Private 2014-2016*, f.14, f. 21
57. Republika e Kosovës (2021) *PROGRAMI I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2021 –2025*, f.21
58. Ritter, E.-H. (ed.), (2003) *Spatial Development Policy in the European Constitutional Treaty: Position Paper from the ARL* (Hanover: Akademie für Raumforschung und Landesplanung), f.9
59. Soros (2012) *Magazina evropiane- zhvillimet urbane*, f.12
60. Spangenberg, J.H. and Valentin, A. (1999) *Indicators for Sustainable Communities*. Wuppertal Institute for Climate, Environment and Energy, e qasshme në: <https://engagement.uiowa.edu/sites/engagement.uiowa.edu/files/2020-11/Valentin%2C%20Spangenberg%20-%202000%20-%20A%20guide%20to%20community%20sustainability%20indicators.pdf> , (qasur me 21.05.2021)
61. State Secretariat of Regional Development and Construction of the Ministry for National Development and Economy (MNDE) (2010) *Handbook for the National Implementation of the Territorial Agenda of the European Union- The Case of Hungary*, f.14
62. The Royal Swedish Academy of Engineering Sciences (IVA) (2017) *Drivers and consequences of urban development. IVA project Good cities of the future*, f.6
63. UCGL (2016) *Agenda 21 for culture. Operationalising culture in the sustainable development of cities*, f.9-11
64. UN (2016) *The New Urban Agenda: Key Commitments*", e qasshme në: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/blog/2016/10/newurbanagenda/> , (qasur me 12.10.2020)
65. UN (2018) *68% of the world population projected to live in urban areas by 2050*, says UN, e qasshme në: <https://www.un.org/development/desa/en/news/population/2018-revision-of-world-urbanization-prospects.html>, (qasur me 20.04.2020)
66. UNDP (2019) *Social Cohesion in Kosovo: Context review and entry-points*, f.8
67. UN Habitat (2016) *Urban governance, capacity and institutional development*, e qasshme në: <http://habitat3.org/wp-content/uploads/Policy-Paper-4-English.pdf> (qasur me 20 Gusht 2021)
68. UN Habitat (2016) *Leading Change. Delivering the New Urban Agenda through Urban and Territorial Planning*, f.10, f.14
69. UN Habitat (2011) *Public- Private Partnership in Housing and Urban Development*, f.10

70. UN Habitat (2019) *CAPACITY BUILDING STRATEGY 2020-2030- ZERO DRAFT*, f.8
71. United Nations Department of Economic and Social Affairs (2018) *The Sustainable Development Goals Report 2018*, f. 24-25
72. United Nations General Assembly (1987) *Report of the World Commission on Environment and Development: Our Common Future*, f.16
73. Urbact News (2019) *Improving children's education for a sustainable urban future* e qasshme në: <https://urbact.eu/cities-improving-children-education> , (qasur me 03.11.2021)
74. Union of the Baltic Cities Sustainable Cities Commission (2017) *Nordregio Forum 2017: "Nordic Cities - Connecting the Urban and the Rural*, e qasshme në: <https://www.ubc-sustainable.net/events/nordregio-forum-2017-nordic-cities-connecting-urban-and-rural> (qasur me 15 Nentor 2021)
75. Urban Times (2017) *Promoting Diversity in a Globalized World*, e qasshme në: <https://www.smartcitiesdive.com/ex/sustainablecitiescollective/promoting-diversity-globalized-world/129576/> , (qasur me 18.10.2021)
76. Urban Times (2017) *Promoting Diversity in a Globalized World*, e qasshme në: <https://www.smartcitiesdive.com/ex/sustainablecitiescollective/promoting-diversity-globalized-world/129576/> , (qasur me 29.10.2021)
77. UNESCAP & UN-Habitat (2010) *The state of Asian cities 2010/11. Nairobi: UN-Habitat/UNESCAP*, e qasshme në: <https://gsdrc.org/topic-guides/urban-governance/concepts-and-debates/what-is-urban-governance/>, (qasur me 12.12.2020)
78. Van den Berg et al. (2004) *European Cities in the knowledge economy*, Euricur, Rotterdam
79. van Winden et al. (2007) *European Cities in the Knowledge Economy: Towards a Typology*, f.1
80. Vutsova, Albena (2014) *The role of public-private partnership for effective technology transfer*, f.88
81. World Bank (2018) *3 Big Ideas to Achieve Sustainable Cities and Communities*, e qasshme në: <https://www.worldbank.org/en/news/immersive-story/2018/01/31/3-big-ideas-to-achieve-sustainable-cities-and-communities> , (qasur me 11.07.2021)
82. World Bank (2014) *Urban Development: Sector Results Profile*, e qasshme në: <https://www.worldbank.org/en/results/2013/04/14/urban-development-results-profile> , (qasur me 15.9.2020)
83. World Bank (2016) *Global Platform for Sustainable Cities*, e qasshme në: <https://www.worldbank.org/en/topic/urbandevelopment/brief/global-platform-for-sustainable-cities> , (qasur me 12.09.2019)

ANEKSET

1. ANEKSI-I- TË DHËNA TË SIGURUARA NGA LIGJE DHE RREGULLORE

LIGJI NR. 04/L-045 PËR PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT

LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

LIGJI NR. 06/L-012 PËR KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PRISHTINËN

2. ANEKSI-II- ANKETË ME AUTORITETIN LOKAL (KOMUNA E PRISHTINËS)
ZHVILLUAR ME DATËN: 15.08.2020, PRISHTINË

3. ANEKSI III ANKETË ME DUQANGJINJTË BRENDA DHE JASHTË NËNKALIMIT
“BILL CLINTON”
ZHVILLUAR ME DATËN: 16.08.2020, PRISHTINË

4. ANEKSI IV- ANKETË ME KALIMTARËT BRENDA DHE JASHTË NËNKALIMIT
“BILL CLINTON”
ZHVILLUAR ME DATËN: 17.08.2020, PRISHTINË